



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

Hz. MUSA a.s.

Harun Yahya

Botuar nga: **e pabotuar**

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë autorit

| | |
|---|----|
| HYRJE | 6 |
| SOVRANITETI I FARAONIT NË EGJIPT DHE GJENDJA E BIJVE TË IZRAELIT | 8 |
| LINDJA E MUSAIT (AS)..... | 13 |
| MUSAI (AS) IKË NGA EGJIPTI | 18 |
| IKJA PËR NË MEDJEN DHE VENDOSJA E TIJ ATJE | 21 |
| ARRITJA E TIJ NË LUGINËN TUVA DHE FRYMËZIMI I PARË | 25 |
| BISEDA E ZOTIT ME MUSAIN (AS) | 26 |
| MUSAI (AS) KËRKON HARUNIN (AS) SI SHOQËRUES TË TIJ | 29 |
| HISTORIA E MUSAIT (AS) DHE..... | 31 |
| FSHEHTËSIA E FATIT | 31 |
| PËRCJELLJA E POROSISË FARAONIT DHE MËNYRA E DUHUR NË TË CILËN KJO DUHET TË BËHEJ..... | 35 |
| GJYKIMI I SH TREMBËRUAR I FARAONIT | 37 |
| TITUJT E SUNDUESVE EGJIPTIANË NË KUR'AN | 45 |
| LUFTA E MUSAIT (AS) KUNDËR MAGJISTARËVE | 47 |

| | |
|---|-----|
| MAGJISTARËT PËRQAFOJNË BESIMIN | 50 |
| NJË NJERI BESIMTAR DHE PALLATI | 55 |
| EMRI "HAMAN" NË KUR'AN PËRMEDET GJITHASHTU NË MBISHKRIMET E LASHTA EGJIPTIANE | 59 |
| MOSMIRËNJOHJA E TË BIJËVE TË IZRAELIT | 62 |
| PERIUDHA E KATASTROFAVE DHE MARRËZIA E FARAONIT | 64 |
| EKSODI NGA EGJIPTI DHE FUNDOSJA E FARAONIT NË DET | 68 |
| ARROGANCA E KARUNIT DHE NDËSHKIMI I TIJ | 73 |
| FISI I MUSAIT (AS) DEVIJON DHE ADHURON VIÇIN E ARTË | 78 |
| SJELLJA E ÇORODITUR E FISIT HEBREIT | 86 |
| RRËFIMI PËR LOPËN | 88 |
| NGRITJA E TË BIJËVE TË IZRAELIT KUNDËR URDHËRIT TË ZOTIT | 90 |
| MUSAI (AS) DHE NJË NJERI I DITUR | 93 |
| PËRFUNDIM | 97 |
| KEQKËPTIMI I EVOLUCIONIT | 103 |

| | |
|--|-----|
| RËNIA (RRËNIMI) SHKENCORE E DARVINIZMIT | 104 |
| HAPI I PARË I PAKAPËRCYESHËM: ZANAFILLA E JETËS | 105 |
| “JETA RRJEDH (BURON) NGA JETA” | 106 |
| PËRPJEKJET JOBINDËSE TË SHEKULLIT TË ZOTË..... | 107 |
| PËRBËRJA KOMPLEKSE E JETËS..... | 109 |
| MEKANIZMAT IMAGJINARË TË EVOLUCIONIT..... | 110 |
| NDIKIMI I LAMARKUT..... | 111 |
| NEO-DARVINIZMI DHE MUTACIONET | 112 |
| DËSHMITË PËR FOSILE: S’KA SHENJA TË FORMAVE TË NDËRMJETME | 114 |
| SHPRESAT E DARVINIT U SHPARTALLUAN..... | 115 |
| PËRRALLA E EVOLUCIONIT NJERËZOR..... | 116 |
| TEKNOLOGJIA E SYRIT DHE VESHIT | 120 |
| KUJT I TAKON NDËRGJEGJIA QË SHEH DHE DËGJON PËRBRENDIA TRURIT? | 123 |
| NJË BESIM MATERIALIST | 124 |

HYRJE

Historia e njerëzimit do të mund të konsiderohej si histori e profetëve. Zoti iu ka kumtuar Shpalljet e Tij Hyjnore njerëzve përmes të dërguarve të Tij gjatë historisë. Këta të dërguar ju treguan njerëzve për Zotin dhe ua komunikuan atyre fjalët e Zotit tonë.

Lufta me të cilën një numër prej të dërguarve u përballën në përhapjen e porosisë është përshkruar hollësisht në Kur'an. Vështirësitë që ndeshën, zgjidhjet që bënë dhe sjellja shembullore janë të përshkruara të gjitha në mënyrë të qartë. Zoti na njofton me çfarë sfida u desht të përballen ata si një shembull për njerëz, sepse lufta e tyre dhe karakteri i mirë i tyre janë gjithashtu të zbatueshme për njerëzit sot.

Në Kur'an, tregimet dhe përvojat e profetëve të ndryshëm, përveç Profetit Muhamed (saas), sikur ato për Profetin Isa (Jesus), Sulejman (Solomon), Jusuf (Jozef), Nuh (Nou), Ibrahim (Abraham), dhe shumë të tjerë (paqja qoftë mbi të gjithë ata), janë të përcjellura si shembuj. Për shembull, ka mësim të shumta për ne në sjelljen e drejtë të Profetit Jusuf, si edhe në njohjen e thellë të psikologjisë njerëzore dhe shoqërore në marrëdhënien e Jusufit me vëllezërit e tij, hudhja e tij në pus nga ata, shitja e tij si rob, rrënia e tij në burg gjersa ishte rob në pallatin mbretëror për shkak të akuzave të rrejshme dhe emërimi i tij si autoritet i arkës shtetërore.

Ekziston me të vërtetë një shembull i rëndësishëm për ne tek Profeti Ibrahim, i cili përmendet nga Zoti në Kur'an si "...një shembull i shkëlqyeshëm për ju..." për shkak të ndërgjegjshmërisë dhe butësisë së tij, për mbështjetjen e tij në Zotin dhe për kthimin e tij kah Zoti kur po e hudhnin në zjarr.

Profeti i cili më së shpeshti përmendet në Kur'an si shembull është Profeti Musa (Mojsiu) (as). Emri i Musait përmendet në 34 sure (kapituj) të ndryshme. Mund të gjejmë informacion të gjerë për jetën e Musait në tri prej sureve më të mëdha (al-A'raf, Ta Ha dhe al-Qasas). Gjithë këto sure dhe vargje ofrojnë shpjegime të hollësishme për vështirësitë e tij me Faraonin, duke filluar nga fëmijëria e tij, sjellja e ligë e njerëzve të tij dhe lufta e tij për t'ua përcjellur atyre porosinë. Guximi i tij i palëkundur në rrethanat më të vështira paraqitet me qëllim që të jetë shembull për njerëzit.

Në këtë libër do ta hulumtojmë jetën e Profetit Musa siç është përshkruar në Kur'an. Do t'i hulumtojmë ndodhitë që ai ka përjetuar ashtu siç janë përshkruar. Në thelb, ndodhitë në jetën e Profetit Musa nuk duhet të merren thjeshtë si ndodhi të së kaluarës së lashtë, por më shumë si ndodhi dhe shembuj për të ndriçuar vet jetërat tona sot.

SOVRANITETI I FARAONIT NË EGJIPT DHE GJENDJA E BIJVE TË IZRAELIT

Përveç qyteteve shtete të themeluara në Mesopotami, qytetërimi Egjiptian ishte një prej qytetërimeve më të lashta në histori. Egjipti i vjetër dihet të ketë pasur rregullimin më të organizuar shoqëror dhe politik të kohës. Zbulimi i tyre i shkrimit, 3000 vite para erës së re, përdorimi i lumit Nil, shkretëtirat që rrethonin vendin dhe që shërbenin si një mbrojtje e fortë ndaj kërcënimeve të jashtme ishin faktorët kryesor për përparimin e suksesshëm të Qytetërimit Egjiptian.

Megjithatë, ky qytetërim madhështor sundohej nga Faraoni, sundimi i të cilit përshkruhet në mënyrë të qartë në Kur'an si një shembull i kokëfortësisë (kryeneqësisë). Ky popull vepronte me mendjemadhësi kundër Zotit, duke këmbëngulur në mënyrë të vazhdueshme në mohimin e së vërtetës.

Si pasojë, madje edhe qytetërimi i tyre i përparuar, rregullimi shoqëror dhe politik dhe të arriturat ushtarake, s'arritën t'i mbrojnë ata nga shkatërrimi.

Ndodhitë më të rëndësishme të historisë së Egjiptit patën lidhje me praninë e bijve të Izraelit në këtë vend.

Izrael është emri tjetër i Profetit Jakub (Jakobi) (as). Të bijtë e Jakubit formuan fisin e “të bijve të Izraelit,” fisin i cili me kohë u bë i njohur si “Çifutët (Jahuditë apo Hebrenjtë).” Të bijtë e Izraelit

së pari erdhën në Egjipt gjatë kohës së Profetit Jusuf, djalit më të ri të Jakubit. Në Kur'an, në Suren Jusuf, është dhënë një përshkrim i hollësishëm i jetës së Jusufit. Duke filluar që nga vitet e para të jetës së tij, Jusufi ishte përballur me vështirësi të shumta dhe i ishte nënshtruar sulmeve dhe shpifjeve të shumta. Në periudhën e mëvonshme të jetës, pas liritimit nga burgu ku e kishin futur për shkak të një akuze të rrejshme, Jusufi u emërua përgjegjës për arken shtetërore të Egjiptit. Emërimi i tij u përcoll me dyndjen e bijve të Izraelit në Egjipt. Kjo në Kur'an përshkruhet kështu:

Pastaj kur ata hynë te Jusufi, ai i mori prindërit e tij pranë vetes dhe u tha: “Hyni në Egjipt të sigurt, nëse dëshiron Zoti.” (Kur'an, 12:99)

Siç shpjegohet në Kur'an, të bijtë e Izraelit, që banuan në paqe dhe siguri në Egjipt, përfundimisht humbën pozitën e tyre në shoqëri dhe me kohë u robëruan. Nga vargjet e cekura në Kur'an mësojmë se bijtë e Izraelit ishin në atë gjendje kur Musai u paraqit në skenë. Siç përshkruhet në Kur'an, Musai shkoi te Faraoni si “pjesëtar i një fisi të robëruar.” Përgjigja arrogante që pasoi, që Faraoni dhe paria e tij ia bënë Musait (as) dhe Harunit (as), na e bënë të ditur këtë fakt:

Ata thanë: “A të besojmë ne në dy njerëz si vet ne dhe duke qenë populli i tyre nën robërinë tonë?” (Kur'an, 23:47)

Siç përshkruhet në këto vargje, Egjiptianët i kishin robëruar të bijtë e Izraelit dhe i kishin bërë ata shërbëtorë të vet. Për të mbajtur dhe imponuar këtë sistem të robërisë, Egjiptianët përdorën metoda të shtypjes. Kjo shtypje u ushtrua gjer në shkallën e vënies nën kontroll të tërë popullatës Izraelite. Shtimi i popullatës mashkullore i konsideruar si një sfidë e mbijetesës së vet

Egjiptianëve, u pengua, gjersa popullata femërore u shfrytëzua për t'u shërbyer atyre. Kjo gjendje përshkruhet në vargjet në të cilat Zoti iu drejtohet bijve të Izraelit:

Përkujtoni kur Ne ju shpëtuam nga populli i Faraonit. Ata po ju sprovonin me dënimin më të rëndë – duke ju vrarë bijtë tuaj dhe duke lënë gjallë gratë tuaja. Këtu pati një sprovë të madhe për ju nga Zoti juaj. (Kur'an, 2:49)

Përkujtoni kur Ne ju shpëtuam nga populli i Faraonit, i cili po ju sprovonte me dënimin më të rëndë, duke vrarë bijtë tuaj dhe duke lënë gjallë gratë tuaja. Këtu pati një sprovë të madhe për ju nga Zoti juaj. (Kur'an, 7:141)

Religjioni mbizotërues në tokën Egjiptiane ishte trashëgimia e zakoneve të adhurimit të idhujve të paraardhësve të Faraonit. Ky religjion i padrejtë besonte në ekzistencën e zotërave të shumtë. Faraoni në anën tjetër besohej të ishte një zot i gjallë. Ishte pikërisht ky besim që iu dha faraonëve një fuqi të tillë mbi njerëzit që ishin nën sundimin e tyre. Faraoni dhe paria sunduese e tij e panë Musain si një kërcënim për mënyrën e jetës së tyre të diktuar nga religjioni i paraardhësve të tyre, pasi që sipas këtij religjioni, ishte Faraoni ai që zotëronte gjithë fuqinë dhe madhësitinë. Arroganca e Faraonit, përpjekja e tij për të ruajtur kontrollin dhe konsiderimi i Musait dhe Harunit si rival të tij dëshmohen me këto fjalë të Faraonit dhe parisë së tij, me të cilat ata i drejtohen Musait dhe Harunit:

Ata i thanë: “A ke ardhur te ne që t’na largosh nga ai besim të cilin i gjetëm baballarët tonë ta ndjekin dhe që ju të dy të mund të fitoni madhësi në tokë? Ne nuk do t’ju besojmë ju të dyle.” (Kur'an, 10:78)

Në pajtim me religjionin e paraardhësve të tij, Faraoni pohonte se ishte zot. Ai shkoi aq larg sa të pohonte se ishte zoti i tyre më i lartësuar:

(Faraoni) duke thënë: “Unë jam zoti juaj më i lartë!” (Kur’an, 79:24)

Për shkak të bestytnisë së tyre, Faraoni dhe paria e tij e konsideronin veten si qenie hyjnore. Arroganca e tyre buronte nga fakti se ata ishin shumë larg dashurisë, përkujdesjes dhe mëshirës, që janë norma të urdhëruara nga religjioni i ri. Si rrjedhojë e arrogancës së tyre, ata besonin se kishin të drejtë t’i japen mizorisë. Zoti i referohet mendësisë së tyre në vargun vijues:

...tek Faraoni dhe krerët e tij. Por ata u sollën me paturpësi dhe qenë popull arrogant e mburravec. (Kur’an, 23:46)

Faraoni kishte ndikim aq të madh tek njerëzit e Egjiptit sa që të gjithë i nënshtroheshin plotësisht atij. Ata besonin se Faraoni ishte i vetmi zotërues i tërë tokës së Egjiptit dhe lumit Nil:

Faraoni iu drejtua njerëzve të tij duke thënë: “O populli im! A nuk më takon mua sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjëve që rrjedhin poshtë meje? A nuk shihni pra?” (Kur’an, 43:51)

Me të drejtë thuhet se Nili don të thot jetë për Egjiptin. I tërë Egjipti mvarej nga Nili për bujqësi. Nili ujiste të lashtat, furnizonte me ujë të pijshëm si kafshët ashtu edhe njerëzit. Sipas Faraonit dhe parisë së tij, i vetmi pronar i ujërave të Nilit dhe i vet tokës ishte Faraoni. Secili në Egjipt pranonte në heshtje fuqinë e tij dhe i bindej sundimit të tij.

Për të siguruar pushtetin e tij dhe për t'i nënshtruar njerëzit e tij, Faraoni i kishte përçarë ata në grupe të veçuara dhe me ndihmën e këshilltarëve të besuar të tij nga mesi i tyre, i sundonte këto grupe të dobësuara. Në një varg, Zoti na tërheq vëmendjen për këtë gjendje:

Faraoni ngriti veten shumë lart në tokë dhe i ndau njerëzit në të në sekte, duke dobësuar (shtypur) një grup prej tyre duke vrarë bijtë e tyre dhe duke lënë gjallë gratë. Vërtetë që ai qe prej shtypësve (tiran). (Kur'an, 28:4)

Para lindjes së Musait, Egjipti ishte një vend i mëkatshmërisë dhe çoroditjes. Duke u bazuar krejtësisht në dallime racore njerëzit robëroheshin dhe torturoheshin. Pa ndonjë arsyetim të qartë, Faraoni urdhëroi të vriteshin që të gjithë fëmijët e gjinisë mashkullore të Izraelitëve që ishin nën sundimin e tij. Për më tepër, i zhytur në mendjemadhësi dhe mizori, ai e konsideronte veten zot në tokë. Me anë të vendosjes së një sistemi të sundimit, Faraoni mbante çdo gjë nën kontrollin e tij dhe i bënte njerëzit t'i nënshtroheshin atij.

Në këto rrethana Musai u dërgua atje si i dërguar i Zotit për t'i dhënë fund shtypjes dhe mizorisë, për t'ju përkujtuar njerëzve se Zoti ynë është Allahu, për t'ju mësuar atyre fenë e re dhe për t'i shpëtuar të bijtë e Izraelit nga robëria.

LINDJA E MUSAIT (AS)

Siç u tha në kapitullin e mëparshëm, Musai lindi në një kohë fatkeqe. Madje edhe në momentin e lindjes së tij, jeta e tij ishte në rrezik. Faraoni urdhëroi që të gjithë femijët e gjinisë mashkullore të vriten dhe femrat të kursehen për t'u robëruar. I zënë në grackë nën rrethana të tilla, Musai ishte i shtyer të jetonte një jetë të vështirë në mesin e robërve nën kërcënimin e vazhdueshëm me vdekje. Nëna e tij ishte shumë e brengosur për të deri në momentin kur u frymëzua nga Zoti:

Dhe Ne e frymëzuam nënën e Musait (duke i thënë): “Jepi gji atij por kur të kesh frikë për të, atëherë hidhe në lum (det) dhe mos ke frikë dhe as mos u pikëllo. Sigurisht që Ne do ta sjellim atë përsëri tek ti dhe do ta bëjmë atë prej të Dërguarve Tonë.” (Kur’an, 28:7)

Zoti e udhëzoi nënën e Musait dhe i tha asaj që ta vendoste atë në një arkë dhe ta lëshonte të lundroj në lumin Nil, poqese ushtarët e Faraonit kurdoherë do të mësonin për lindjen e tij. Pasiqë frikësohej për jetën e djalit të saj, ajo veproi sipas asaj që iu frymëzua. Duke mos ditur se ku dhe si do ta kishin bartur ujërat djalin e saj, ajo e vendosi Musain në një arkë dhe e lëshoi në ujërat e Lumit Nil. Mirëpo, me frymëzimin nga Zoti, ajo e dinte se ai në fund do t'i kthehej asaj dhe do të bëhej i dërguar i Zotit. Zoti, Krijuesi dhe Gjithëpërfshirësi, krijoi Musain dhe nënën e tij dhe i lejoi të dinë për fatin e tyre. Më vonë, Zoti përkujtoi Musain për faktet e fëmijërisë së tij të hershme në këtë mënyrë:

Kur Ne e frymëzuam nënën tënde (duke i thënë): “Vendose në arkë dhe hidhe në lum (det), pastaj lumi (deti) do ta nxjerr në breg dhe atje, ai që është armik i Imi dhe i tij do ta marr...” ” (Kur’an, 20:38-39)

Në këtë pikë, do të duhej të shtjellonim në hollësi temën e fatit. Zoti, siç tregohet në vargun më lartë, i tha nënës së Musait ta lëshonte djalin në ujë dhe e bëri me dije atë se Faraoni më vonë do ta gjente dhe se Musai në fund do t'i kthehej asaj si një i dërguar i Zotit. Me fjalë të tjera, se Musai do të vendosej në arkë dhe do të lëshohej në lum, se atë do ta gjente dhe për të do të përkujdesej Faraoni dhe se ai përfundimisht do të bëhej njëri prej profetëve, të gjitha ishin të ditura që më parë. Kjo për arsye se të gjitha këto ngjarje ishin parapërcaktuar nga Zoti, në pajtueshmëri me vullnetin e Tij dhe që Ai i lejoi nënës së Musait të mësoj për këtë para se kjo të kishte ndodhur.

Këtu duhet të përmendim se të gjitha hollësitë që kanë të bëjnë me jetën e Musait ishin të paracaktuara në sytë e Zotit dhe se të gjitha ishin jetësuar sikurse ishte paracaktuar. Përmbushja e frymëzimit hyjnor që iu shfaq nënës së Musait ishte e mundur me anë të zhvillimit të kushteve të panumërta të paracaktuara nga fati.

Shmangia e ushtarëve të Faraonit dhe arritja e Musait në pallatin e Faraonit pa u fundosur mvareshin nga përmbushja e disa kushteve. Këto janë ato kushte:

1 Arka në të cilën ishte vendosur Musai foshnje duhej të ishte e papërshkueshme nga uji. Prandaj, ai që e konstrukttoi arkën duhej ta punonte në atë mënyrë që ajo të mund të lundronte. Për më tepër, forma e arkës ishte një faktor i rëndësishëm sa i përket shpejtësisë së lundrimit në ujë, s'duhej as të lundronte shumë shpejt dhe ta kalonte pallatin e Faraonit, e as shumë ngadalë, duke u ndalur kështu para se të arrinte tek Pallati. Arka duhej të ishte punuar pikërisht në formën e duhur që të mund të lundronte me shpejtësinë e duhur. Gjithë këta faktorë përbënin hollësitë e shumta të paracaktuara si pjesë e fatit të zdrukthëtarit, i cili e punoi arkën tamam ashtu si duhej.

2 Rryma e ujit që e kishte bartur arkën s'duhej të ishte as shumë e shpejtë e as shumë e ngadalshme, por të kishte shpejtësinë e duhur. Kjo do të ishte e mundshme vetëm me llogaritjen e saktë të sasisë së rreshjeve të shiut që formuan sasinë e ujërave të Nilit për minut. Kjo sasi e ujit bën gjithashtu pjesë në hollësitë e ndërlikuara të fatit të paracaktuar nga Zoti.

3 Erërat gjithashtu duhet të kenë ndikuar në mënyrë të përshtatshme në lëvizjen e arkës. Domethënë, erërat gjithashtu frynë në përputhje me një fat të paracaktuar. Ato duhet të kenë fryer as shumë shpejtë që ta largonin arkën, as në drejtim të kundërt që t'ia ndërronin drejtimin dhe as shumë ngadalë që t'ja ngadalsonin shpejtësinë.

4 Gjersa arka ishte në lum, askush s'do të mund ta gjente. Domethënë, askush përveç atij që duhej të haste në të apo ta vërente atë. Rrjedhimisht, në pajtim me një fat të përcaktuar, secili që jetonte përgjatë lumit Nil nuk kishte qenë afër apo s'e kishte vënë re arkën. Në fakt, këto rrethana ishin të gjitha pjesë e fatit të parapërcaktuar nga Zoti.

5 Sikurse jeta e Musait, jetërat e Faraonit dhe të familjes së tij gjithashtu u rregulluan në pajtim me një fat të paracaktuar. Ata duhej të ishin pikërisht në vendin e duhur dhe në kohën e duhur në mënyrë që të gjenin Musain. Familja e Faraonit do të mund të kishte planifikuar të vinte te bregu i lumit më heret. Ajo që i kishte shtyer ata të shkojnë atje pikërisht në atë kohë ishte fati i tyre.

Këto janë vetëm disa prej rrethanave që lejuan Faraonin të gjej Musain. Të gjitha kishin ndodhur pikërisht ashtu siç i ishte frymëzuar nënës së Musait. Në të vërtetë, premtimi që Zoti i dha nënës së Musait dhe të gjitha ngjarjet tjera që kishin ndodhur, kishin ndodhur të gjitha dhe ishin përmbushur pikërisht siç ishin paracaktuar tashmë nga Zoti.

Ngjarjet që kishin të bëjnë me fatin e Musait nuk ishin të kufizuara vetëm me ato ngjarje që i rrëfyem gjer më tani. Secili moment i jetës së tij ishte me kujdes i paracaktuar në pajtim me një fat të veçantë. As vendi as viti i lindjes së tij, as njerëzit me të cilët ishte i rrethuar ai, as nëna apo babai i tij nuk ishin përcaktuar sipas zgjidhjes së tij. Ishte Zoti që paracakttoi gjithçka dhe krijoi secilin prej tyre. Ky fakt u shpall gjithashtu nga Profeti Muhamed (saas) i cili tha: *“Gjithçka bëhet me urdhër – madje edhe paaftësia dhe aftësia”* (Muslim)

Një vlerësim më i thellë i këtyre ngjarjeve do t'na mundësoj që të kuptojmë më mirë se si secili moment i jetërave tona është i lidhur ngusht me fatin tonë. Përmes shembujve të shumtë, tregimi për Musain na mundëson të mendojmë për kuptimin dhe thurjen e fatit të tij. Me hollësitë e llojllojshme të tregimit për Musain, Zoti na përkujton se jeta e një individi, sikurse edhe jetërat e gjithë njerëzimit dhe e tërë gjithësia, janë të lidhura ngusht me fatin që Ai ka paracaktuar.

Poashtu sikur që Musai lundroi në Nil në pajtim me fatin e tij, ashtu edhe Faraoni dhe familja e tij u shtynë të arrijnë tek vendi ku do të takonin Musain. Nga vargjet që kanë të bëjnë me këtë temë, mësojmë se familja e Faraonit ishte sjellur pikërisht sikurse i ishte frymëzuar më parë nënës së Musait, domethënë, ata e kishin marrë Musain nën përkujdesjen e tyre pa qenë të vetëdijshëm se çfarë barte e ardhmja për ta:

Pastaj atë e mori familja e Faraonit, që ai të mund të bëhej për ta një armik dhe burim i pikëllimit të tyre. Me të vërtetë që Faraoni dhe Hamani dhe pasuesit (trupat) e tyre ishin mëkatarë. Dhe gruaja e Faraonit tha: “Një burim kënaqësie për mua dhe për ty. Mos e vrisni atë, mbase mund të jetë i dobishëm për në ose mund ta birësojmë atë si djalin tonë.” Dhe ata nuk e kuptonin dot (përfundimin e kësaj pune). (Kur'an, 28:8-9)

Dhe kështu Faraoni dhe familja e tij, plotësisht të pavetëdijshëm se çfarë do t'ju sjellte fati, gjetën Musain dhe e birësuan si djalin e tyre. Në të vërtetë, ata kishin vendosur ta mbajnë atë me shpresë se fëmija një ditë do t'ju sjellte përfitim.

Në ndërkohë, nëna e Musait ishte e brengosur për djalin e saj sepse nuk e dinte se çfarë i kishte ndodhur atij. Për ta përballuar këtë situatë, Zoti ia forcoj zemrën asaj:

Dhe zemra e nënës së Musait mbeti e zbrazët. Ajo që gati ta zbulonte (të vërtetën) po t'mos e kishim forcuar Ne zemrën e saj që ajo t'mund të mbetej prej besimtareve. Dhe ajo i tha motrës së tij (Musait): “Ndiqe atë.” Kështu ajo e përcjellte atë nga larg fshehtas, ndërsa ata nuk e shihnin dot. Dhe Ne së pari e bëmë atë (Musain) t'i refuzoj të gjitha mëndeshat, derisa erdhi ajo (motra e Musait) dhe tha: “A t'ju tregoj unë për një familje që do ta ushqej atë dhe do ta rritë atë për ju dhe që do të kujdeset mirë për të?”

Kësisoj Ne e kthyem atë te nëna e tij që asaj të mund t'i qetësoheshin sytë e t'mos pikëllohej dhe që të mund të kuptonte se premtimi i Zotit është i vërtetë. Por shumica e tyre nuk e dinë këtë. (Kur'an, 28:10-13)

Musai foshnje refuzoi të gjitha mëndeshat, domethënë, nuk piu qumështin e tyre, sepse sipas fatit të përcaktuar për të, Zoti kishte urdhëruar që ai të pinte vetëm qumështin e nënës së tij. Kjo ndriçon faktin se gjithcka njerëzit dëshirojnë është gjithashtu në pajtim me fatin e paracaktuar nga Zoti. Siç i ishte frymëzuar nënës së tij, Profeti Musa më në fund u kthye tek familja e tij.

Në tregimin për Musain, Zoti sqaron se Ai shpesh krijon situata që duken të jenë të vëshira dhe pa rrugëdalje të dukshme dhe se ngjarjet që perceptohen si fatkeqësi shumë lehtë mund të

ndodhë të jenë bekime të mrekullueshme. Një nënë e frikësuar nga kërcënimi që foshnja e saj mund të vritet nga ushtarët mizorë, për ta shpëtuar atë, e lëshon foshnjën të lundroj në ujërat e një lumi. E njëjta foshnje mandej birësohet nga familja më e fuqishme e vendit, e cila në fund e kthen foshnjën tek familja e saj, sepse foshnja refuzon të gjitha mëndeshat tjera... Secila nga këto ngjarje është një mrekulli në vetvete që demonstroi përsosmërinë e skajshme të fatit të urdhëruar nga Zoti. Për besimtarët, secili detaj i fatit të njeriut në fund rezulton të jetë një bekim. Siç mund të shihet në shembullin më lartë, nganjëherë Zoti përgatitë aso të mira për ne përmes rrethanave më të papritura.

MUSAI (AS) IKË NGA EGJIPTI

Në Kur'an rrëfëhet ngjarja në vazhdim nga jeta e Musait:

Dhe ai (Musa) hyri në qytet kur banorët e tij qenë të pavëmendshëm dhe gjeti atje dy burra që po ziheshin, njëri nga pala e tij, ndërsa tjetri nga armiqtë e tij. Njeriu i palës së tij i kërkoi atij ndihmë kundër armikut të tij, kështu që Musai e qëllloi atë me grusht dhe e mbyti atë. Ai tha: “Kjo është punë prej punëve të Shejtanit. Ai me të vërtetë është armik çorientues dhe humbës i qartë.” (Kur'an, 28:15)

Ngjarja e sipër përmendur na shfaqë një situatë në të cilën Musai ishte dëshmitar i një zënke në të cilën merrte pjesë një njeri nga fisi i tij, pas së cilës, pa vlerësuar se kush kishte të drejtë, ai muar anë duke goditur tjetrin. Edhe pse qëllimi i tij s'ishte ta mbyste atë, ai vdiq nga goditja. Profeti

Musa e pa se bëri mëkat. Parimi moral i kësaj ngjarjeje është se kur një person është në gabim, është e padrejtë të përkrahet vetëm pse i takon anës (palës) së njëjtë. Musai e quan veprimin e tij të gabuar, domethënë pandehjen e tij të epërsisë së njeriut nga vet fisi i tij si “punë prej punëve të Shejtanit.”

Me të vërtetë, çështja e përfolur këtu është një çështje që i ka sjellë urrejtje dhe luftëra njerëzimit gjatë historisë dhe kështu vazhdon të jetë gjer në ditët tona. Obsesioni patriotik i njeriut ndaj familjes së tij, fisit, shokëve apo racës dhe refuzimi i asaj që është e drejtë për këtë qëllim kanë qenë shkaktarët kryesor të shumicës së konflikteve dhe mizorive të kryera në histori.

I alarmuar nga ndërgjegja e tij, Musai përnjëherë kuptoj se kjo ndjenjë ishte një e keqe që vinte nga ndikimi i Shejtanit, dhe prandaj kërkoi strehim (mbrojtje) nga kjo tek Zoti dhe u pendua. Në vargjet vijuese, lexojmë për qasjen shembullore dhe të ndërgjegjshme të përvetësuar nga Musai:

Ai tha: “Zoti im! I bëra keq vetes sime. Më fal.” Pastaj Zoti e fali atë. Vërtetë që Ai është gjithnjë Falës i Madh, i Gjithëmëshirshëm. Ai tha: “Zoti im! Për atë që ti më ke nderuar, unë kurrë më s’do të jem ndihmës i keqbërësve.” (Kur’an, 28:16-17)

Musai pranoi gabimin e tij, atë të mbrojtjes së një njeriu, në kundërshtim me drejtësinë, vetëm pse ai ishte nga fisi i tij. Megjithatë, ky lloj qëndrimi paragjykues ishte i zakonshëm për njerëzit e Egjiptit. Me të dëgjuar për vrasjen e paqëllimtë të Musait, njerëzit e fisit tjetër të shtyrë nga nderja raciste mund të ishin hakmarrë duke vrarë Musain. Ishte frika që kjo mund të ndodhte ajo që e shqetësoi Musain:

Mëngjezi e gjeti atë në qytet, të frikësuar dhe në pritje të asaj që do të ndodhte (i frikësuar për pasojat e vrasjes), kur ç'të shoh! Njeriu që i kish kërkuar atij ndihmë një ditë më parë, kërkoj përsëri ndihmë nga ai. Musai i tha atij: “Me të vërtetë që ti je humbës dhe ngatërrestar i qartë.” (Kur'an, 28:18)

Pra, Musai s'mund të mbante më vendin e tij në shoqërinë e Faraonit. I brengosur për sigurinë e tij, Musai kaloi natën duke u ruajtur nga çfarëdo e keqe e mundshme nga Faraoni dhe njerëzit e tij. Të nesërmen, ngjarja e cila rrëfëhet në vargun e mësipërm ndodhi; njeriu i cili kërkoj ndihmën e Musait një ditë më parë erdh tek ai me një kërkesë të ngjashme, këtë herë kundër një njeriu tjetër. Siç bëhet e ditur në këtë varg, ai shpresonte që Musai t'i ndihmonte edhe njëherë tjetër, duke u bazuar në faktin se ishte pjesëtar i fisit të tij. Megjithatë, Musai iu shmang përsëritjes së gabimit të njëjtë. I vetëdijshëm se shoqëruesi i tij nuk kishte të drejtë, ai refuzoi t'i ndihmonte. Atëherë shoqëruesi i Musait përnjëherë u kthye kundër tij dhe filloi ta kritikonte. Ai përmendi kundër Musait vrasjen e paqëllimtë që Musai kryejti një ditë më parë:

Por kur po mendohej ta kapte njeriun që ishte armiku i atyre të dyve, burri tha: “O Musa! A don t'më vrasësh edhe mua sikur e mbyte një njeri dje? Ti vetëm dëshiron të bëhesh tiran në tokë dhe nuk don të jesh prej atyre që bëjnë mirësi e drejtësi.” (Kur'an, 28:19)

Sidoqoftë, edhe pse vrasja u krye pa qëllim, Musai merrej si një njeri që kishte vrarë një Egjiptian. Ndërkohë, Faraoni dhe krerët e tij diskutuan dënimin e Musait, madje edhe mundësinë e ekzekutimit të tij. Dikush që dëgjoi bisedën erdh të paralajmëroj Musain. I brengosur për thurrije të komplotit ndaj tij, Musai u largua nga Egjipti:

Një njeri erdh duke vrapuar nga skaji më i largët i qytetit, duke thënë: “O Musa! E vërtetë se krerët janë mbledhur të këshillohen së bashku për ty, për të vrarë ty, prandaj largohu! Vërtetë që jam prej atyre që të këshillojnë për të mirë.” Kështu ai u largua prej aty i frikësuar dhe duke u ruajtur, duke thënë: “Zoti im! Më shpëto prej popullit keqbërës!” (Kur’an, 28:20-21)

Këto fakte për jetën e Musait na japin njohuri për personalitetin e Musait gjithashtu. Duket që ai të ketë qenë një njeri mjaft gjaknxhtë. Gjatë përleshjes ai menjëherë muar anën e njeriut nga fisi i tij dhe pastaj goditi dhe paqëllim mbyti kundërshtarin. Në fund, duke u frikësuar për jetën e tij, ai iku nga Egjipti. Mund të fitohet përshtypja se Musai duhet të ketë qenë gjithnjë gjaknxhtë gjatë gjithë kohës në të cilën ndodhën këto ngjarje. Sidoqoftë, pas bisedës me Zotin, Musai mësoi të ketë frikë vetëm nga Zoti dhe të kërkojë mbrojtje (strehim) vetëm tek Ai. Ky është një shembull shumë i mirë për mënyrën se si Zoti forcon karakterin e njeriut.

IKJA PËR NË MEDJEN DHE VENDOSJA E TIJ ATJE

Musai la pas vetes Faraonin, njeriun i cili e kishte rritur, sikurse edhe popullin e Faraonit dhe shkoi në Medjen (Medjeni është një rajon përtej shkretëtirës së Sinait në lindje të Egjiptit, që korrespondon me skajin jugor të Jordanit të sotëm.)

Tek ujërat e Medjenit, Musai takoi dy gra që nuk mund t’u japnin për të pirë ujë tufës së tyre të deleve duke dashur t’ju shmangeshin barinjëve të tjerë. Por siç rrëfejnë vargjet e Kur’anit, nga pamja e jashtme, Musai dukej si një njeri tejet i edukuar dhe i besueshëm. Pra, gratë nuk ngurruan

t'i afrohen atij. Ato i shpjeguan se ato duhej të kullotnin tufën e deleve të babait të tyre ngase ai ishte një njeri i thyer në moshë, por s'kishin mundur ta bëjnë këtë për shkak të barinjëve. Atëherë Musai ju ndihmoi atyre duke qar tufën e tyre të deleve për t'u dhënë ujë:

Dhe kur arriti te ujërat e Medjenit, gjeti aty disa burra që po u japnin ujë bagëtive dhe aty pranë pa dy gra që po e ndalonin prapa tufën e tyre. Ai u tha: “Si është puna me ju?” Ato thanë: “Ne nuk mund t'i japim ujë tufës sonë, derisa barinjtë t'i kenë larguar tufat e tyre. Dhe babai ynë është burrë tepër i thyer në moshë.” Kështu ai u dha për to ujë tufës së tyre... (Kur'an, 28:23-24)

Vargjet ofrojnë një shembull të karakterit të sjellshëm dhe mirëdashës të Musait; ai i afrohet dy të huajave, i ndihmoi ato dhe fitoi respektin e tyre. Në anën tjetër, duhet të nënkuptohet se njerëzit, të përmendur si “barinjë,” japnin përshtypjen e një qëndrimi krejtësisht të kundërt me atë të Musait. Kjo është e qartë nga fakti se femrat me sa duket iu shmangeshin atyre ndonëse zgjodhën të bisedojnë me Musain. Këta njerëz mund të jenë dukur të dyshimtë për nga pamja e tyre (Zoti di më së miri.)

Mund të arrijmë në përfundimin se një Musliman duhet me kujdes t'i shmangët sjelljes karakteristike për njerëzit e përmendur këtu si “barinjë.” Muslimanët duhet të jenë shembull si Musai, i cili u soll me mirësi, modesti dhe çiltërsi. Siç sugjeron shembulli i Musait, një Musliman duhet të zhvillojë sjellje tejet të kultivuar dhe të jetë i besueshëm, cilësi këto që duhet të jenë menjëherë të dallueshme në të.

Gjithashtu duhet të përmendim faktin se Musai gjithnjë shfaq një temperament që shërben si shembull i nënshtrimit të sinqertë ndaj Zotit. Duke lënë gjithçka të dashur në tokën e Egjiptit ku ishte rritur, ai nuk e kishte fare idenë se çfarë i sillte e ardhmja. E vetmja gjë e sigurt ishte se asgjë

në jetën e tij më s'do t'ishte si më parë. Megjithatë, edhe pse ai nuk e dinte, Zoti tashmë kishte paracaktuar se çfarë do t'i ndodhte. Musai u lut kësisoji:

...dhe pastaj u ktheu shpinën dhe shkoi nën një hije dhe tha: “Zoti im! Sigurisht që unë kam nevojë për çfarëdo mirësie që Ti mund t'më dhurosh.” (Kur'an, 28:24)

Sinqeriteti i njeriut në lutje është dëshmi e të kuptuarit të tij të faktit se Zoti ka fuqi të bëjë çdo gjë, se të gjitha të mirat dhe fatkeqësitë vijnë vetëm prej Tij dhe se njeriu s'ka tjetër ndihmues a mbrojtës përveç Zotit. Lutja e Musait e cituar në vargjet e mësipërme është një lutje e bërë në nënshtrim të plotë ndaj Zotit, nga dikush që ka vetëdije të plotë për këtë të vërtetë. Me të vërtetë, Zoti iu përgjigj lutjes së sinqertë të Musait dhe derdhi prej mëshirës së Tij mbi të.

Mirësia që tregoi Musai ndaj dy grave rezultoi me një fillim të një jete plotësisht të re për të. Gjersa Musai ishte duke pushuar, njëra prej dy grave iu afrua dhe e njoftoi për ftesën e babait të saj në shenjë falënderimi për ndihmën e tij:

Pastaj atij iu afrua njëra nga dy gratë duke ecur e turpëruar dhe tha: “Babai im të fton që të mund të të shpërblejë për atë që u dhe ujë për ne tufës sonë.” Kështu kur shkoi tek ai dhe i tregoi gjithçka i kishte ndodhur, ai tha: “Mos u frikëso. Ti ke shpëtuar prej një populli keqberës.” (Kur'an, 28:25)

Musai iu lut Zotit tonë me sinqeritet, duke iu lutur për çfarëdo mirësie që Ai do t'i dhuronte. Zoti iu përgjigj lutjes së tij dhe pas kërcënimit që iu kanos për jetë e udhëzoi atë tek njerëzit që do t'i ndihmonin dhe ofronin siguri. Musai kishte karakter të fortë dhe ishte njeri i besueshëm për shkak të sjelljeve të tij. Me të vërtetë, femrat, pavarësisht nga ajo që ishin të kujdesshme ndaj

barinjëve, i besuan Musait dhe i folën atij. Për më tepër njëra nga femrat e luti babain e saj që të punësonte Musain duke e parë se ishte i fortë dhe i besueshëm:

Dhe njëra prej tyre tha: “Punëso atë, baba! Vërtetë që njeriu më i mirë për tu punësuar është dikush që është i fortë dhe mund t’i besosh.” (Kur’an, 28:26)

Me këto fjalë, vajza në mënyrë të qartë i shprehi babait të saj se ajo e konsideronte Musain si një njeri të besueshëm. I bindur për besueshmërinë e tij, plaku vendosi që të martojë vajzën e tij me Musain. Mirësjellja e dallueshme e Musait ishte faktori kryesor që ndikoi në vendimin e plakut, i cili ia bëri këtë propozim atij:

Ai i tha: “Vërtetë që unë dëshiroj që ti të marrësh për grua njërën prej këtyre dy bijave të mia me kusht që ti t’me shërbesh mua për tetë vjet të plota, por nëse i mbush dhjetë vjet, do të jetë një mirësi prej teje. Por nuk kam për qëllim që të vë në vështirësi. Nëse do Allahu, ti do t’me gjesh mua prej të drejtëve.” Ai (Musai) tha: “Kjo u vendos mes meje dhe teje. Cilindo prej afateve që unë i përmbush, nuk përbën padrejtësi për mua. Allahu është dëshmitar për çfarë po themi.” (Kur’an, 28:27-28)

Musai pranoi propozimin e plakut, i cili siç kuptojmë nga Kur’ani duhet të ketë qenë prej besimtarëve të vërtetë dhe filloi jetën e tij në Medjen. Kështu Zoti së pari e siguroi Musain duke bërë që ujërat e Nilit ta bartin atë tek Pallati i Faraonit pa u fundosur. Mandej, gjersa kishte jetën në rrezik në Egjipt, Ai e shpëtoi atë për të dytën herë dhe e udhëhoqi në një jetë të qetë në Medjen.

Ata që bëjnë vepra të mira do të shpërblehen me mirësi më të mëdha dhe s'do të kenë pse të frikësohen në atë Ditë. (Kur'an, 27:89)

ARRITJA E TIJ NË LUGINËN TUVA DHE FRYMËZIMI I PARË

Musai respektoj marrëveshjen që bëri me plakun dhe qëndroi në Medjen për shumë vite. Në fund të kohës së përcaktuar, domethënë, kur marrëveshjes i erdh fundi, Musai dhe familja e tij u larguan nga Medjeni. Gjatë udhëtimit, Musai pa një zjarr në largësi, në njërën anë të Malit Sinai, kah i cili po kalonte me familjen e tij. Musai mendoi se do të mund të sjellte një degë të ndezur nga zjarri për tu ngrohur ose të merrte ndonjë lajm që andej:

Pasi që Musai e kishte përmbushur afatin e përcaktuar dhe po udhëtonte me familjen e vet, vërejti një zjarr në njërën anë të Malit Tur. Ai i tha familjes së vet: “Qëndroni këtu, kam parë një zjarr. Mbase mund t’ju sjell që andej ndonjë lajm ose ndonjë degë të ndezur nga zjarri që të mund të ngroheni.” (Kur'an, 28:29)

(Kujto) kur Musai i tha familjes së vet: “Vërtetë që pashë një zjarr. Unë do t’ju sjell që andej ndonjë lajm ose së paku një degë të ndezur që të mund të ngroheni.” (Kur'an, 27:7)

Kujto) kur ai pa një zjarr dhe i tha familjes së tij: “Pritni këtu! Vërtetë që shoh një zjarr. Mbase mund t’ju sjell një degë që andej ose mbase gjë ndonjë udhëzim atje.” (Kur’an, 20:10)

Kjo ngjarje është treguese e edhe një tipari tjetër të karakterit shembullor të Musait. Musai është një person shumë i vëmendshëm, i cili me kujdes vlerëson çdo gjë që ndodh rreth tij. Ai e din që Zoti paracakton të gjitha ndodhitë në pajtim me një fat të caktuar dhe me urtësinë hyjnore. Për këtë arsye, Musai gjithmonë i mirëpret ngjarjet apo rrethanat e ndryshme duke shpresuar të nxjerrë ndonjë përfitim prej tyre. Vërejtja e zjarrit në mal dhe vlerësimi i situatës nga ai është mënyrë e të menduarit të veçantë të një besimtari vigjilent. Vendimi i tij që të shkoj vetëm duke lënë familjen prapa për t’u siguruar për sigurinë e tyre është gjithashtu një urtësi shembullore që iu dhurua nga Zoti.

BISEDA E ZOTIT ME MUSAIN (AS)

Kur Musa shkoi te zjarri në mal ai u mirëprit nga një ngjarje e mrekullueshme. Atij iu drejtua Zoti nga një shkurre. Aty, Zoti rrëfen për këtë frymëzim të parë në Kur’an si vijon:

Por kur arriti aty një zë e thirri atë nga ana e djathtë e luginës së bekuar, nga një shkurre: “O Musa! Unë jam Zoti yt, Zoti i gjithë botërave.” (Kur’an, 28:30)

Dhe kur arriti aty, një zë e thirri në emër: “O Musa! Unë jam Zoti yt. Zbathi këpucët (sandalet), se ti me të vërtetë që ndodhesh në luginën e shenjtë Tuva. Dhe Unë të kam zgjedhur ty, kështuqë

dëgjo mirë se çfarë të frymëzohet ty. Sigurisht që Unë, vërtetë Unë jam Allahu. Nuk ka zot tjetër pos Meje, kështuqë Më adhuro dhe plotëso rregullisht faljen e namazit për Përkujtimin T'im.” (Kur'an, 20:11-14)

Ky ishte frymëzimi i parë që Musai pranoi, që e nderonte atë si të dërguar të Zotit, rangi më i lartë që një genie njerëzore mund të arrij në këtë botë.

Një pikë e rëndësishme meriton vëmendje këtu; Zoti i drejtohet Musait...Zoti e thërret Musain nga një dru. Zoti ishte mjaft afër Musait sa t'i drejtohej atij drejtpërdrejt. E vërteta megjithatë është, Zoti është gjithnjë aq afër sa për t'ju drejtuar kujtdo. Për shembull, gjatë leximit të këtyre rreshtave, Zoti është afër teje. Është aq afër sa të flas me ty, të dëgjoj zërin tënd dhe t'ju bëj të dëgjoni zërin e Tij. Ai mund t'na dëgjoj edhe nëse ne pëshpërisim. Zoti rrëfen këtë fakt në Kur'an me këtë varg “Zoti është më afër njeriut se sa vet vena e qafës së tij.” (Kur'an, 50:16)

Pasiqë i tha Musait se zëri që dëgjon i takon Zotit të tij, Zoti e pyeti atë për shkopin e tij:

“Dhe ç'është ajo që ke në dorën tënde të djathtë, o Musa?” Ai u përgjigj: “Ky është shkopi im mbi të cilin unë mbështetem, me të cilin shkund gjethe nga pemët për delet e mia dhe më shërben edhe për punë të tjera.” (Kur'an, 20:17-18)

S'ka dyshim se Zoti e dinte çfarë Musai mbante në dorë. Megjithatë për ta udhëzuar Musain dhe për t'ia njoftuar atij urtësinë e Tij, Zoti i tha që ta hudh shkopin:

“Hidhe shkopin tënd!” Por kur ai e pa atë të përdridhej si të ishte gjarpër u kthye dhe iku dhe nuk shiqoi prapa...(Kur'an, 27:10)

Kur Musai pa shkopin e tij të shndërrohej në gjarpër e pushtoi frika. Megjithatë, kjo ngjarje ishte paraparë të jetë një mësim me anë të cilit Zoti mësoi Musain të mos frikësohej ndaj askujt përveç Tij dhe të mos i nënshtrohej askujt tjetër pos Tij:

...“Mos ke frikë Musa! Vërtetë që të Dërguarit nuk frikësohen para Meje.” (Kur’an, 27:10)

Ai tha: “Kape atë dhe mos ke frikë, Ne do ta kthejmë në gjendjen e mëparshme.” (Kur’an, 20:21)

Në pajtim me urdhërin, Musai muar shkopin e tij. Ky shkop më vonë do të bëhet një mrekulli që do të përdoret kundër Faraonit. Pas kësaj, Zoti i dha Musait mrekullinë e dytë:

Fute dorën tënde në gjë, do të dal plotësisht e bardhë dhe e padëmtuar fare...(Kur’an, 28:32)

Siç na njoftojnë vargjet e mësipërme, dora e Musait u shfaq plotësisht e bardhë, si një mrekulli nga Zoti. Musai u shqetësua dhe u ndje i frikësuar nga këto gjëra. Megjithatë, Zoti e urdhëroi të merrte veten dhe të shkonte me këto mrekulli te Faraoni:

...Dhe vëri duart në ije që të çlirohesh nga frika. Këto janë dy dëshmi nga Zoti yt për Faraonin dhe krerët e tij. Vërtetë që ata janë një popull në rrugë të gabuar. (Kur’an, 28:32)

MUSAI (AS) KËRKON HARUNIN (AS) SI SHOQËRUES TË TIJ

Përgjigjet e Musait ndaj frymëzimeve të Zotit janë përplot me shembuj të shumtë të sinqeritetit të tij. Musai i tha Zotit sinqerisht se kishte frikë, se ngurronte dhe ndjente pasiguri dhe kërkoi udhëzimin e Zotit. Për shembull, ai shprehi brengën e tij se do të mund të vritej nga ndonjë Egjiptian që kërkon hakmarrje, për shkak se kishte vrarë një Egjiptian tjetër. Ai gjithashtu tha se ishte i brengosur për paaftësinë e tij që të shprehej rrjedhshëm, duke u frikësuar se s'do të mund t'i drejtohej Faraonit ashtu si i takonte një të dërguari. Për këtë arsye kërkoi që vëllau i tij Haruni, që fliste më rrjedhshëm se ai, ta shoqëronte:

Ai tha: “Zoti im! Unë kam vrarë një njeri prej tyre dhe kam frikë se do t'më vrasin. Dhe vëllaun tim Harunin që është më i aftë në të shprehur se unë, dërgoje pra edhe atë me mua si ndihmues për t'më vërtetuar mua. Vërtetë se kam frikë se do t'më quajnë gënjeshtar.” (Kur'an, 28:33-34)

“Harunin, vëllaun tim. Ma shto fuqinë me të dhe bëje të ketë pjesë në detyrën time, që ne të lavdërojmë Ty shumë dhe të përkujtojmë Ty shumë.” (Kur'an, 20:30-34)

Prandaj, duhet të kuptojmë se arsyeja tjetër pse Musai kërkoi që Haruni të ishte shoqëruesi i tij ishte që t'i ndihmonte që më mirë të përkujtonte Zotin. Ai mendoi se shoqërimi nga një person tjetër do ta shtynte atë që ta lavdëronte dhe ta lartësonte Atë më shumë. Me të vërtetë, shoqërimi me besimtarë tjerë dhe inkurajimi shpirtëror reciprok i tyre janë thelbësore në shmangjen e pavëmendshmërisë, për të cilën arsye, në shumë vargje të Kur'anit, Zoti i këshillon besimtarët të

jenë të bashkuar. Ky është një mësim tjetër që besimtarët duhet ta nxjerrin nga tregimi për Musain.

Kërkesat e Musait u pranuan nga Zoti. Zoti shpalli se Harunit i ishte lejuar ta shoqëronte Musain në mënyrë që ta mbështeste atë në misionin e tij te Faraoni si edhe për t'i dhënë forcë atij:

Ai (Zoti) tha: “Padyshim që Ne do ta forcojmë krahun me vëllaun tënd dhe me anë të Shenjave Tona do t’ju japim të dyve fuqi, që ata të mos jenë në gjendje t’ju dëmtojnë ju. Ju të dy dhe ata që do t’ju ndjekin pas, do të jeni fitimtarë.” (Kur’an, 28:35)

Edhe një varg tjetër na rrëfen të njëjtën ngjarje si vijon:

Ai i tha: “O Zoti im! Ma hap mua gjoksin dhe lehtësoma detyrën time. Dhe zgjidhna nyjen nga gjuha (ma largo mangësinë e të shprehurit), që ata të kuptojnë fjalën time. Më cakto një ndihmës nga familja ime.” (Kur’an, 20:25-29)

(Musai i tha): “Vërtetë që Ti je për ne gjithnjë Gjithëvëzhgues .” Ai (Zoti) i tha: “Të është pranuar tashmë kërkesa, o Musa!” (Kur’an, 20:35-36)

Me vlerësimin e kërkesave të Musait, shohim se ai i shfaqti të gjitha dobësitë e tij vetjake me çiltërsi para Zotit dhe se u lut dhe kërkoi udhëzim nga Zoti. Çiltërsia e lutjes së tij është shembull për gjithë njerëzit. Njeriu duhet t'i lutet Zotit me përlutje dhe me sinqeritet duke qenë i vetëdijshëm se është i dobët dhe i kufizuar në praninë e Zotit, i Cili përmban gjithçka nën kontrollin e Tij të përgjithshëm. Zoti din gjithçka dhe dëshmon për secilën vepër në të cilën përfshihet njeriu. Për më tepër, Ai din edhe mendimet e njeriut. Duke qenë kështu, s'ka nevojë që të mbahet fshehur çkadoqoftë nga Zoti.

Si përfundim, secili duhet t'i drejtohet Zotit me sinqeritetin dhe zemërdëlirësinë që ai përndryshe s'do t'ia shfaqte njerëzve të tjerë.

HISTORIA E MUSAIT (AS) DHE FSHEHTËSIA E FATIT

Në Malin Sinai, Zoti i dha Musait lajmin e mirë se Ai do ta lejonte vëllaun e tij Harunin ta shoqëronte. Pastaj, Zoti ia përkujtoi Musait mirësitë që Ai më parë ia kishte dhuruar atij:

Dhe sigurisht që Ne të dhamë mirësi ty edhe një herë tjetër më parë, kur Ne frymëzuam nënën tënde, duke i thënë: “Vendose atë në arkë dhe hidhe në lum (det), pastaj lumi (deti) do ta nxjerrë në breg, ku një armik i Imi dhe i tij do ta marr atë.” Dhe Unë të brumosa ty me dashuri prej meje me qëllim që ti të rritesh nën mbikqyrjen (syrin) Time. Kujto kur motra jote shkoi dhe tha: “A t’ju tregoj unë një grua që do të kujdeset për të?” Kështu Ne të rikthyem te nëna jote, që asaj t’i qetësoheshin sytë dhe t’mos pikëllohej. Pastaj ishte ti që e mbyte një njeri dhe Ne të shpëtuan nga një fatkeqësi e madhe dhe të sprovuam me shumë sprova. Pastaj ti qëndrove disa vite në mesin e popullit të Medjenit. Pastaj ti erdhe në kohën e përcaktuar që Unë urdhërova për ty, o Musa! Dhe Unë të zgjodha ty për Veten Time. (Kur’an, 20:37- 41)

Këto vargje shfaqin fshehtësinë e fatit, për të cilin mjaft njerëz janë të pavetëdijshëm ose mezi e kuptojnë. Që nga koha kur ishte foshnje gjer në kohën kur ai ishte zgjedhur si i dërguar, Musai kaloi çdo moment të jetës së tij në pajtim me atë që Zoti paracaktoi për të në të kaluarën e përjetshme. Përbrenda këtij fati nuk ka asgjë tjetër përveç përmbushjes së vullnetit të Zotit. Për shembull, siç e thamë edhe më heret, me mijëra hollësi të çastit të paracaktuara nga Zoti për fatin e Musait bën të mundshme arritjen e arkës tek familja e Faraonit.

Është gjithashtu e mundshme për të parë shtrirjen në të cilën fazat e mëvonshme të jetës së Musait ishin përbrenda kufinjëve të fatit të tij. Musai përfshihet në një zënkë dhe ikë nga qyteti për në Medjen, ku ai takon dy gra. Këto gra s'mund t'u japnin deleve të pijnë ujë sepse iu shmangeshin barinjëve. Në këtë situatë, Musai iu ofroi ndihmë. Musai fitoi besimin e këtyre grave dhe si shpërblim për mirësinë e treguar, filloi një jetë të re në Medjen pas propozimit të babait të tyre plak. Kur erdh koha e përcaktuar, Musai lëshoi Medjenin me familjen e tij. Duke u kthyer, pa një zjarr ku atij iu drejtua Zoti dhe u zgjodh si i Dërguar i Zotit.

Arka që bartte Musain foshnje duke lundruar me hamendje nëpër lumin Nil, marrja e tij nga familja e Faraonit, rritja e tij në pallat, vrasja e paqëllimt që ai kryejti, ikja e tij nga Egjipti, takimi i tij me dy vajzat, shumë vite të kaluara me plakun, mënyra se si krijoi familje, kthimi në Egjipt, drejtimi i Zotit atij dhe hollësi tjera të panumërta të cilat nuk përmenden në Kur'an, të gjitha ndodhën në pajtueshmëri me fatin e Musait, që Zoti veçse kishte paracaktuar para lindjes së tij. As edhe një ngjarje e vetme nga këto ngjarje s'ka mundur të mos ndodhte apo të ndodhte ndryshe. Sepse jetërat tona janë të ngjashme me një film të xhiruar në një video kasetë; është e pamundshme të largohet edhe një tablo e vetme nga fati i një njeriu, sikur që s'mund të bëhet kjo

me një tablo nga shiriti filmik. Fati i një njeriu, me secilin moment të veçantë në të, është një tërësi e pacenueshme.

Gjithashtu në vargjet e cituara më lartë, përmendet fakti se udhëtimi i Musait në luginën e shenjtë të Tuvas ishte në pajtueshmëri të plotë me fatin e tij:

...Pastaj ti erdhe këtu në kohën e përcaktuar që Unë urdhërova për ty, o Musa! (Kur'an, 20:40)

Kjo çështje kërkon t'i dhurohet vëmendje e posaçme. Fati për të cilin bëhet fjalë këtu nuk është një gjë e veçantë vetëm për Musain. Lindja e Musait ishte pjesë e fatit të nënës së Musait. Që ajo do të lindte Musain në një ditë të caktuar dhe bile edhe në një orë të caktuar, ishte gjithashtu pjesë e fatit të saj. Por nëna e Musait kishte prindër gjithashtu. Ishte fati i nënës së nënës së Musait ta lindte atë. Kjo mënyrë e të menduarit gjithashtu vlen edhe për babain e Musait dhe për anëtarët e tjerë të familjes së tij.

Zdrukthëtari i cili punoi arkën që barti Musain teposhtë lumit gjithashtu konstruktoi atë sepse në fatin e tij ishte paracaktuar që ai ta bënte këtë. Punimi i arkës nga ai ishte paracaktuar për të para se ai të lindte. Prindërit e këtij zdrukthëtari gjithashtu jetuan jetët e tyre në harmoni me një fat të caktuar.

Le të marrim parasysh zënkën në të cilën u përfshi Musai. Kjo zënkë ndodhi po në atë moment kur Musai ndodhi të ishte aty. Nga një pikëpamje më e thjeshtësuar, njeriu do të mund të thoshte, “po të kishte ndodhur kjo në një kohë tjetër, Musai s’do të kishte qenë atje dhe ngjarjet do të kishin marrë një rrjedhë krejt tjetër.” Megjithatë ky do të ishte një vlerësim i gabueshëm. Zënka ndodhi po në atë moment që duhej të ndodhte dhe u zhvillua në atë mënyrë si duhej të

zhvillohej. Arsyeja për këtë është se edhe zënka ishte e paracaktuar nga Zoti. E njëjta rregull e fatit gjithashtu vlen edhe për pjesëmarrësit e tjerë në zënkë, arsyet që shkaktuan zënkën, si edhe njeriu që e këshilloi Musain të ikë nga qyteti, duke i treguar se po bëhej konspiracion kundër tij. Në fund të fundit, edhe barinjët afër lumit të Medjenit, si edhe dy femrat që Musai i takoi, të gjitha këto përbënin pjesët e domosdoshme të këtij fati.

Janë profetët e Zotit ata që më së miri kuptuan faktin se gjithçka ndodhë sipas urdhërave të paracaktuara nga Zoti. Profeti Muhamed (saas), i cili është një shembull i shkëlqyeshëm për të gjithë besimtarët ka thënë:

Nëse të ndodhë ndonjë fatkeqësi, mos thuaj: “Vetëm po të kisha vepruar në këtë apo në atë mënyrë, do të kishte qenë kështu apo ashtu;” por më mirë thuaj: “Zoti e ka urdhëruar (këtë) dhe ka bërë çfarë Ai ka dashur, sepse vërtetë, (fjala) (nëse) i hap udhën të bërave të Shejtanit.” (Muslim)

Kur të vlerësohen të gjitha këto së bashku, bëhet e qartë se jo vetëm Musai, por gjithashtu edhe gjithçka që kishte të bëj me jetën e tij e krijoi një pjesë të fatit të tij. Një vlerësim më i thellë dhe më i detajuar do t’na ndihmonte të kuptojmë se ne të gjithë jemi pjesë të të njëjtit fat. Në jetërat tona, ne gjithashtu i ekspozohemi ngjarjeve të paracaktuara në të kaluarën e përjetshme nga Zoti i gjithëfuqishëm. Ne të gjithë ishim të lidhur me fatin e paracaktuar për ne. Momenti i vdekjes sonë do të jetë gjithashtu pjesë e të njëjtit fat. Fati është në realitet një dituri hyjnore që rrethon gjithçka ekziston. Sikurse të gjitha hollësitë e jetës së Musait, duke përfshirë edhe bërjen e tij të dërguar, ishin të paracaktuara për të, të gjitha hollësitë që lidhen me jetërat e gjithë njerëzimit, sikur edhe vet jetërat tuaja, të gjitha janë të paracaktuara. Për më tepër, fakti që ju do ta lexoni

këtë libër dhe të informoheshit për jetën e Musait ishin të gjitha të paracaktuara për ju shumë kohë para se të lindte Musai. Fati është një tërësi në vetvete dhe mbulon gjithçka. I lirë nga vullneti i çfarëdo qenieje tjetër përveç Allahut, fati përcaktohet vetëm nga Ai. (Për më shumë informacion ju lutemi t'i referoheni librit *Përjetshmëria dhe Realiteti i Fatit* dhe *Përjetshmëria tashmë ka filluar* të të njëjtit autor).

PËRCJELLJA E POROSISË FARAONIT DHE MËNYRA E DUHUR NË TË CILËN KJO DUHET TË BËHEJ

Zoti paralajmëroi Musain dhe Harunin para se të vizitonin Faraonin dhe ju tërhoqi vëmendjen që gjithnjë ta përkujtonin Atë dhe që t'mos prajnë së përkujtuari Atë:

“Shko, ti dhe vëllau yt, me Shenjat e Mia dhe mos u bëni të plogësht e të dobët në të përmendurit Mua.” (Kur’an, 20:42)

Zoti urdhëroi Musain dhe Harunin që të shkonin te Faraoni, sunduesi i Egjiptit. Zoti ju shpjegoi atyre se Faraoni ishte i pacipë dhe grindavec, por megjithatë, Ai i urdhëroi ata të përdornin një mënyrë të butë të komunikimit të porosisë së Tij tek ai:

“Shkoni të dy te Faraoni, se vërtetë ai i ka tejkaluar gjithë kufijtë (në mosbesim). Dhe i flisni atij butë e shtruar, mbase mund të marr qortim ose të frikësohet (prej Meje).” (Kur’an, 20:43-44)

Siç u theksua në vargjet më lartë, përdorimi i një gjuhe të këndshme është një qasje tejet e dobishme që do të duhej gjithnjë të përdorej gjatë komunikimit të fesë. Në shumë vargje të Kur'anit, rëndësia e zgjidhjes së fjalëve të buta theksohet si një rregull i përgjithshëm. Në të vërtetë, Zoti e urdhëron njeriun të flas me butësi bile edhe kur ai me të cilin flet është mendjemadh, duke e bërë të qartë rëndësinë e përdorimit të sjelljes së tillë në komunikimin e porosisë së Zotit.

Në këtë urdhër të Zotit, Musai edhe njëherë hapur shprehi frikën që ndjente në zemër. Ai i tha Zotit për brengosjen e tij, domethënë, për frikën se mund të vritej nga Faraoni:

Ata i thanë: “Zoti ynë. Në të vërtetë ne kemi frikë mos ai shpejton t’na ndëshkojë ose se mos i tejkalon kufijtë (në mosbesim apo kundër nesh).” (Kur’an, 20:45)

Ai (Musai) tha: “Zoti im! Unë kam vrarë një njeri prej tyre dhe kam frikë se do t’më vrasin.” (Kur’an, 28:33)

Këtu Zoti edhe njëherë e përkujtoi Musain se Ai ishte me të, duke shikuar dhe dëgjuar gjithçka që ai bënte. Për më tepër, Zoti i urdhëroi Musait dhe Harunit të shkojnë te Faraoni dhe të kërkojnë prej tij që t’i lejoj bijtë e Izraelit të largohen:

Shkoni pra te ai dhe thuani: “Me të vërtetë që ne jemi të Dërguarit e Zotit tënd, kështu që lëre fisin e Izraelit të vij me ne dhe mos i ndëshko ata. Ne të kemi sjellur ty një Shenjë nga Zoti yt. Paqja qoftë mbi ata që ndjekin udhëzimin.” (Kur’an, 20:47)

Vlen të përmendim se nuk sprovohej këtu vetëm Faraoni. Kjo gjithashtu ishte edhe provë për Profetin Musa. Musai i frikësohej mundësisë së vrasjes nga Faraoni. Megjithatë, çfarë kërkonte

Zoti nga Musai ishte më shumë se thjeshtë një vizitë te Faraoni; Musai do të shkonte të kërkonte nga Faraoni që të gjithë Izraelitët të largoheshin me të. Të shkosh para sunduesit të padiskutueshëm të Egjiptit, të cilit i gjithë kombi i nënshtrohej si një hyjnie, ishte me të vërtetë një detyrë shumë e rrezikshme. Edhe më e rrezikshme ishte t'i thuhej Faraonit në mënyrë të qartë se ai ishte në rrugë të gabuar dhe pastaj t'i kërkohej t'i japte lirinë një kombi të robëruar, domethënë të bijve të Izraelit. Sidoqoftë, të vetëdijshëm se ishin nën mbrojtjen e plotë të Zotit, Musai dhe Haruni vazhduan detyrën e tyre me sigurinë dhe lehtësinë që Zoti ynë ua dhuroi atyre. Zoti i përkujtoi ata për këtë të vërtetë, duke i urdhëruar që t'mos frikësoheshin:

Ai (Allahu) u tha: “Mos u frikësoni. Padyshim që Unë jam me ju duke dëgjuar dhe shikuar çdo gjë.” (Kur'an, 20:46)

Ftoji në Udhën e Zotit tënd me urtësi dhe me thirrje të ndershme dhe të bukur dhe bisedo me ta në mënyrën më të mirë. Nuk ka dyshim se Zoti yt e di më së miri se kush është larguar e ka humbur nga Rruga e Tij dhe Ai është me i Dituri për ata që janë udhëzuar. (Kur'an, 16:125)

GJYKIMI I SH TREMBËRUAR I FARAONIT

Në Malin Sinai, së bashku me frymëzimin, Musait iu dhurua një urtësi e madhe nga Zoti ynë. Atje Zoti ia ndriçoi mendjen Musait në veçanti në lidhje me dy çështje: fatin dhe mbështetjen e njeriut në Zotin. Musai kishte kuptuar se e gjithë jeta e tij kishte qenë përbrenda kufijve të një fati të përcaktuar dhe kishte ndjekur rrugëtimin e tij në pajtim me atë fat. Gjithashtu, ai kishte kuptuar

se s'duhej të kishte frikë nga Faraoni, por duhej të kishte besim në Zotin sepse Zoti është me të, e sheh atë dhe i ndihmon atij. Me këtë bindje, Musai dhe Haruni kishin shkuar te Faraoni dhe paria e tij e ngusht, të cilëve Kur'ani iu referohet si “një popull keqbërës”:

Më vonë pas tyre Ne dërguam Musain dhe Harunin me Shenjat Tona te Faraoni dhe prijësit e tij, por ata u sollën me arrogancë dhe qenë njerëz keqbërës (mosbesimtarë, mëkatarë). (Kur'an, 10:75)

Dialogu mes Musait dhe Faraonit rrëfhet në Kur'an. Një vlerësim i hollësishëm i përgjigjeve që Faraoni i dha Musait zbulon mënyrën e tij tejet të paarsyeshme dhe joracionale të të menduarit. Nga ajo që ai tha ne kuptojmë se në vend që të merrte parasysh fjalët e Musait ai kërkonte rrugë për ta mposhtur atë dhe për ta akuzuar. Për këtë qëllim, Faraoni u përpoq që të bindte njerëzit rreth tij ose të impononte arsyen e tij të shtrembëruar tek të tjerët. Dialogu mes Musait dhe Faraonit ishte si vijon:

Faraoni tha: “Kush është pra Zoti juaj, o Musa?”

Ai (Musai) tha: “Zoti ynë është Ai i Cili i dha çdo gjëje që krijoi formën dhe llojin e vet (me krijim të përsosur) dhe pastaj e udhëzoi drejt.”

Ai (Faraoni) tha: “Po për brezat e parë, ç'thoni atëherë?”

Ai (Musai) tha: “Dija për ta është me Zotin tim në shkresën e duhur. Zoti im as nuk është i pavetëdijshëm dhe Ai as nuk harron.”

Ai është i Cili e ka bërë tokën për ju si shtrat (të shtrirë) dhe ka hapur në të për ju rrugë e lidhje, ka zbritur edhe ujë nga qielli me anë të të cilit Ne kemi nxjerrë lloj-lloj bimësie (secila në llojin e vet). Hani ju dhe kullotni bagëtinë tuaj në të. Vërtetë që këtu ka Shenja e prova për njerëzit e brumosur me arsye. Prej saj (tokës) Ne ju kemi krijuar dhe atje Ne do t'ju kthejmë ju, dhe prej saj Ne do t'ju nxjerrim përsëri edhe njëherë tjetër. (Kur'an, 20:49-55)

Në vend se të vlerësonte këtë porosi me mendje të shëndoshë dhe ndërgjegje të pastër, Faraoni dhe paria e tij e vlerësuan duke u mbështetur në mënyrën e tyre të zakonshme të të menduarit, të bazuar në religjionin e të parëve të tyre. Sipas besimeve të tyre të kota, Faraoni ishte hyjni, larg prej pranimit të idesë së ekzistencës së Zotit:

Por kur Musai ua solli atyre Shenjat Tona të Qarta, ata thanë: “Kjo nuk është asgjë tjetër veçse magji e trilluar. Ne kurrë s’kemi dëgjuar për diç të tillë nga baballarët tonë të parë.” (Kur'an, 28:36)

Siç bëhet e qartë në vargun e mësipërm, populli i Faraonit mendonin se qëllimi i Musait me shpalljen e ekzistencës dhe njësisë së Zotit, ishte për të fituar fuqi në tokë, duke shfuqizuar sistemin e trashëguar nga të parët e tyre. Religjioni i vjetër i japte të drejtë Faraonit dhe parisë së tij për përparësi të qarta dhe ndryshimi i këtij religjioni nënkuptonte humbjen e fuqisë së Faraonit dhe zhvendosjen e autoritetit tek Musai. Prandaj, ata besuan se Musai thjeshtë kishte ardhur që të shtypte popullin, në të njëjtën mënyrë si Faraoni. Kjo formë e kufizuar e të kuptuarit të tyre më së miri shprehet në përgjigjen që Musai dhe Haruni morën nga Faraoni dhe paria e tij:

Ata thanë: “A ke ardhur te ne t’na largosh nga ai besim të cilin i gjetëm baballarët tonë ta ndjekin dhe që ju të dy të mund të kenë madhështi në tokë? Ne nuk do t’ju besojmë ju të dyve.” (Kur’an, 10:78)

Megjithatë, akuza e shprehur në fjalët ”A keni ardhur te ne për të përfitur madhështi (pushtet) në tokë” nga Faraoni dhe pasuesit e tij ishte thjeshtë një tentim shpifjeje pa ndonjë arsytim të sinqertë. Qëllimi i Musait ishte larg dëshirës së tij për të sunduar Egjiptin; ai vetëm kishte kërkuar nga Faraoni që të lejonte fisin Izraelit të largohej nga Egjipti me të. Kërkesa e Musait ishte lirimi i bijve të Izraelit, një kombi të robëruar që ishin duke jetuar në kushte të mjerueshme:

Musai tha: “O Faraon! Vërtetë unë jam i Dërguar nga Zoti i gjithë botërave, i detyruar të them për Allahun vetëm të vërtetën e asgjë tjetër. Padyshim që unë kam ardhur tek ju nga Zoti juaj me Shenjë të Qartë, kështu që lëre fisin e Israilit të largohet bashkë me mua.” (Kur’an, 7:104-105)

Megjithatë, Faraoni duke refuzuar kërkesën e tij, provoj mënyra tjera të ndryshme kundër Musait. Një nga këto hile ishte shpërdorimi emocional. Duke ia përkujtuar Musait se si ishte rritur në pallat, u përpoq ta përkujtonte atë për besnikërinë që ai ia kishte borxh atij dhe parisë së tij. Për më tepër, ai u përpoq ta detyronte atë duke ia përmendur burrin Egjiptian që ai kishte vrarë paqëllim. Reagimi i Musait ndaj gjithë këtij keqtrajtimi ishte një reagim i veçantë për një besimtar të vërtetë i cili pa kushte i nënshtrohet fatit të tij dhe është plotësisht i vetëdijshëm për pasojat:

Ai (Faraoni) tha: “A nuk të rritem ne ty në mesin tonë si fëmijë dhe a nuk kalove shumë vite të jetës tënde me ne? Prapseprap ti bërë atë që bërë (krim duke vrarë një njeri) dhe ishe mosmirënjohës.”

Ai (Musai) tha: “Atë e bëra atëherë kur isha në padije (për Zotin tim dhe Mesazhin e Tij), kështuqë ika prej jush kur kisha frikë nga ju, por Zoti im më dha mua gjykimin e drejtë (urtësinë, pejgamberinë) dhe më bëri prej të Dërguarve të Tij.” (Kur’an, 26:18-21)

Musai i shpjegoi Faraonit se rritja e tij në pallat nuk ishte një mirësi por pasojë e shtypjes së tij të egër:

Dhe kjo është mirësi e kaluar me të cilën ti më qortove mua, ti që ke skllavëruar fisin e Israilit! (Kur’an, 26:22)

Përkundër çfarëdo ngurrimi që mund të kishte ndier më parë, Musai ia përcolli porosinë pa u trembur dhe haptazi Faraonit dhe parisë së tij sunduese, i vetëdijshëm se Zoti e kishte përkujtuar atë për shoqërimin e Tij. Faraoni së pari pyeti Musain për Zotin tonë:

Faraoni tha: “E çfarë është Zoti i gjithë botërave?”

Ai (Musai) tha: “Zoti i qiejve dhe tokës dhe i gjithçkaje që ndodhet ndërmjet tyre, nëse doni të bindeni plotësisht.”

Ai (Faraoni) u tha njerëzve përreth tij: “A nuk e dëgjoni se çfarë thot?”

Ai (Musai) u tha: “Zoti juaj dhe Zoti i të parëve tuaj, i popujve të mëparshëm.” (Kur’an, 26:23-26)

Në përgjigjen e tij, Musai ishte duke shpjeguar se religjioni i të parëve të Faraonit ishte i pavlefshëm ngase edhe ata ishin gjithashtu mëkatarë. Allahu ishte Zot i atyre gjithashtu. Duke mos pasur ç’ të thoshte në këtë, Faraoni iu kthye shpifjeve dhe kërcënimeve ndaj Musait:

Ai (Faraoni) tha: “Vërtetë që i Dërguari që është sjellë tek ju është i çmendur.”

Ai (Musai) u tha: “Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit dhe i gjithçkaje që ndodhet ndërmjet tyre, veç sikur ta kuptonit (të mendonit).”

Ai (Faraoni) i tha: “Nëse ti zgjedhë zot tjetër përveç meje, sigurisht që do të fus në burg.” (Kur’an, 26:27-29)

Siç shihet, shpjegimet e ngjeshura të Musait dhe shenjat e qarta e vunë Faraonin në pozitë të vështirë, gjë që e shtyri atë të akuzonte Musain për çmendri. Brenga parësore e Faraonit këtu ishte që t’i kundërpërgjigjej ndikimit të fuqishëm që Musai po ushtronte në njerëz. Mënyra e çiltër dhe bindëse e fjalimit të Musait e xhindosi Faraonin. Në fund ai iu kërcënua Musait me burgim poqese do të vazhdonte të mohonte hyjninë e tij. Ky veprim ishte thjeshtë një shfaqje tjetër e karakterit të egër të Faraonit.

Në këtë pikë, Musai deklaroi se kishte ardhur me shenja që dëshmonin pejgamberinë (profecinë) e tij dhe i demonstroi dy mrekullitë që Zoti ia dhuroi:

Ai (Musai) i tha: “Edhe sikur të sjell ndonjë gjë të qartë dhe të pamohueshme?”

Ai (Faraoni) tha: “Sille pra atë nëse vërtetë flet të drejtën.”

Kështu ai (Musai) hodhi shkopin, kur ç’të shohësh, ai u shndërrua në një gjarpër të vërtetë. Dhe nxori dorën e tij, kur ç’të shohësh, ajo ishte plotësisht e bardhë në sy të të gjithë shikuesve. (Kur’an, 26:30-33)

Faraoni dhe paria e tij që po shihnin me sytë e tyre dy mrekullitë e mëdha të Zotit të demonstruara nga dora e Musait, menduan se ato mund të realizoheshin vetëm me anë të magjisë.

Për t'mos pranuar se ishin magjepsur nga këto mrekulli, e bindën njëri tjetrin të mendojnë në këtë mënyrë:

Ai (Faraoni) u tha krerëve rreth tij: “Vërtetë që ky është një magjistar tepër i ditur i cili dëshiron t’ju largoj nga toka juaj me magjinë e tij. Atëherë çfarë këshille jepni dhe çfarë urdhëroni?” (Kur’an, 26:34-35)

Mendësia e ilustruar këtu është tipike për ata të cilët e mohojnë të vërtetën. Në shumë rrëfime që rrëfehen në Kur’an, ekzistojnë shembuj të shumtë të njerëzve të ngjashëm dhe të përgjigjeve të tyre që dëshmojnë një përsiatje të mangët. Kjo gjendje mendore, e nënshtruar verbërisht në ndjekjen e besimit të të parëve të tyre dhe në mohimin e të vërtetës përkundër shenjave të qarta, nuk ishte e veçantë vetëm për Faraonin dhe parinë e tij. Gjatë historisë, mohuesit gjithnjë kërkonin rrugë të ngjashme shpëtimi. Bindjet e një personi mendjemadh rrëfehen kështu në Kur’an:

Unë do ti largoj nga Shenjat e Mia të gjithë ata që do të sillen me kryelartësi dhe me kundërshti në tokë pa asnjë të drejtë. Por edhe sikur ata t’i shohin të gjitha Shenjat, ata s’do t’i besojnë ato. Edhe sikur ta shohin rrugën e udhëzimit të drejtë, ata përsëri nuk do ta bëjnë për vete atë (si udhe të tyre). Por nëse ata shohin udhën e gabuar, kjo është udha që ata do të përqafojnë...(Kur’an, 7:146)

Faraoni dhe paria e tij parapëlqenin në mënyrë të qartë të ndjeknin udhën e mohimit dhe të keqes në vend se të zgjidhnin të jenë të udhëzuar drejtë. Përkundër këtyre mrekullive, ata vendosën që t’i kundërvihen Musait. Për këtë qëllim, ata kërkuan të ashtuquajturit kundërshtarë të Musait, për të cilin besuan se ishte një “magjistar”:

Ata thanë: “Ndaloni atë dhe vëllaun e tij dhe dërgoni lajmetarë në gjithë qytetet të sjellin magjistarët më të ditur.” (Kur’an, 7:111-112)

Faraoni pohonte se mrekullitë e Musait ishin iluzione magjistari dhe besonte se mund të çbëheshin nga magjistarët e tij. Prandaj, planifikoi të mposhte Musain për të rifituar epërsinë e tij. Ai mund të kishte vrarë Musain dhe Harunin. Megjithatë, duke shpresuar për një fitore më madhështore dhe më jetëgjatë, ai pranoi këshillën e atyre rreth tij. Kjo i dukej e logjikshme atij. Në të vërtetë, ata megjithatë ishin të dënuar që të përjetonin një disfatë të plotë nga Zoti. Për më tepër, disfata e tyre pasoi ashtu sikur askush nuk e priste.

Të sigurt në fitoren e tyre përfundimtare, ata lejuan Musain të përcaktonte kohën dhe vendin për ballafaqim:

Ai (Faraoni) tha: “A ke ardhur t’na largosh ne nga toka jonë me magjinë tënde, o Musa? Atëherë sigurisht që ne mund të sjellim të njëjtën magji si e jotja. Na cakto një takim mes nesh dhe teje që as ne as ti t’mos dështojmë t’i përmbahemi në një vend të hapur ku të dy palët do të kenë mundësi e rast të barabartë (dhe ku shikuesit do të dëshmojnë garën).”

Ai (Musai) tha: “Takimi juaj është dita e festës. Dhe njerëzit do të duhej të mblidhen paradite.” (Kur’an, 20:57-59)

Musai zgjodhi “ditën e festës” në mënyrë që të gjithë njerëzit të mund t’ishin dëshmitarë të ballafaqimit. Kjo ishte me të vërtetë një zgjidhje e mençur; në këtë mënyrë, të gjithë njerëzit do të dëgjonin porosinë e Musait dhe do të ishin dëshmitarë të disfatës së Faraonit dhe të magjistarëve të tij. Faraoni pranoi kohën e caktuar:

Kështu Faraoni u tërhoq, thurri grackën e tij dhe pastaj u kthye prap.

Musai u tha atyre: “Të mjeret ju! Mos trilloni gënjeshtër kundër Zotit, që Ai t’mos ju shkatërrojë plotësisht me ndëshkimin e Tij. Dhe vërtetë që trilluesit e gënjeshtërave do të dështojnë sa s’ka më keq.”

Pastaj ata e rrahën mirë çështjen mes tyre për atë që duhej të bënin, por e mbajtën të fshehtë fjalën e tyre.

Ata thanë: “Vërtetë që këta të dy janë magjistarë dhe dëshirojnë që t’ju dëbojnë nga toka juaj me magji dhe të zhvlerësojnë mënyrën tuaj të shkëlqyer të jetesës, kështuqë bashkërendoni përbetimin tuaj dhe pastaj vihuni në rradhë dhe do të jetë vërtetë triumfues ai që fiton epërsi këtë ditë.” (Kur’an, 20:60- 64)

TITUJT E SUNDUESVE EGJIPTIANË NË KUR’AN

Musai nuk ishte profeti i vetëm që kishte jetuar në Egjiptin e lashtë. Profeti Jusuf gjithashtu kishte jetuar në Egjipt shumë kohë para Musait.

Në rrëfimet për Musain dhe Jusufin në Kur’an ndeshemi me një element që vlen të përmendet. Për t’ju referuar sunduesit të Egjiptit në kohën e Jusufit, fjala “malik” (Mbreti) përdoret në Kur’an:

E mbreti (Malik) tha: “Ma sjellni atë (Jusufin) menjëherë që ta mbaj pranë meje.” Kur i foli atij (Jusufit) i tha: “Vërtetë që këtë ditë ti qëndron lartë në radhët tona dhe plotësisht i besuar.” (Kur’an, 12:54)

Në kohën e Musait, megjithatë, sunduesit të Egjiptit i referohet me emrin “Faraon”:

Vërtetë që Ne i dhamë Musait më parë nëntë Shenja të qarta. Pyetni atëherë Bijtë e Izraelit kur ai shkoi tek ata dhe Faraoni i tha: “O Musa! Më duket se ti me të vërtetë je i magjepsur.” (Kur’an, 17:101)

Të dhënat historike të disponueshme tani japin shpjegime për emërtimet e ndryshme të përdorura për të emëruar këta dy sundues të Egjiptit. Në Egjiptin e lashtë, emërimi “Faraon” fillimisht i referohej pallatit mbretëror. Gjatë sundimit të mbretërive të lashta, sunduesit nuk kishin një titull të tillë. Emri “Faraon” filloi të përdorej si një sinonim për mbretin Egjiptian nën Mbretërinë e Re (duke filluar me dinastinë e 18të, 1539-1292 p.e.r.), dhe që nga dinastia e 22-të përdorej si një epitete i respektit.¹

Prap këtu, edhe njëherë dëshmohen cilësitë e mrekullueshme të Kur’anit. Pasiqë Profeti Jusuf jetoi shumë kohë para Mbretërisë së Re, Kur’ani i referohet mbretit Egjiptian që ishte bashkëkohës i Jusufit me emrin “malik” e jo me emrin “faraon.” Në anën tjetër, Musai jetoi në kohën e Mbretërisë së Re dhe prandaj, sunduesit të Egjiptit që ishte bashkëkohës i Musait i referohet në Kur’an me emrin “faraon.”

Në mënyrë të qartë, një dallim i tillë nënkupton një njohje të historisë së Egjiptit të lashtë. Megjithatë, siç u përmend më heret, historia e Egjiptit të Vjetër u harrua plotësisht në shekullin e

4të, pasi që shkrimi me hieroglifë nuk u deshifrua gjer në shekullin e 19të. Prandaj, gjatë periudhës kohore në të cilën u shpall Kur'ani, nuk ishte e disponueshme një njohuri e thellë e historisë së Egjiptit. Ky fakt është edhe një pjesë tjetër e dëshmisë, në mesin e dëshmive të panumërta, që vërtetojnë faktin se Kur'ani është Fjala e Zotit.

LUFTA E MUSAIT (AS) KUNDËR MAGJISTARËVE

Magjistarët erdhën tek Faraoni nga të gjitha anët e Egjiptit për të shfaqur magjinë e tyre kundër Musait. Faraoni ishte i sigurt për fitoren e tij përfundimtare. Me një ballafaqim të suksesshëm, do të sigurohej autoriteti i Faraonit dhe parisë së tij. Në anën tjetër, magjistarët ishin kurreshtarë të dinin shpërblimin që do të merrnin për disfatën që do t'i shkaktonin Musait:

(Ata thanë) “Të sjellin para teje të gjithë magjistarët më të ditur.”

Dhe kështu erdhën magjistarët te Faraoni dhe pyetën: “A do të ketë për ne një shpërblim të mirë nëse dalim fitimtarë?”

Ai (Faraoni) ju tha: “Po, dhe për më tepër, ju do të jeni pas kësaj më të afërmit tek unë.” (Kur'an, 7:112-114)

Faraoni po e shfrytëzonte rastin që të konsolidonte autoritetin e tij, gjersa magjistarët menduan se duke qenë të nderuar me të qenit “të afërt” me Faraonin, do të kishin përfitime të caktuara.

Magjistarët më të ditur të Egjiptit u sollën kundër Musait dhe Harunit. Nga Musai u kërkua që të vendoste se kush do të fillonte i pari:

Ata thanë: “O Musa! A do të hedhësh ti i pari apo të jemi ne të parët që do të hedhim?”

Ai (Musai) tha: “Jo, hidhni ju më parë!” Dhe befas, litarët dhe shkopinjtë e tyre, prej magjisë së tyre, iu dukën atij sikur rrëshqitnin me shpejtësi. (Kur’an, 20:65-66)

Kur magjistarët shfaqën magjinë e tyre, dukej se litarët dhe shkopinjtë e tyre rrëshqitnin. Siç merret vesh nga ky varg, të gjithë ishin të mashtruar duke parë litarët dhe shkopinjtë sikur lëviznin vetvetiu.

Një gjë meriton vëmendje këtu: në vargun e mësipërm, ndeshim shprehjen “i u dukën sikur rrëshqitnin me shpejtësi.” Ky formulim tregon se ato në të vërtetë nuk lëviznin, por kështu i parafytyrohej publikut. Në një varg tjetër, natyra iluzore e kësaj ngjarje shpjegohet në këtë mënyrë:

Ai (Musai) ju tha: “Hidhni ju të parët.” Kështu kur ata hodhën (magjinë e tyre), ata i magjepsën sytë e tyre duke u futur tmerrin atyre. Ata vërtetë paraqitën një magji marramendëse. (Kur’an, 7:116)

Me iluzionet e tyre, magjistarët e Faraonit përfituan publikun. Ata ngritën pushtetin e tij me magjitë që i shfaqën, gjë që ata e bën kinse “me fuqinë e Faraonit.” Faraoni, nga ana e tij, ju ofroj përfitime financiare. Shkurtimisht, marrëdhënia e tyre ishte e dobishme për të dyja anët.

Në përballjen e tyre me Musain, magjistarët ishin plotësisht të vetëdijshëm se Faraoni nuk posedonte kurrfarë fuqie hyjnore. Megjithatë, vetëm nga dëshira që të jenë “pranë” për t’i gëzuar përfitimet që do të delnin nga kjo, ata hüdhen shkopinjtë e tyre. Kështu vepruan shumë të sigurt për epërsinë e tyre mbi Musain, gjë që edhe e shprehën:

Kështu ata hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre dhe thanë: “Me fuqinë e Faraonit, vërtetë që ne do të jemi fitimtarë.” (Kur’an, 26:44)

Edhe pse mashtruese, shfaqja e magjistarëve impresionoi masën. Siç shkruan në Kur’an, njerëzit u tmerruan. Musai u impresionua gjithashtu; iu fut tmerrri në zemër pasi që litarët dhe shkopinjtë e magjistarëve iu dukën edhe atij sikur rrëshqitnin me shpejtësi. Megjithatë, Zoti përkujtoi Musain që t’mos frikësohej:

Musai përjetoi një ndjenjë frike në vetvete. Ne i thamë: “Mos u frikëso! Sigurisht që ti do të kesh epërsi. Hidhe atë që ke në dorën tënde të djathtë! Ai do të përpijë të bërat e tyre. Ajo që ata kanë bërë është veçse një mashtrim magjistari dhe magjistari s’do të jetë kurrë fitimtar, sado aftësi që mund të arrijë.”

I nxitur nga ku përkujtim i Zotit, Musai menjëherë iu drejtua magjistarëve duke ju thënë se shfaqja e tyre ishte një magji e kulluar që do të zhvlerësohej me vullnetin e Zotit:

Kur ata shfaqën magjinë e tyre, Musai u tha: “Ajo që ju keni sjellë është magji. Allahu padyshim do ta asgjësojë atë (do ta zhvlerësojë). Vërtetë që Allahu nuk e drejton punën e të korruptuarve (keqbërësve).” (Kur’an, 10:81)

Pastaj Musai hodhi shkopin e tij. Përfundimi i kësaj ishte i tmerrshëm për magjistarët. Shkopi I Musait përpiu magjinë e magjistarëve të Faraonit:

Dhe Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): “Hidhe ti shkopin tënd.” Dhe ç’te shohësh! Ai i përpiu menjëherë gjithë magjitë mashtruese që ata trilluan. Kështu e vërteta doli në shesh dhe gjithçka që ata punuan u asgjësua plotësisht. Në këtë mënyrë ata u thyen atje dhe u kthyen të turpëruar (e tepër të poshtëruar). (Kur’an, 7:117-119)

Ndryshe nga mashtrimet iluzore të magjistarëve, Musai bëri një mrekulli të vërtetë me shkopin e tij. Magjistarët kishin thurur komplot kundër Musait. Megjithatë, Allahu, thurësi më i mirë i kompleteve, ndihmoi Musain me një plan që plotësisht zhvlerësoj mashtrimet e tyre. Kështu, komplotet e magjistarëve veçse punuan në dëm të tyre. I pajisur me fuqi të mbinatyrshme nga Zoti, shkopi bëri një mrekulli të vërtetë.

Si rrjedhojë, ndryshe nga se është pritur, Musai mposhti magjistarët. Kështu, të gjithë ishin dëshmitarë se premtimi i Zotit ishte i vërtetë. Zoti nuk e la Musain vetëm dhe me anë të kësaj mrekullie, e bëri atë fitimtar mbi një prej sistemeve më të fuqishme të kohës së tij.

MAGJISTARËT PËRQAFOJNË BESIMIN

Rezultati i ballafaqimit ishte krejtësisht i papritur për Faraonin, për magjistarët si edhe për shikuesit. Magjistarët që ishin aq të sigurt dhe kryelartë për superioritetin e tyre, ishin mundur.

Për më tepër, kjo humbje e plotë ndodhi mu para syve të popullit të Egjiptit. Efekti i humbjes ishte madje edhe më i madh për magjistarët. Shfaqja e tyre, e cila ishte thjeshtë një iluzion, ata e dinin shumë mirë që s'ishte e vërtetë. Ata kishin sajuar mashtrime për të mashtruar njerëzit për të besuar se sistemi i tyre – dhe si rrjedhojë sistemi i Faraonit – kishte fuqi hyjnore. Megjithatë, mrekullitë e Musait paraqitnin diçka tjetër. Ata kuptuan se shkathësia e tij nuk ishte as iluzion, e as një dredhi magjistari. Shkopi i Musait në fakt kishte gëlltitur dredhitë e tyre. Magjistarët, prandaj kuptuan se kjo ishte një mrekulli e vërtetë dhe shenjë e ekzistencës së Zotit, dhe një dëshmi e përkrahjes së Musait nga Zoti. Për këtë arsye ata përqaftuan besimin:

Dhe magjistarët ranë në sexhde. Ata thanë: “Ne besojmë në Zotin e Gjithësisë (Aleminit), Zotin e Musait dhe të Harunit.” (Kur'an, 7:120-122)

Në atë moment, i tërë sistemi u përmbys. Faraoni, i cili e sfidoi Musain botërisht, duke qenë tepër i sigurt se do të fitonte, në fakt pësoi disfatë dhe magjistarët e tij në fund besuan Musain. Faraoni nuk mund të pranonte vendimin e magjistarëve. Sipas arsyes së tij të çoroditur, ai ishte i vetmi pronar i tokës – madje edhe i njerëzve – dhe mendonte se kishte të drejtën që t'i lejonte apo ndalonte njerëzit që të ktheheshin në një besim tjetër:

Faraoni u tha: “Ju i keni besuar atij (Musait) para se t'ju jap unë leje? Vërtetë ky është një komplot të cilin ju e keni kurdisur në qytet që të nxirrni banorët e tij prej andej.” (Kur'an, 7:123)

I mashtruar nga të menduarit e tij të shtrembëruar, Faraoni u përpoq që të gjente rrugëdalje nga kjo situatë.

Një mrekulli e qartë sapo kishte ndodhur dhe pasiqë u pasua nga një disfatë e turpshme, magjistaret filluan të besojnë në Zotin e Musait. Ajo që do të duhej të pritej nga Faraoni pastaj ishte që të pranonte botërisht ndodhinë e një mrekullie dhe të pranonte që të udhëzohej drejt. Megjithatë, ai bëri të kundërtën duke i ofruar vetes interpretime të rrejshme, duke fabrikuar skenare që edhe ai vet e dinte se ishin të imagjinuara. Kështu, ai e bindi vetveten se Musai dhe magjistaret kishin bërë konspiracion për të marrë pushtetin mbi Egjipt. Për më tepër, ai pandehte se ishte Musai ai që ua kishte mësuar magjinë atyre:

“...Ai (Musai) është prijës i juaj, i cili ua mësoi juve magjinë...” (Kur’an, 20:71)

Ja se si Faraoni dëshmoi për shenjat dhe mrekullitë e pakundërshtueshme të Zotit, por kundërshtoi dhe mohoi të vërtetën. Në të vërtetë, sjellja e tij ishte tipike për të gjithë ata që e mohojnë të vërtetën. Këta njerëz, të vendosur të mos besojnë, i përmbahen kësaj pa marrë parasysh sa të pakundërshtueshme janë shenjat që ju paraqiten atyre. Ata i japen çfarëdo forme të mashtrimit për të përlligjur mohimin e tyre. Në secilën shoqëri dhe në secilën kohë, do të gjejmë mosbesimtarë të panumërt të infektuar me kryeneçësi të palëkundur si ajo e Faraonit, që kishin mohuar ekzistencën, njësinë dhe drejtësinë e religjionit të Zotit.

Sidoqoftë, Faraoni ishte i vetëdijshëm se kryeneçësia e tij nuk do ta shpëtonte atë. Humbja e magjistarëve të tij dhe pranimi i besimit në Zotin nga ana e tyre e lëkundti autoritetin e tij në një masë të madhe. Në një mënyrë apo tjetër, atij iu desht të gjente rrugëdalje nga kjo situatë dhe të rivendoste pushtetin e tij. Për këtë qëllim ai iu dha dhunës, duke iu kërcënuar magjistarëve besimtarë me torturë dhe vdekje. Megjithatë, tashmë të vetëdijshëm për të vërtetën e porosisë së

Zotit, magjistarët iu nënshtruan Zotit me bindje. Në disa vargje të Kur'anit, mësojmë për shprehjen e vendosmërisë së magjistarëve në besimin e tyre:

“...Unë do t’ua pres duart dhe këmbët tuaja të këmbyera (dorën e djathtë dhe këmbën e majtë ose e kundërta) dhe do t’ju kryqëzoj në trungjet e hurmave dhe vërtetë që do ta kuptoni se cili prej nesh (unë apo Allahu) mund të jap ndëshkim më të ashpër e më të gjatë.” Ata i thanë: “Ne nuk të përfillim e nuk të vlerësojmë ty përmbi Shenjat e Qarta që na kanë ardhur dhe përmbi Atë (Allahun) i Cili na krijoi ne. Kështu pra, vendos e urdhëro çfarë të duash, pasi ti mund të vendosësh vetëm përsa i takon jetës së kësaj bote!” (Kur’an, 20:71-72)

Ata i thanë: “Me të vërtetë që ne po kthehemi te Zoti ynë.” Ndërsa ti hakmerresh mbi ne vetëm pse ne besuam në Shenjat e Zotit tonë, kur këto mbërritën tek ne. Zoti ynë! Na dhuro durim dhe na bën të vdesim si Muslimanë!” (Kur’an, 7:125-126)

Ata (magjistarët) thanë: “Asnjë dëm! Sigurisht që te Zoti ynë do të kthehemi. Shpresojmë se Zoti ynë do të na i falë mëkatet tona, pasi ne jemi të parët e besimtarëve.” (Kur’an, 26:50-51)

Si shpjegohet në vargjet e mësipërme, këta njerëz besimtarë nuk u dorëzuan para kërcënimeve të Faraonit, as nuk iu nënshtruan, sepse ata e kuptuan se nëse do të vriteshin, ata do t’i ktheheshin Zotit, i cili është Krijuesi i çdo gjëje. Gjatë gjithë kohës, ata shpresonin shumë se Zoti do t’i falte ata për lëshimin e tyre në mohim para se të pranonin besimin dhe qëndrimin e tyre armiqësor që kishin pasur ndaj fesë. Sepse Zoti është Gjithnjë Falës i Madh dhe i Gjithëmëshirshëm.

Që nga ai moment, sundimi i Faraonit mbi njerëzit u bë gjithnjë e më i dhunshëm. Ai kërkonte të drejtonte njerëzit me anë të fuqisë që posedonte. Për shkak të shtypjes që ai bëri, askush përveç

një grupi të vogël të të rinjëve nga populli i Musait, nuk ndoqi Musain. Vetëm ky numër i vogël i të rinjëve tregoi guxim dhe sinqeritet për të ndjekur shembullin e magjistarëve. Shumica, në anën tjetër, nuk e vlerësoi fuqinë e Zotit të Plotfuqishëm dhe duke mos iu frikësuar Atij, nuk pranuan besimin. Kjo rrëfëhet në Kur'an si vijon:

Por askush nuk e besoi Musain përveç pasardhësve të popullit të vet duke pasur frikë se Faraoni dhe paria e tij do t'i persekutonin dhe vërtetë Faraoni ishte tiran arrogant në tokë, ai me të vërtetë ishte prej atyre që tejkalojnë çdo kufi. (Kur'an, 10:83)

Njëra prej atyre që i besuan Musait ishte gruaja e Faraonit. Kjo grua bujare, që para kësaj kishte ndarë aq shumë të mira të kësaj bote me Faraonin, jo vetëm që muar guximin të braktis gjithë këtë pasuri, por gjithashtu ta bënte veten objekt të dhunës së Faraonit. Zgjedhja e saj është shenjë e qartë e një besimi të thellë dhe të sinqertë. Me të vërtetë, së bashku me Merjemen (Marien) (as), Kur'ani përmend gruan e Faraonit si një grua besimtare sjellja e së cilës ishte shembullore:

Dhe Allahu sjellë një shembull për ata që besojnë: bashkëshorten e Faraonit kur ajo tha: “Zoti im, më ndërto mua tek Ti një shtëpi në Parajsë (Xhennet) dhe më shpëto mua nga Faraoni dhe puna e tij dhe më shpëto mua nga njerëzit keqbërës.” (Kur'an, 66:11)

Përkushtimi i sinqertë i gruas së Faraonit ndaj Zotit është një shembull i shkëlqyer për të gjithë Muslimanët. Kjo besimtare e vërtetë braktisi pasurinë e kësaj bote duke pranuar se jeta e vërtetë ishte ajo e përjetshme. Ajo parapëlqeu të mirat e jetës së përjetshme mbi të mirat e kësaj jete të shkurtër edhe pse jetë verbërisht mashtruese. Ajo iu lut Zotit vetëm për një shtëpi në Parajsë (Xhennet). Padyshim se një lutje e tillë e sinqertë, e përmbushur me një përkushtim shpirtëror ndaj jetës së përjetshme, është një shembull i mirë për ata që besojnë.

...Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të jenë në kopshtet e bukura të Xhennetit. (Kur'an, 42:22)

NJË NJERI BESIMTAR DHE PALLATI

Pavarësisht nga ngjarjet e mbinatyrshe dhe mrekullitë që përjetuan, Faraoni dhe paria e tij iu kundërvunë Musait. Ata insistuan në mohimin e së vërtetës, për shkak të arrogancës dhe kryeneçsisë së tyre dhe shkuan aq larg sa të pohonin se Musai ishte magjistar i cili shfaqti një magji. Për më tepër, ata sajuan plane të reja që Musai dhe pasuesit e tij t'iu nënshtroheshin torturave edhe më të vrazhda dhe shtypjes:

Dhe padyshim që Ne dërguam Musain me Shenjat Tona dhe me autoritet të qartë te Faraoni, Hamani dhe Karuni, por ata e quajtën dhe i thanë: “Magjistar gënjeshtar!” Pastaj, kur ai u solli atyre të vërtetën nga Ne, thanë: “Vrisni bijtë e atyre që besojnë me të dhe lini gjallë gratë e tyre,” por përбетimet e mosbesimtarëve s’janë veçse të kota e në humbje! Faraoni tha: “Më lini mua ta vras Musain dhe le të thërras Zotin e tij (t’më ndalojë)! Kam frikë se ai do t’ju ndërrojë juve fenë tuaj ose se ai mund të bëjë që të përhapet në tokë e keqja dhe ligësitë!” Musai tha: “Padyshim që unë jam mbështetur tek Zoti im dhe tek Zoti juaj që të më mbrojë nga çdo kryeneç që nuk beson në Ditën e Llogarisë!” (Kur’an, 40:23-27)

Faraoni kishte për qëllim të vriste Musain. Ai ishte i përkushtuar të parandalonte vendosjen e një rendi të ri në tokën e Egjiptit që do të pengonte pasurimin e tij të mëtejshëm. Poqese Musai do të

arrinte më shumë pushtet, Faraoni s'do të ishte në gjendje të sundonte popullin e Egjiptit ashtu si dëshironte ai. Për këtë arsye ai u përpoq të arsyetonte vrasjen e Musait duke sugjeruar se qëllimet e Musait ishin jashtëzakonisht të liga. Megjithatë, aty u paraqit një njeri nga familja e Faraonit, i cili përkrahu Musain dhe kundërshtoi mizoritë e Faraonit:

Dhe një njeri besimtar nga familja e Faraonit, i cili e fshihte besimin e tij, tha: “A do të vrisni një njeri sepse thot: “Zoti im është Allahu” dhe tashmë ju ka ardhur me shenja e tregues të qartë nga Zoti juaj? Edhe nëse ai është gënjeshtar, mbi të do të jetë gjynahi i gënjeshtres së tij; por nëse po e thot të vërtetën, atëherë mbi ju do të bjerë nga ai dënim të cilin ai ju premton. Vërtetë që Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar i shfrenuar e i papërmirsueshëm! O njerëzit e mi! I juaji është mbretërimi këtë ditë, ju jeni më të lartët në tokë. Por kush do të na shpëtojë ne nga Ndëshkimi i Allahut nëse bie mbi ne?”

Faraoni u tha: “Unë ju tregoj juve vetëm atë që unë e shoh të drejtë dhe unë ju udhëzoj vetëm në rrugën e qeverisjes së drejtë!” Dhe ai që besoi tha: “O njerëzit e mi! Me të vërtetë që kam frikë për ju një përfundim si ajo dita e shkatërrimit të popujve të shumtë (në kohët e para)!” Si fati i popullit të Nuhut, dhe Aadit, dhe Themudit edhe i atyre që erdhën pas tyre. Dhe Allahu nuk dëshiron asnjë padrejtësi për robërit e Tij. O njerëzit e mi! Me të vërtetë që kam frikë për ju Ditën në të cilën do të jetë thirrja e përbashkët (midis banorëve të Xhehenemit dhe banorëve të Xhennetit).” Një Ditë kur do të ktheni shpinën dhe do t'ia mbathni duke mos pasur asnjë mbrojtës prej Allahut. Dhe cilindo që e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues. Dhe me të vërtetë që juve ju erdhi Jusufi në kohën e shkuar me tregues të qartë por ju nuk pushuat së dyshuari në atë që ai ua solli, derisa kur ai vdiq, ju thatë: “Asnjë të dërguar nuk do të çojë Allahu pas tij.”

Kështu pra Allahu i humbet rrugën atij i cili është i shfrenuar dhe mosbesues (që dyshon në Njësinë e Allahut).

Ata që kundërshtojnë Shenjat e Allahut pa u ardhur atyre asnjë dije e provë, kjo është mjaftë e urryer dhe e neveritur tek Allahu dhe për ata që besojnë. Kësisoj pra, Allahu vulos zemrën e çdo tirani kryelartë (kështuqë ata nuk mund ta drejtojnë veten në Udhën e Drejtë). (Kur'an, 40:28-35)

Paralajmërimi që iu bë nga ky njeri besimtar i pallatit nuk pat ndonjë ndikim tek Faraoni, zemra e të cilit ishte mbushur përplot arrogancë dhe ishte e verbëruar nga mohimi. Për t'i paraqitur fjalët e tij si të kota, ai u përpoq që të tallej me këtë Musliman i cili ia kishte tërhekur vërejtjen atij dhe gjithë popullit të Egjiptit. Faraoni iu drejtua ndihmësit të tij Hamanit me ironi, duke i kërkuar atij që të ndërtonte një kullë:

E Faraoni tha: “O Haman! Ndërto për mua një kullë që të mund të arrijë rrugët, rrugët e qiejve dhe të mund të shoh Zotin e Musait, por unë me të vërtetë e quaj atë gënjeshtar”. Kështu pra, në sytë e Faraonit u bë joshëse dhe si e drejtë e liga e punëve të tij dhe ai qe i ndaluar nga Udhë e Drejtë. Dhe qëllimi dhe betimi i Faraonit nuk çoi veçse në humbje e shkatërrim. (Kur'an, 40:36-37)

Faraonit kishte për qëllim që të rimerrte kontrollin thjeshtë duke u tallur. Ai nuk e kishte kuptuar rëndësinë e porosisë, domethënë, ekzistencën dhe njësinë e Zotit, që iu përcoll nga Musai. Faraoni mendonte se Musai po sugjeronte se Zoti ishte lart në qiell dhe mendonte se asgjë nuk mund të shihej prej atje me të hipur atje. Duke u bazuar në këtë kusht (premisë) ai mbështeti mohimin e asaj që Musai i përcolli.

Duke e kuptuar mënyrën e të menduarit të gabueshëm të Faraonit, besimtari nga familja e Faraonit, i cili e kishte mbajtur të fshehtë besimin e tij, filloi që t'ia shpjegoj ekzistencën e Zotit dhe të jetës së përjetshme Faraonit dhe njerëzve të tij. Ai i paralajmëroi ata për mundimet/vuajtjet e pafund. Ai i thirri ata në rrugën e drejtë dhe iu lut atyre që ta ndjekin atë:

Njeriu që besoi tha: “O njerëzit e mi! Më ndiqni mua, unë do t’ju udhëzoj në rrugën e drejtimit të drejtë! O njerëzit e mi! Nuk ka dyshim se kjo jetë e kësaj bote nuk është veçse një kënaqësi e shpejtë dhe e përkohshme, dhe sigurisht se Jeta e Fundit, ajo është banesa që do të mbetet përgjithmonë. Kushdo që bën një vepër të keqe, nuk do të shpërblehet veçse me një të tillë si ajo dhe kushdo që bën vepër të mire e të drejtë, qoftë burrë apo grua duke qenë besimtar i vërtetë, të tillët do të hyjnë në Xhennet në të cilin do t’u shërbehet me të gjitha të mirat pa masë e pa kufi. O njerëzit e mi! Si është kjo? Unë ju ftoj në shpëtim, ndërsa ju më ftoni në Zjarr! Ju më ftoni të mohoj Allahun dhe të bashkoj me Të të tjerë në adhurim përkrah Tij, gjë për të cilën unë nuk kam asnjë dije. Dhe unë ju ftoj tek i Gjithëfuqishmi, gjithnjë Falës i Madh. Nuk ka dyshim se ju më ftoni mua të adhuroj një i cili s’mund t’i përgjigjet lutjes sime në këtë botë apo në Jetën e Fundit. Dhe kthimi ynë do të jetë tek Allahu dhe padysim se të larguarit prej rrugës së drejtë, ata do të jenë banorë të Zjarrit. Dhe ju do ta kujtoni çfarë po ju them. Dhe çështjen time unë ia lë Allahut. Vërtetë që Allahu është gjithëvëzhgues i robërve të Tij!”

Kështu Allahu e shpëtoi atë (besimtarin) nga poshtërsitë që ata i kurdisë (kundër tij), ndërsa njerëzit e Faraonit i rrethoi ndëshkimi më i keq. (40:38-45)

Faraoni dhe shoqëruesit e tij nuk ua vunë veshin këtyre paralajmërimeve të këtij besimtari të përkushtuar i cili ishte nga mesi i tyre. Sidoqoftë, një dënim i madh i priste ata si shpëtim për mohimin dhe arrogancën e tyre.

EMRI “HAMAN” NË KUR’AN PËRMENDET GJITHASHTU NË MBISHKRIMET E LASHTA EGJIPTIANE

Një pjesë e të dhënave që jap Kur’ani për Egjiptin e lashtë zbulon shumë fakte historike që nuk u zbuluan deri vonë. Këto të dhëna gjithashtu tregojnë se çdo fjalë në Kur’an është përdorur në pajtueshmëri me arsyen hyjnore.

“Hamani” është një person tjetër, emri i të cilit përmendet në Kur’an përkrah Faraonit. Në gjashtë vargje të veçanta, Hamani përmendet si njëri nga njerëzit më të afërt të Faraonit.

Mirëpo çuditërisht, ne kurrë nuk takojmë emrin e Hamanit në pjesën e Tevratit në të cilën bëhet fjalë për jetën e Musait. Megjithatë, Hamani përmendet në kapitujt e fundit të Biblës, si këshilltari i një mbreti Babilonas, i cili kishte jetuar përafërsisht 1100 vjet pas Faraonit dhe i cili njihej si një njeri që kishte qenë shumë mizor ndaj Çifutëve.

Disa jo-Musliman, të cilët pohojnë se Kur’ani është njëfarë ripërpilimi i Biblës nga ana e Profetit Muhamed (saas) dhe pretendojnë që Profeti të ketë kopjuar gabimisht një pjesë të materialit nga Bibla në Kur’an.

Megjithatë, ky pohim është vërtetuar të jetë i pabazë duke iu falënderuar deshifrimit të alfabetit të hieroglifeve Egjiptiane përafërsisht 200 vjet më parë. Përmes kësaj të arriture, emri i “Hamanit” është gjetur në mbishkrimet e lashta Egjiptiane. Deri në atë kohë, shkrimet dhe dorëshkrimet në hieroglifet e lashta Egjiptiane kishin mbetur të palexuara. Gjuha e hieroglifeve të lashta Egjiptiane kishte mbetur në përdorim për shumë shekuj, por me përhapjen e Krishtëritimit dhe me ndikimin e tij përfundimtar në shekullin e 2-të dhe të 3-të të erës së re, solli fundin e njohjes së saj. Shembulli i fundit i shkrimit hieroglifik i njohur për ne është një dorëshkrim i vitit 394 të erës së re. Pas kësaj date, gjuha e hieroglifeve u bë një gjuhë e vdekur, duke mos lënë pas askend që mund ta fliste atë deri në shekullin e 19-të. 2

Fshehtësia e hieroglifeve të lashta Egjiptiane u zgjodh vetëm në vitin 1799, me zbulimin e Gurit të Rosetës (Rosetta Stone) që datonte nga viti 196 para erës së re. Përdorimi i tri gjuhëve të ndryshme e bëri këtë gur të deshifrueshëm: gjuha e hieroglifeve, gjuha popullore (një formë e thjeshtësuar e gjuhës së hieroglifeve që përdorej nga shtresa e njerëzve të rëndomtë të shkolluar) dhe greqishtja. Shkrimet e lashta Egjiptiane u zbërthyen kryesisht me ndihmën e shkrimit Grek. Përkthimi (transkriptimi) u kompletua nga një Francez, Jean-François Champollion, dhe një gjuhë e vdekur si edhe historia e bartur prej saj, përfundimisht u ndriçua. Pra, qytetërimi i lashtë Egjiptian, që përfaqësonte një religjion dhe jetë shoqërore krejtësisht tjetër, u ringjall. 3

Duke iu falënderuar zbërthimit të shkrimit të hieroglifeve, ne gjithashtu arritëm deri te një e dhënë thelbësore që ka të bëjë me temën tonë: emri i “Hamanit” me të vërtetë ishte përmendur në tekstet Egjiptiane. Ky emër ishte skalitur në një monument që sot është i ekspozuar në Hof Muzeun e Vienës. Mbishkrimi gjithashtu thekson afërsinë e Hamanit me Faraonin. 4

Në “Fjalorin e Emrave Personal të Mbretërisë së Re,” një fjalor i mbështetur në të dhënat e grumbulluara nga përmbledhja e plotë e dorëshkrimeve, Hamani përmendet si “udhëheqësi I punëtorëve në minierat e gurit.” 5

Ndryshe nga pohimet e kundërshtarëve të tij, Hamani ishte një person që kishte jetuar në Egjipt në kohën e Musait, sikurse shkruan në Kur’an. Prap, sikurse përmendet në Kur’an, ai ishte një njeri i afërt me Faraonin që ishte përgjegjës për projektet ndërtimore. Në mënyrë të ngjashme, vargu që rrëfen se si Faraoni kishte kërkuar nga Hamani që t’i ndërtonte një kullë është gjithashtu në pajtueshmëri me dëshminë e këtij zbulimi arkeologjik:

Faraoni tha: “O pari! Unë nuk di se ju keni ndonjë ilah (zot) tjetër veç meje. Ndiz pra një zjarr, o Haman, të pjekim tulla dhe më ngri (ndërto) mua një kullë të lartë (pallat madhështor) që ta shoh (apo të kërkoj për) Zotin e Musait, dhe në të vërtetë mendoj se ai është prej gënjeshtarëve.” (Kur’an 28:38)

Në përfundim, ekzistenca e emrit të Hamanit në dorëshkrimet e lashta Egjiptiane jo vetëm që i bëri këto pohime të sajuara krejtësisht të pabaza, por gjithashtu përforcoi faktin se Kur’ani është fjala e pagabueshme e Zotit. Kur’ani na zbulon në mënyrë të mrekullueshme një të dhënë historike që përndryshe do të ishte e pamundur të arrihet apo të zgjidhet në kohën e Profetit.

MOSMIRËNJOHJA E TË BIJËVE TË IZRAELIT

Pas ballafaqimit të tij me magjistarët, Musai qëndroi në Egjipt për një kohë të gjatë që u dallua nga një shtypje më e ashpër e ushtruar nga Faraoni ndaj Musait dhe të bijëve të Izraelit. Në njërën anë, Musai u ballafaqua me Faraonin dhe shtypjen e tij, ndërsa në anën tjetër, ai i ftoi të bijtë e Izraelit që të jenë të palëkundur. Disa nga të bijtë e Izraelit e kritikuan Musain pa treguar kurrfarë respekti ndaj tij, duke thënë se prezenca e tij nuk e kishte zbutur shtypjen të cilës ata i ishin nënshtruar:

Musai i tha popullit të tij: “Kërkoni mbështetje tek Allahu dhe jeni të duruar. Vërtetë që toka është e Allahut. Ai ia lë në trashëgim atë kujtdo që Ai dëshiron prej robërve të Tij dhe fundi i shkëlqyer është për të përkushtuarit ndaj Allahut, për ata që i frikësohen Allahut.” Ata i thanë: “Ne (Bijtë e Izraelit) kemi hequr shumë para se të vije ti edhe prej se ke ardhur ti në mesin tonë.” Ai (Musai) u tha: “Mbase kjo është se Zoti juaj do ta shkatërrojë armikun tuaj (Faraonin), duke ju bërë ju trashëgues në tokë e t’ju shoh si do të veproni?”. (Kur’an, 7:128-129)

Mosrespekti i të bijëve të Izraelit ndaj Musait është tregues i dobësisë së tyre shpirtërore. Zoti kishte dërguar një profet i cili për t’i shpëtuar nga mizoria e Faraonit kërkoi nga ata që të jenë të palëkundur. Për shkak të dobësisë së besimit të tyre dhe të mungesës së plotë të urtësisë, ata nuk ishin në gjendje të tregohen të përmbajtur. Në vend të kësaj, me mosmirënjohje, ata filluan që të ankohen dhe t’i shryhen Musait. Megjithatë, pa marrë parasysh se çfarë i ndodhë, një besimtar i vërtetë i është falënderues Zotit dhe vetveten ia nënshtron çdo gjëje që Zoti të ketë paracaktuar për të. Në kohë të vështira, të vuajtjes, të urisë ose madje të shtypjes apo torturës, një Musliman duhet gjithmonë të jetë në një gjendje të tillë të nënshtrimit shpirtëror. Kjo gjendje shpirtërore

ishte shpjeguar nga i Dërguari i Zotit, Profeti Muhamed (saas) me këto fjalë *“Lavdia i qoftë Allahut i Cili krijoi gjithçka ashtu siç duhet, i Cili nuk nxiton asgjë që Ai përcakton dhe vendosë. Allahu është i mjaftueshëm për mua.”* (Ibn Majah) Vetëm një nënshtrim dhe përkushtim i tillë në Zotin mund t’i shndërroj vështirësitë në të mira të mëdha shpirtërore.

Me shembullin e Musait, Zoti na tregon se shumica e të bijëve të Izraelit nuk kishte një vetëdije të këtillë. Si do të bëhet e qartë në vazhdim, ankesat e të bijëve të Izraelit, siç u përshkrua më lartë, më vonë do të shndërroheshin në mosmirënjohje dhe përfundimisht në kryengritje kundër Zotit. Zoti na bën me dije për këto ngjarje nga të cilat mund të nxjerrim mësim. Po sikur në rastin e mohimit të Faraonit, ashtu edhe në besimin e dobët dhe zemrat e sëmura të bijëve të Izraelit ka mësim për ne.

Dhe Ai (Allahu) ju dha gjithçka që kërkuat prej Tij dhe po të përpiqeni t’i numëroni mirësitë e Allahut, ju kurrë nuk do të ishit në gjendje t’i numëroni ato. Me të vërtetë që njeriu është plotësisht i dhënë pas padrejtësisë dhe mosmirënjohjes. (Kur’an, 14:34)

PERIUDHA E KATASTROFAVE DHE MARRËZIA E FARAONIT

Zoti dërgoi fatkeqësi të ndryshme mbi Faraonin dhe vartësit e tij njëren pas tjetrës, një popull këmbëngulës në mohim. Së pari, filloi një periudhë e thatësisë së jashtëzakonshme në Egjipt. Uji ishte jashtëzakonisht qenësor për Egjiptianët dhe thatësia e kërcënonte në mënyrë të drejtpërdrejtë vet jetesën e tyre. Si rezultat i kësaj, të mirat bujqësore u pakësuan në masë të madhe dhe pasoi uria:

Dhe me të vërtetë Ne e shkatërruam popullin e Faraonit me vite thatësie dhe me mungesë drithërash e frutash, me qëllim që ata të mund të përkujtonin. (Kur'an, 7:130)

Siç mësojmë nga vargu i mësipërm, uria zgjati disa vjet rresht. Pas ballafaqimit të tij me magjistarët, Musai qëndroi në Egjipt për shumë vite për të përcjellur porosinë e Zotit. Brenda kësaj kohe, Zoti kërkoi nga Musai që të ndërtonte shtëpi për popullin e tij për t'i kryer lutjet (namazin) e tyre në siguri. Në këtë mënyrë, besimtarët gjithashtu u ndihmuan të qëndrojnë së bashku:

Dhe Ne e frymëzuam Musain dhe vëllaun e tij (duke ju thënë): “ Zini vendbanime për popullin tuaj në Egjipt, i bëni edhe vende adhurimi vendbanimet tuaja dhe kryeni rregullisht faljet e përcaktuara (falni namazin rregullisht). Dhe përgëzo besimtarët.” (Kur'an, 10:87)

Në këto shtëpi, Musai dhe pasuesit e tij i bënë lutjet e tyre dhe përkujtuan Zotin. Populli i Egjiptit, në anën tjetër, vazhduan që të inkurajojnë njëri tjetrin në padituri dhe fajësuan Musain dhe pasuesit e tij për fatkeqësitë që ju ndodhën atyre:

Por, kurdo që u vinte e mira (viti i begatshëm), ata thoshin: “Kjo është në sajën tonë.” Ndërsa po t’i goditnin fatkeqësitë, këto ia mveshnin shenjave ogurzeza të lidhura me Musain dhe ata (besimtarët) që ishin me të. Me të vërtetë që shenjat e tyre ogurzeza janë vetëm tek Allahu (si të dojë Ai), por shumica prej tyre nuk e dinë. (Kur’an, 7:131)

Fatkeqësitë ndodhnin gjithkund në vend. Mirëpo përkundër kësaj, Faraoni dhe paria e tij nuk braktisën zakonet e tyre të çoroditura politeiste; ata ishin plotësisht të përkushtuar ndaj “religjionit të të parëve të tyre.” As edhe dy mrekullitë e Musait, domethënë, shfaqja e dorës së tij të zbardhur dhe shndërrimi i shkopit të tij në gjarpër, nuk ndihmuan që ata të braktisnin besimet e tyre të kota. Në të vërtetë, ata pohuan se nuk do t’i besonin atij, madje edhe nëse ai do të sjellte edhe një mrekulli tjetër:

Ata i thane (Musait): “Çfarëdo Shenjash që ti mund t’na sjellësh neve, që të punosh mbi ne magjinë tënde, ne nuk do të besojmë ty”. (Kur’an, 7:132)

Për shkak të sjelljes së tyre, Zoti i ndëshkoi ata me një varg fatkeqësish si “shenja, të qarta dhe të dallueshme” (Kur’an, 7:133), në mënyrë që ata të shijonin vuajtjet edhe në këtë botë. E para prej këtyre fatkeqësive ishte thatësia që e përmendëm më heret që shkaktoi një rrënjë të dëmshme të prodhimit të të mirave bujqësore.

Bujqësia e Egjiptit mbështetej në lumin Nil dhe prandaj nuk ishte e ndikuar nga ndryshimet e kushteve natyrore. Madje edhe në stinët më të nxehta kur nuk binte shi në tokën e Egjiptit, lumi Nil bartte sasi të bollshme të ujërave nga brendia e Afrikës. Mirëpo, pasi që Faraoni dhe paria e tij vazhduan të jenë arrogant dhe krenar ndaj Zotit, një katastrofë që në këtë vend ishte e papritur i goditi ata; një thatësi. Kjo thatësi në mënyrë të qartë përgënjeshtroi fjalët e Faraonit kur ai tha:

“O populli im! A nuk është i imi sundimi i Egjiptit dhe i këtyre lumenjëve që rrjedhin poshtë meje? A nuk shikoni pra?” (Kur’an, 43:51)

Megjithatë, në vend se të “tregoheshin të vëmendshëm,” populli jobesimtar i konsideronte këto katastrofa si një fatkeqësi që atyre iu kishte sjellë Musai dhe të bijtë e Izraelit. Ata ishin plotësisht të bindur në këtë iluzion për arsye të bindjeve të tyre në bestytini dhe në religjionin e të parëve të tyre. Ata përjetuan vuajtje të mëdha, por ajo që do t’iu ndodhte atyre nuk mbaronte me këto fatkeqësi fillestare. Ky ishte vetëm fillimi. Zoti iu dërgoi atyre një varg fatkeqësish. Ato janë të përshkruara në Kur’an si vijon:

Kështu Ne dërguam mbi ta përmytjen, karkalecat, morrat, bretkocat dhe gjakun si vazhdimësi të Shenjave të qarta dhe të dallueshme, por prapsepap ata mbetën mospërfillës dhe të mbytur në mendjemadhësi dhe ishin popull keqbërës. (Kur’an, 7:133)

Përkundër gjithë këtyre fatkeqësive, ata vazhduan me mohimin e tyre. Madje edhe kur e kishin kuptuar se këto fatkeqësi ishin pasojë e mohimit të tyre, ata këmbëngulën në mohimin e tyre. Faraoni dhe shoqëruesit e tij u përpoqën që të mashtrojnë Musain dhe në këtë mënyrë edhe Zotin. Kur iu ndodhën këto fatkeqësi të tmerrshme, njëra pas tjetrës, ata e thirrën Musain dhe iu përgjëruan atij që t’i shpëtonte ata nga ato:

Ndërsa kur u ra ndëshkimi në kokë, thanë: “O Musa! Lutju Zotit tënd për ne, për Premtimin e tij që të ka dhënë ty. Nëqoftëse ti e largon ndëshkimin prej nesh, me të vërtetë që ne do të besojmë ty dhe do t’i lëmë edhe Beni Israilët të vijnë me ty.” Por kur Ne e larguam ndëshkimin prej tyre për një afat të përcaktuar të cilin ata duhej ta mbërrinin, kur ç’të shohësh! Ata e thyen besën e dhënë. (Kur’an, 7:134-135)

Duhet të përmendim se sjellja e mosbesimtarëve ishte shumë e ngjashme me atë të Shejtanit. Shejtani refuzoi t’i bindej Zotit përkundër pranimin të ekzistencës e Tij. Po në këtë mënyrë, populli i Faraonit refuzoi t’i nënshtrohej Zotit dhe të dërguarit të Tij, edhe pse ishin të vetëdijshëm për faktin se Zoti, të cilin ata patën guxim ta quajnë “Zoti i Musait,” dërgoi këto fatkeqësi. Përfundimisht ata pranuan ekzistencën e Zotit, por megjithatë refuzuan t’i nënshtrohen Atij për shkak të arrogancës së tyre dhe besimit të verbër në religjionin e të parëve të tyre.

Për një kohë të gjatë, Musai paralajmëroi fisin e tij dhe iu përcollti atyre religjionin e Zotit. Për më tepër, ai bëri një varg mrekullish si shenja nga Zoti. Zoti dërgoi mbi këta njerëz shumë fatkeqësi, që ata t’i ktheheshin Atij, megjithatë, asnjëri nga idhujtarët nuk braktisi besimin e tij në shumë zotëra e as nuk iu kthye Zotit tonë të vërtetë, Krijuesit. Në Kur’an, Zoti na bën me dije se Faraoni i rezistoi Musait përkundër të gjitha përpjekjeve të tij:

Edhe te Musai gjithashtu ka tregues, kur Ne e dërguam atë te Faraoni me autoritet të qartë. Por (Faraoni) u largua (nga të besuarit) dhe u kthye nga vetja bashkë me krerët e tij... (Kur’an, 51:38-39)

I kundërshtuar nga ky refuzim i prerë, Musai iu lut Zotit të tij të sjellte vuajtje mbi këtë komb kryengritës:

Ndërsa Musai tha: “Zoti ynë! Ti vërtetë u keqderdhur Faraonit dhe prijësve të tij madhështi dhe pasuri në jetën e kësaj bote. Zoti ynë! Që të mund të t’i largojnë e t’i humbin njerëzit nga Udhë Jote. Zoti ynë! Shkatërroje pasurinë e tyre dhe ngurtësoji zemrat e tyre që të mos besojnë derisa të shohin dënimin e dhimbshëm.”

Ai (Allahu) tha: “Padyshim që dua (lutja) e ju të dyve është e pranuar, kështu që ju përmbajuni Udhës së Drejtë dhe mos ndiqni rrugën e atyre që nuk dinë! (Kur’an, 10:88-89)

Zoti iu përgjigj lutjes së Musait. Faraoni dhe njerëzit e tij që nuk pranuan udhën e drejtë përkundër të gjitha paralajmërimeve, u ndeshën me një “ndëshkim të dhimbshëm.” Fundi i tyre pasqyronte sjelljen e tyre, duke qenë se ata u varrosën me gjithë pronat e tyre.

A nuk e shohin ata se janë sprovuar një herë apo dy herë çdo vit. Prap ata nuk kthehen në pendim dhe as nuk marrin mësim. (Kur’an, 9:126)

EKSODI NGA EGJIPTI DHE FUNDOSJA E FARAONIT NË DET

Ka një kufi për frymëzimet që një komb mund t’i pranoj. Zoti paralajmëron njerëzit përmes librave të Tij, të dërguarve të Tij apo shërbyesve të tij besnik. Të gjithë njerëzit janë të ftuar të besojnë në ekzistencën dhe njësinë e Zotit tonë dhe t’i binden Mbrojtësit dhe Krijuesit tonë të Vërtetë. Ky kumtim mund të zgjas me vite të tëra. Megjithatë, në sytë e Zotit, ekziston gjithmonë

një kufi i paracaktuar për këtë process. Për ata që këmbëngulin në mohim, do të ketë vuajtje gjatë jetës në këtë botë, vuajtje që shtrihet në pafundësi në jetën e përjetshme.

Faraoni dhe paria e tij, një trup i pabindur, i kthyer nga vetvetja, që i bëri ballë porosisë për vite të tëra, meritoi ndëshkimin. Ata ngritën krye kundër Zotit, duke e akuzuar të dërguarin të jetë i çmendur dhe gënjeshtar. Për shkak të mohimit të tyre, Zoti përgatiti për ta një fund poshtërues.

Para se të sjellte këtë ndëshkim mbi ta, Zoti urdhëroi Musain që të largonte të bijtë e Izraelit nga Egjipti:

Dhe Ne e frymëzuam Musain duke i thënë: “Largohu me robët e Mi natën, vërtet që do të ndiqeni (prej Faraonit).” (Kur’an, 26:52)

Në pajtim me urdhërin e Zotit, Musai dhe populli i tij fshehurazi u larguan nga Egjipti.

Ikja e të bijëve të Izraelit ishte krejtësisht e papranueshme për Faraonin, i cili konsideronte se ishte zoti i tyre. Ai e shihte veten si pronarin e vetëm të të gjithë të bijëve të Izraelit. Veç kësaj, kjo do të thoshte humbje e fuqisë punëtore që në fund të fundit do të ndihmonte në dobësimin e autoritetit të tij. Prandaj, ai vuri në lëvizje ushtarët e tij që të vihen në ndjekje të të bijëve të Izraelit:

Pastaj Faraoni dërgoi thirrës në (gjithë) qytetet (duke thënë): “Vërtetë që ata s’janë veçse një bandë e vogël dhe sigurisht që ata kanë bërë atë që na ka tërbuar ne. Por ne siç jemi të gjithë të grumbulluar, jemi shumë të paralajmëruar.”

Në këtë mënyrë Ne i përzumë ata nga kopshtet dhe nga burimet, nga thesaret dhe nga çdo vend tjetër i nderuar. Kësisoj (Ne e nxorrëm jashtë popullin e Faraonit) dhe bëmë që t'i trashëgojnë ato Beni Israilët. Kështu ata i ndoqën (Bijtë e Israilit) në mëngjes, me lindjen e diellit. (Kur'an, 26:53-60)

Kur të bijtë e Izraelit kishin arritur tek bregu i detit, Faraoni dhe ushtarët e tij i kishin arritur ata. Paniku dhe dëshprimi pushtoi popullin e Musait kur ata panë Faraonin dhe ushtarët e tij që iu afroheshin. Faraoni dhe ushtarët e tij ishin afër tyre. Nuk kishte mundësi për të ikur. Ata menduan se ishin zënë në kurth:

Dhe kur dy ushtritë panë njëra tjetrën, njerëzit e Musait thanë: “Padyshim që do të kapemi!” (Kur'an, 26:61)

Në atë moment, mënyra se si Musai u soll është një shembull për të gjithë besimtarët. Ai përkujtoi se kurrë s'duhet të humbiste besimin në ndihmën e Zotit:

Ai (Musai) tha: “Jo kurrë! Sigurisht që me mua është Zoti im, Ai do të më udhëzojë mua.” (Kur'an, 26:62)

Atëherë, ai iu bind frymëzimit që muar nga Zoti: “Bjeri detit me shkopin tënd” (Kur'an, 26:63).

Për mrekulli, Zoti ndau ujërat e detit duke lënë një udhë të thatë në mes, që të bijtë e Izraelit menjëherë e ndjekën. Faraoni dhe ushtarët e tij u treguan aq kokëkrisur sa të ndjeknin të bijtë e Izraelit në det. Këtu ndodhi një mrekulli e qartë; padyshim se ndihma dhe përkrahja e Zotit ishte

në anën e Musait dhe pasuesve të tij. Sidoqoftë, kjo mrekulli nuk mjaftoi që Faraoni të bindej. Së bashku me ushtarët e tij, ai verbërisht u fut në atë rrugë që ndau detin në gjysmë. Mirëpo, pasi që të bijtë e Izraelit kishin kaluar të sigurt në anën tjetër, ujërat befas filluan të bashkohen duke përmbytur kështu Faraonin dhe ushtarët e tij. Edhe pse në momentin e fundit, Faraoni u mundua të pendohej, pendimi i tij nuk u pranua:

Kështu Ne i morëm Bijtë e Israilit përmes detit, ndërsa Faraoni me ushtritë e tij i ndoqi me agresivitet e tirani derisa kur e mbuloi dallga mbytëse, ai tha: “Unë besoj se nuk ka Zot tjetër përveç Atij në të Cilin besojnë Bijtë e Israilit dhe unë jam prej atyre që janë muslimanë.” Tani ti beson? Ndërsa nuk pranove të besoje më parë dhe ishe prej të korruptuarve. Kështu këtë ditë Ne do ta nxjerrim trupin tënd të vdekur nga deti që të jesh si shenjë treguese për ata që do të vijnë pas teje! Dhe vërtetë që shumë nga njerëzit janë të pavëmendshëm ndaj Shenjave Tona. (Kur’an, 10:90-92)

Mund të nxjerrim një mësim shumë të rëndësishëm nga pendimi i Faraonit në momentin e fundit të jetës së tij dhe mospranimin e pendimit të tij nga ana e Zotit. Zoti i jap kohë dhe mundësi të mjaftueshme çdonjërit për të menduar mbi arsyen e ekzistencës së tyre në tokë, për të kuptuar se këtu janë për të qenë shërbëtorë të Zotit dhe për mënyrën se si duhet t’i shërbejnë Atij. Të dërguarit e Zotit, frymëzimet hyjnore dhe besimtarët i përcjellin njerëzimit urdhërat e Zotit. Ka kohë të mjaftueshme për t’i vlerësuar këto porosi dhe përkujtime dhe në fund për të kërkuar strehim në mëshirën e Zotit. Nëse megjithatë, njeriu çon kohën e përcaktuar për këtë kot dhe përpiqet që të pendohet vetëm në momentin kur takon vdekjen e tij – veçse kur kjo është përcaktuar me vullnetin e Zotit – pendimi i tij është i pavlerë. Sepse, në momentin e vdekjes, njeriu mund të ndjejë vërtetësinë dhe afërsinë e jetës së përjetshme dhe dëshmon këtë të vërtetë

kur të ballafaqohet me engjujt e vdekjes. Në atë çast, njeriu nuk mundet më të mos e pranoj të vërtetën. Ajo që megjithatë është e rëndësishme, është që njeriu të jetë i ndërgjegjshëm dhe i sinqertë gjersa është ende duke jetuar në këtë botë, domethënë, gjersa është ende duke u vënë në sprovë. Përgjatë gjithë kohës së vënies në sprovë, Faraoni bëri përpjekje që të sillej me mosrespekt dhe përbuzje ndaj Zotit. Prandaj, pendimi i tij, i bazuar në frikë, nuk i solli atij shpëtimin.

Ky do të duhej të ishte një paralajmërim posaçërisht i rëndësishëm për të gjithë ata që besuan në “një jetë të shfrenuar” dhe shtynë permbushjen e përgjegjësive të tyre fetare në vitet e vonshme të jetës së tyre. Mirëpo, permbushja e detyrave fetare nuk do të duhej të shtyhej në asnjë mënyrë. Përveç për ata për të cilët Zoti ka paracaktuar një gjë të tillë, njerëzit të cilët shtyejnë formimin e një vetëdijeje fetare në moshën e re, në fund do të arrijnë fazën e vonshme të jetës së tyre kur besimi dhe pendimi më nuk kanë vlerën e njëjtë. Zoti na bën të ditur këtë fakt në vazhdim:

Allahu pranon vetëm pendimin e atyre që bëjnë gjynah nga padija dhe marrëzia dhe pendohen menjëherë pas kësaj dhe janë mu këta të cilët do t'i falë Allahu dhe Allahu është kurdoherë i Gjithëdituri, më i Urti Gjithëgjykues. Dhe pa asnjë përfitim është pendimi i atyre të cilët vazhdojnë të bëjnë vepra të këqia derisa t'u vijë përballë vdekja dhe pastaj thot: “Tani pendohem”; as edhe pendimi i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për ta Ne kemi përgatitur dënim të dhimbshëm. (Kur'an, 4:17-18)

Sigurisht që përqafimi i besimit nga ana e Faraonit në çastin e fundit dhe kërkimi i faljes nga ana e tij, nuk u pranuan nga Zoti. Zoti na njofton ne për gjendjen e Faraonit dhe shoqëruesve të tij në ferr si vijon:

Përballë Zjarrit ata do të sillen mëngjes e mbrëmje dhe ditën e kur do të vendoset Ora (do t'u thuhet melekëve): “Futeni popullin e Faraonit në ndëshkimin më të rreptë!” Dhe kur të jenë duke u grinder në Zjarr, të dobëtit do t'u thonë atyre që ishin kryelartë: “Vërtetë që ne ju ndoqëm ju. A mundeni tani të merrni prej nesh ndopak nga Zjarrin?” Ata që ishin kryelartë do të thonë: “Ne jemi të gjithë në këtë (Zjarr)! Vërtetë që Allahu ka gjykuar mes robërve të Tij!” (Kur'an, 40:46-48)

Në jetën e përjetshme, me Vullnetin e Zotit, të gjithë ne do të shohim vuajtjet që do t'i shkaktohen Faraonit dhe parisë së tij që ishin përpjekur të mendojnë Musain dhe besimtarët që ndoqën atë. Në ndërkohë, ne do të duhej t'i lutemi Zotit që të jemi prej atyre që do të shohin ndëshkimin e rëndë të Faraonit, jo sikurse ata me të ne Ferr, por sikurse ata që janë në mesin e shërbëtorëve të drejtë të Zotit në Parajsë.

ARROGANCA E KARUNIT DHE NDËSHKIMI I TIJ

Bashkë me Faraonin, Karuni përmendet si njëri prej atyre që u shkatërruan në kohën e Musait.

Kur'ani na njofton se Karuni ishte pronari i një pasurie të madhe në Egjipt, përkundër faktit se ishte pasardhës i fisit Izraelit.

Vargu vijues tregon se Karuni iu kundërvu Musait së bashku me Faraonin:

Dhe padyshim që Ne e dërguam Musain me Shenjat Tona dhe me autoritet të qartë te Faraoni, Hamani dhe Karuni, por ata e quajtën dhe i thanë: “Magjistar gënjeshtar!” (Kur’an, 40:23-24)

Vlen të përmendet se Karuni, i cili ishte me Faraonin, ishte gjithashtu përgjegjës i një thesari të madh:

Vërtetë që Karuni ishte prej popullit të Musait por ai u soll me kryeneçësi ndaj tyre. Dhe Ne i dhamë atij gjithë thesaret e begatitë, aq sa çelësat ishin një peshë e madhe për t’u mbajtur për një grup të madh burrash të fortë... (Kur’an, 28:76)

Pasuria e madhe dhe pozita që Karuni kishte në Egjipt, për shkak të afërsisë së tij me Faraonin, e bëri atë arrogant dhe të përbuzës ndaj popullit të tij. Ai refuzoi të pranoj porosinë e Musait dhe mburrej me pasurinë e tij për t’i bërë të bijtë e Izraelit të ndjejnë dashuri ndaj jetës së kësaj bote. Në të vërtetë, pasuria e tij e madhe dhe pozita e tij shkaktoi zili tek disa prej njerëzve të fisit të Musait. Zoti na përshkruan arrogancën e Karunit dhe zilinë që ndjenin ndaj tij ata njerëz me besim të dobët që i takonin fisit Izraelit:

Kështu ai (Karuni) doli para popullit të tij me kryelartësinë e tij. Ata që ishin të dëshiruar për jetën e kësaj bote thanë: “Ah, sikur edhe ne të kishim ashtu siç i është dhënë Karunit! Vërtetë që ai ka në dorë një fat të madh.” (Kur’an, 28:79)

Besimtarët e vërtetë nga mesi i fisit Izraelit kurrë nuk anuan nga Karuni. Përkundrazi, ata kuptuan pozitën e mjerueshme në të cilën ai ndodhej dhe e paralajmëruan atë:

Kur populli i tij i tha atij: “Mos u ngazëlle (me mosmirënjohje ndaj Mirësisë së Allahut). Vërtetë që Allahu nuk i do ata që ngazëllehen.” Por kërko me atë pasuri që Allahu ta ka dhuruar Banesën

e pastajme dhe mos e harro edhe pjesën e lejuar të kënaqësisë së kësaj bote dhe bën mirësi ashtu siç ka qenë Allahu i mirë me ty dhe mos kërko rast për të bërë padrejtësi e djallëzi në tokë. Vërtetë që Allahu nuk i do çrregulluesit. (Kur'an, 28:76-77)

Këta besimtarë të njëjtë ju dhanë këshilla pjesëtarëve të vet fisit të tyre që mbanin anën e Karunit dhe i paralajmëruan të ruajnë fisnikërinë e një besimtari në sjelljen e tyre dhe kurrë të mos parapëlqejnë kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote mbi mëshirën e Zotit:

...Thanë ata që ishin të dëshiruar për jetën e kësaj bote: “Ah, sikur edhe ne të kishim ashtu sisikur edhe ne të kishim ashtu siç i është dhënë Karunit! Vërtetë që ai ka në dorë një fat të madh.” Por ata të cilëve u ishte dhuruar dija (e fesë) thanë: “Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut (në Jetën e Përtejme) është tejet më i mirë për ata të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi dhe këtë askush nuk do ta arrijë përveç atyre që janë të duruar.” (Kur'an, 28:79-80)

Arsyeja kryesore pse Karuni humbi rrugën ishte besimi i tij se ishte i pushtuar nga “dijenja.” Me fjalë të tjera, ai kishte një qëndrim prej mburracaku se ishte më superior se të tjerët.

Ai (Karuni) tha: “Kjo më është dhënë mua vetëm për shkak të zgjuarsisë që kam unë.” A nuk e dinte ai se Allahu ka shkatërruar para tij breza të tërë më të fuqishëm se ai dhe me pasuri të mbledhur akoma më të madhe? Por keqbërësit as që do të pyeten për mëkatet e tyre (sepse Allahu i njeh mirë ata dhe do të ndëshkohen pa llogari). (Kur'an, 28:78)

Sidoqoftë, në fund, arroganca e Karunit nuk i solli atij asgjë tjetër pos dëm. Ai i solli vetes vuajtje të mëdha duke mos qenë mirënjohës ndaj Zotit, duke besuar me arrogancë se gjithë pasuria e tij ishte fituar duke iu falënderuar meritave të tij. Karuni më në fund kuptoi se ai ishte një shërbëtor i

pafuqishëm dhe i paaftë i Zotit, kur Zoti shkatërroi plotësisht pasurinë e tij, që e kishte bërë atë të mburrej aq shumë me të:

Kësisoj Ne bëmë që atë ta përpijë toka bashkë me vendbanimin e tij. Pastaj ai nuk pati as një grusht njerëzish ta ndihmonin atë përkundër Allahut, as nuk ishte prej atyre që mund të shpëtonin vetveten. (Kur'an, 28:81)

Ajo që i ndodhi Karunit ishte një paralajmërim dhe një ndodhi nga e cila ata përreth tij, sikurse edhe gjeneratat e ardhshme, do të nxjerrnin mësim. Ata të cilët ndjenë keqardhje për të menjëherë kuptuan se ajo që ata kishin dëshiruar aq shumë ishte në të vërtetë e përkohshme dhe përfundimisht e pavlerë. Ata kuptuan se ata që mburren për pronat dhe pasurinë e tyre kurrë s'mund të arrijnë shpëtimin dhe se në fund duhet të japin llogari për veprat e tyre:

Dhe ata që kishin dëshiruar një pozitë të atillë si e atij një ditë më parë, filluan të thonë: “A nuk e dini se është Allahu ai që e shton Rizkun (furnizimin dhe mirësitë) ose e pakëson atë për kë ai do për robërit e tij? Po të mos kishte qenë Allahu i Mëshirshëm ndaj nesh Ai do ta kishte bërë tokën t'na gëlltiste ne të gjithëve! A nuk e dini ju se mosbesimtarët nuk do të jenë kurrë të fituar?!” (Kur'an, 28:82)

Përfundimisht, fundi i parapërgatitur për Faraonin dhe Hamanin, ishte fundi i njëjtë me të cilin u ndesh Karuni:

Edhe Karunin, edhe Faronin, edhe Hamanin (gjithashtu i shkatërruam Ne). Dhe Musai padyshim që iu shkoi atyre me Shenja të Qarta, por ata ishin kryelartë në tokë, e prapseprap ata nuk mund të na shmangeshin Neve (Ndëshkimit Tonë). (Kur'an, 29:39)

Tregimi për Karunin qartë na mëson se Zoti nuk derdh nga mëshira e Tij mbi ata që janë arrogant për shkak të pasurisë dhe pronave të tyre dhe që e konsiderojnë veten si më të mençur dhe më të dijshtëm se të tjerët. Në Kur'an, Zoti na jap gjithashtu shembuj për popujt e tjerë të së kaluarës. Shumë qytetërime të së kaluarës kishin arritur zhvillim të madh dhe pasuri të mëdha materiale. Prapseprap, të gjitha këto qytetërime u fshinë nga faqja e dheut. Zoti ktheu prapa shpirtërat e këtyre njerëzve që kishin besuar të ishin sundimtarët e tokës dhe i shndërroi pallatet e tyre në rrënoja:

Dhe shumë prej vendbanimeve vërtetë i shkatërroam Ne, ku ata ishin të dhënë pas së keqes duke mbetur nën gërmadha (deri më sot) si dhe shumë puse uji të braktisur dhe pallatë madhështore! (Kur'an, 22:45)

Në tregimin për Karunin mësojmë edhe një tjetër mësim: që të mos mashtrohemi nga joshja e pasurisë së përkohshme të kësaj bote dhe të atyre që i posedojnë ato. Ata nga të cilët duhet të anoj një besimtar janë njerëzit që përballojnë vështirësi në rrugën e Zotit, ata që shpenzojnë pasuritë e tyre dhe jetojnë për hir të Zotit dhe ata njerëz të përkushtuar dhe të urtë, zemrat e të cilëve janë përplot dashuri për Zotin. Siç ka thënë Profeti Muhamed (saas): *“Zoti nuk shikon pamjen tuaj dhe pasuritë tuaja, por Ai shikon në zemrat tuaja dhe në veprat tuaja.”* (Muslim) Ata që të lënë përshtypjen se qojnë një jetë luksoze dhe të përparuar, në të vërtetë jetojnë një jetë pa vlera shpirtërore. Çdo ditë i shpie këta njerëz drejt vuajtjeve të përrjetshme të ferrit. Zoti shpjegon këtë në këtë mënyrë:

Pra, mos t'i marrin mendët as pasuria e tyre, as fëmijët e tyre. Në të vërtetë Allahu do që t'i ndëshkojë ata me këto në jetën e kësaj bote dhe që t'u ndahet shpirti që këtej duke qenë mosbesimtarë. (Kur'an, 9:55)

Pasuritë nuk duhet kërkuar vetëm për kënaqësi dhe për salltanet. Duhet të kemi parasysh se Zoti e vën në sprovë njeriun edhe me pasurinë e tij. Këto pasuri iu sjellin njerëzve kënaqësi nëse përdoren për të fituar kënaqësinë e Zotit. Karuni p.sh., përfundoi në mjerim, përkundër pasurisë së tij të pallogaritshme. Rasti i Karunit është me të vërtetë një paralajmërim për të gjitha gjeneratat, si të shkuara ashtu edhe të tashme.

FISI I MUSAIT (AS) DEVIJON DHE ADHURON VIÇIN E ARTË

Pasiqë Faraoni dhe ushtarët e tij u fundosën në det, Musai shkoi me fisin e tij në një vend më të sigurt. Gjatë udhëtimit të tyre, megjithatë, u paraqitën dëshmi të mëtejshme të besimit të dobët të Izraelitëve dhe prirja e tyre nga mëkatshmëria.

Populli i Egjiptit praktikonte një religjion politeist. Ata adhuronin idhuj të shumtë. Gjatë qëndrimit të tyre në Egjipt, të bijtë e Izraelit u ndikuan gjithashtu nga ky religjion. Të bijtë e Izraelit dështuan në të përkujtuarit e Zotit dhe kështu, dështuan në ndjekjen e udhës bujare të religjioneve monoteiste që ata trashëguan nga Profetët Ibrahim (Abraham), Ishak (Isak) dhe Jakub (Jakob), paqja qoftë mbi të gjithë ata. Me kohë, ata ranë nën ndikimin e kulturës Egjiptiane,

duke përçafur disa nga zakonet dhe idetë e tyre të çoroditura. Takimi i tyre me një fis idhujtar gjatë udhëtimit të tyre nxorri në shesh pikërisht këtë prirje të tyre drejt idhujtarisë. Disa nga Çifutët nxitën një prirje të dëmshme drejt praktikave idhujtare të këtyre njerëzve dhe kërkuan nga Musai që t’ju japte një idhull:

Dhe Ne i sollëm të sigurtë Bijtë e Israilit përmes detit derisa erdhën të një popull i dhënë në adhurimin e idhujve të tyre. Ata thanë: “O Musa, na bëj edhe ne një zot siç kanë edhe këta zotërat e tyre.” Ai (Musai) u tha: “Vërtetë që ju jeni një popull që nuk dini”. Padyshim që këta njerëz do të shkatërrohen për çfarë po veprojnë (adhurimin e idhujve) dhe e gjitha kjo që po veprojnë është krejt boshe dhe e kotë. (Kur’an, 7:138-139)

Kjo prirje drejt idhujtarisë do të dilte prap në shesh. Në mesin e popullit të Musait, kishte prej atyre që nuk ndjenin frikën e duhur ndaj Zotit dhe prandaj ishin të prirur nga mosbesimi.

Musai dhe fisi i tij u nisën në drejtim të Malit Sinaj. Siç na informon Kur’ani, aty, Zoti do të “bënte një marrëveshje” me Musain gjatë qëndrimit të tij në mal për një periudhë prej dyzet ditësh. Musai me padurim la fisin e tij dhe u nis heret. Ai la fisin e tij nën kujdesin e Harunit, gjithashtu i dërguar i Zotit, i cili duhej të printe fisin Izraelit gjatë mungesës së Musait. Para se të nisej, ai e këshilloi Harunin:

Dhe Ne i caktuam Musait tridhjetë netë duke i shtuar edhe dhjetë të tjera dhe ai e plotësoi kohën e përcaktuar nga Zoti i tij prej dyzet netësh. Dhe Musai i tha vëllait të tij, Harunit: “Zëre vendin tim te populli im, vepro në Rugën e Drejtë dhe mos ndiq rrugën e keqbërësve.” (Kur’an, 7:142)

Pasiqë kishte lënë popullin e tij pas vetes, Musai arriti malin e Horebit në kohën e përcaktuar. Zoti na bën me dije në Kur'an se, atje, Ai i drejtua Musait edhe njëherë:

Dhe kur erdhi Musai në kohën dhe vendin e përcaktuar prej Nesh dhe atij i foli Zoti i tij, ai tha: “O Zoti im! M’u shfaq që të shoh ty hapur.” Allahu tha: “Ti nuk më sheh dot mua, por shiko malin, nëse ai do të mundet të qëndrojë në vendin e tij, atëherë ti do t’më shohësh Mua.” Kështu kur Zoti iu shfaq malit, Ai e bëri atë hi e pluhur, ndërsa Musai ra pa ndjenja. Pastaj kur erdhi përsëri në vete tha: “Lavdi të goftë Ty! Të kthehem Ty me pendim dhe unë jam i pari (dhe më i përkushtuari) i besimtarëve.” All-llahu i tha: “O Musa, Unë të kam zgjedhur ty mbi gjithë njerëzit me Mesazhet e Mia dhe me të Folurit Tim. Kështu pra, mbaje fort atë që të kam dhënë dhe ji prej falënderuesve. Dhe Ne shkruam për të në Pllaka mësimet për çdo gjë dhe shpjegimet për gjithçka (dhe i thamë): Mbahu fort pas tyre dhe urdhëro popullin tënd të zbatojë e të kapë më të mirën prej tyre. Shpejtë do t’ua tregoj vendbanimin të pabindurve, të panënshtuarve ndaj Allahut. (Kur’an, 7:143-145)

Në ndërkohë, mosbesimtarët nga fisi i Musait shfrytëzuan largimin e tij. Duke u sjellë me përbuzje ndaj Harunit, ata mbaruan një idhull në formën e viçit, si në religjionin Egjiptian:

Ndërsa në mungesë të tij, populli i Musait bëri nga stolitë një figurë viçi (për ta adhuruar) që lëshonte një zë sikur (pallte)... (Kur’an, 7:148)

Në ndërkohë, Zoti pyeti Musain për fisin e tij dhe për arsyen që e shtyri atë të largohej më heret:

“E ç’të bëri ty të nxitohesh prej popullit tend, o Musa?” Ai tha: “Ata janë pranë gjurmëve të mia dhe nxitova drejt Teje, o Zoti im, që ti të mund të ishe i kënaqur.” (Kur’an, 20:83-84)

Musai nuk ishte i vetëdijshtëm për këtë shkarje (gabim) të bërë nga populli i tij. Zoti na bën me dije për këtë shkelje dhe për ekzistencën e një dyfytirëshi në mesin e tyre me emrin Samiriji (Samaritani) dhe se si ai iu dha materialeve të caktuara formën e një idhulli, formën e një viçi:

All-llahu i tha: “Me të vërtetë që Ne tashmë e kemi sprovuar popullin tënd në mungesën tënde dhe Es-Samiriji i çoi në rrugë të gabuar.” (Kur’an, 20:85)

Pastaj, me marrjen e pllakave, Musai u kthye tek populli i tij:

Pastaj Musai u kthye te populli i tij i inatosur dhe i pikëlluar. Ai thirri: “O populli im! A nuk ju bëri Zoti juaj një premtim të drejtë e të vyer? A ju duk atëherë i largët ky premtim? Apo mos deshët që t’ju zbriste Zemërimi i Zotit tuaj mbi ju dhe kështuqë ju e thyet premtimin që ma dhatë mua?”

Ata i thanë: “Ne nuk e thyem premtimin ndaj teje nga dëshira jonë, por u detyruam të mbajmë peshën e zburimeve të popullit të Faraonit, pastaj i hodhëm ato (në zjarr) dhe këtë na e shtiu në mendje Es-Samiriji.” Pastaj ai nxorri (nga zjarri) për ta një statujë viçi që lëshonte një zë sikur pëlliste. Ata thanë: “Ky është zoti juaj dhe zoti i Musait, ndërsa Musai e ka harruar (Zotin e vet).” (Kur’an, 20:86-88)

Ky tregim na jap hollësi të qarta për mënyrën se si pjesëtarët e një komuniteti, që kanë sëmundje në zemrat e tyre, mund të joshen nga një dyfytirësh të shmangen nga përkujtimi i Zotit. Për të krijuar kaos dhe çrregullim, njerëzit dyfytirësh gjithmonë kërkojnë disa situata që iu shkojnë për shtati. Gjatë mungesës së Musait, rrethanat ishin të përshtatshme që hipokritët të largojnë nga udha e drejtë njerëzit që tashmë kishin treguar prirje ndaj mëkatshmërisë. Samiriji (Samaritani) u paraqit mu në një kohë të tillë; ai ishte i vetëdijshtëm për dobësinë e këtyre njerëzve, për prirjen e

tyre nga idhujtaria. Sidoqoftë, ai e dinte se ata kishin kërkuar më parë nga Musai që t'ju bënte një idhull. I vetëdijshëm për këtë prirje të tyre, ai përpunoi një metodë për t'u siguruar që t'i largonte ata nga udha e drejtë; ai punoi një shtatore të një viçi dhe për t'i arsyetuar veprimet e tij, ai pohoi se shtatorja ishte e zotit të përparshëm të Musait, por të cilin ai e harroi më vonë.

Sikur që Musai ishte i paepur në besimin e tij dhe udhëzoi popullin e tij nga drejtësia kur u konfrontua nga Faraoni dhe ushtarët e tij në breg të detit, Samiriji (Samaritani) udhëzoi po të njëjtin njerëz në mëkatshmëri. Kjo është dëshmi e ndikimit të dobishëm që një person besimtar mund të ketë mbi një shoqëri dhe të dëmit që një njeri dyfytërësh mund t'i sjellë asaj.

Në të vërtetë, Haruni kishte paralajmëruar fisin e tij dhe iu kishte shpjeguar që po shmangeshin nga rruga e drejtë. Megjithatë, njerëzit nuk i vunë veshin paralajmërimit të tij:

Edhe Haruni padyshim që iu kishte thënë atyre më parë: “O populli im!

Ju po sprovoheni me këtë gjë dhe nuk ka dyshim që Zoti juaj (Allahu) është i Gjithmëshirshmi, andaj më ndiqni mua dhe bindjuni urdhërit tim.”

Ata i thanë: “Ne nuk do të ndahemi së adhuruari atë (viçin), derisa të kthehet Musai tek ne.” (Kur'an, 20:90-91)

Vargu paraprirës qartë dëshmon faktin se populli i Musait ndoqi atë vetëm për arsye se e pranuan si udhëheqës. Po t'kishte qenë bindja tyre e bazuar në besim të thellë, situata atëherë do të ishte ndryshe, ata gjithashtu do të ndiqnin menjëherë Harunin, duke parë se ai gjithashtu ishte një i dërguar i Zotit. Megjithatë, duke mos e pranuar atë si udhëheqës të tyre ata nuk iu përgjigjen

thirrjeve të tij. Çka është edhe më e keqe, ata madje u përpoqën ta vrisnin atë kur ai u përpoq t'i parandaloj ata nga ndjekja e udhës së gabuar:

Ai (Musai) tha: “O Harun! Çfarë të ndali ty kur i pe ata që po gabonin, dhe nuk më ndoqe mua (siç të këshillova)? A e ke thyer urdhërin tim?”

Ai (Haruni) tha: “O biri i nënës sime! Mos më kap për mjekre e as për koke. Në të vërtetë unë kisha frikë se mos thua: “Ti ke shkaktuar ndonjë mosmarrëveshje mes Bijëve të Israilit dhe nuk e ke respektuar fjalën time!” (Kur'an, 20:92-94)

Haruni tha: “O biri i nënës sime! Vërtetë që populli më quajti mua të dobët dhe gadi s'më vranë, kështuqë mos i bëj armiq të e mi të qeshin me mua dhe mos më quaj mua se jam me popullin keqbërës.”

Musai tha: “O Zoti im! Më fal mua dhe vëllain tim dhe na shtjerë në Mëshirën Tënde, sepse Ti je më Mëshirëploti i mëshiruesve.” (Kur'an, 7:150-151)

Në përgjigjen e Harunit, Musai liroi atë dhe iu drejtua Samirijit (Samaritanit), personit të vërtetë përgjegjës për këtë devijim nga ana e fisit. Ai i bëri atij pyetje për keqbërjen e tij. Në një përpjekje për të shfajësuar veten, Samiriji (Samaritani) shpjegoi se atë që kishte bërë ai, kishte bërë për një arsye; ai pohoi të kishte vërejtur gjëra që të tjerët s'kishin mundur t'i vërejnë. Ai gjithashtu shtoi se uni i tij e kishte shtyrë atë të bënte atë që kishte bërë:

I tha (Musai Samirijit): “Dhe si është puna me ty, o Samirij? (Pse veproje kështu?)” (Samiriju) i tha: “Unë pashë atë që ata nuk e pane; kështu unë mora një grusht (pluhur) nga gjurma e të dërguarit (gjurma e kalit të Xhibrilit) dhe e hodha atë (në zjarrin në të cilin ishin

hedhur stolitë e popullit të Faraonit). Kështu më shtyri të bëj shpirti im.” (Musai) i tha: “Ik që këtej atëherë! E padyshim se ndëshkimi yt në këtë jetë do të jetë që të thuash, “Mos më prekni! (Dhe do të jetosh i vetëm e i braktisur larg njerëzve)””; dhe sigurisht që (për ndëshkimin e ardhshëm) ti do të kesh një premtim që nuk do të harrojë. Shihe edhe të adhuruarin tënd (viçin) të cilit ti i qe përkushtuar. Sigurisht që ne do ta djegim e ta shkrijmë dhe hirin e tij do ta shpërndajmë nëpër det”. (Kur’an, 20:95-97)

Këtu duhet të përmendim se Samiriji (Samaritani) i bëri këto vepra të këqija nën përshtypjen e rrejshme se ai ishte më i mençur dhe më largpamës se të tjerët. Kjo arrogancë e tij mund qartë të dallohet në fjalët e tij “Unë pashë atë që ata nuk kishin parë.” Këto ndjenja të madhësisë dhe krenarisë ndikuan që Samiriji (Samaritani) të devijoj me lehtësi nga prirjet negative të shpirtit të tij dhe nga Shejtani. Në këto ndikime negative, ai nuk mundi t’i shpëtojë joshjes që të “bëj diç të ndryshme” dhe që të bëhej udhëheqës për të larguar fisin nga udha e drejtë.

Përkundrazi, një besimtar i vërtetë kurrë nuk vepron duke pandehur se është më i mençur apo më superior se të tjerët. Ai është i vetëdijshëm për mospërkryerjen e tij dhe kërkon strehim/mbrojtje tek Zoti nga bërja e mëkateve. Edhe poqese vëren gjëra që të tjerët dështojnë t’i vërejnë, ai e merr këtë si një bekim dhe sprovë nga Zoti dhe sillet në pajtim me të. Po të ndodhte kështu, ai vetëm thot: “Zoti më bëri të shoh këtë; urtësia i takon vetëm Zotit.”

Mirëpo, në rastin e Samirijit (Samaritanit), ajo që ai vërejti ishte vetëm ajo që e drejtoi atë kah mëkatshmëria dhe e keqja. Në lidhje me këto zhvillime, Musai ndërmori dy masa të rëndësishme kundër të keqës që Samiriji (Samaritani) kishte bërë. Ai së pari dëboi Samirijin (Samaritanin), burimin e së keqes dhe mëkatit në fis. Masa e dytë ishte të shkatërrohej idhulli tërësisht. Idhulli që

fisi adhuroi duhej të digjej tërësisht dhe hiri i tij të hudhej në det, në mënyrë që askush t' mos ishte në gjendje ta gjente prap.

Në mënyrë të qartë, Musai ishte shumë i sinqertë dhe shumë i përkushtuar ndaj fesë. I brengosur për atë që kishte çuar popullin në mosbesim, Musai ndërmori masa të vendosura dhe të duhura për ta çrrënjësuar atë. Ky vetbesim është një cilësi e përbashkët për të gjithë profetët dhe udhëheqësit besnik që kanë ndjekur rrugën e tyre.

Pas shkatërrimit të të gjitha burimeve të ligësisë, Musai i predikoi fisit të tij, duke i thirrur ata që të pendohen dhe t'i binden Zotit:

Kujtoni edhe kohën kur Musai i tha popullit të vet: “O populli im! Me të vërtetë që ju i bëtë padrejtësi vetes suaj duke adhuruar viçin. Kthehuni pra me pendim te Krijuesi juaj dhe vrisni veten tuaj (të pafajshmit le të vrasin keqbërësit nga mesi juaj). Kjo do të jetë më mirë për ju para Krijuesit tuaj.” Pastaj Ai e pranoi pendimin tuaj, Sigurisht që Ai është i Cili gjithnjë pranon pendimin (e robërve të Tij), Mëshirëploti. (Kur'an, 2:54)

Fjalët e Musait patën ndikim të vogël në popullin e tij. Fillimisht, të bijtë e Izraelit i kushtuan vëmendje paralajmërimeve të tij, u penduan dhe u kthyen nga Zotit i tyre. Mirëpo, ky ndryshim ishte i përkohshëm. Siç do të shihet në faqet vijuese, të bijtë e Izraelit shfrytëzuan secilin rast për t' mos iu bindur Musait, duke e mundur atë psikikisht dhe emocionalisht në çdo kuptim.

SJELLJA E ÇORODITUR E FISIT HEBREIT

Fillimisht, Musai drejtoi luftën e tij kundër Faraonit. Para se të vinte Musai, populli i tij, të bijtë e Izraelit, ishin duke vuajtur në robëri. Për këtë arsye, posa që Musai bëri planin për t’u larguar, i tërë fisi vullnetarisht e ndoqi atë dhe lëshoi Egjiptin. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton një besim të sinqertë nga ana e tyre. Në mësin e tyre kishte njerëz që iu bashkuan vetëm për shkak të besnikërisë fisnore. Sipas të gjitha gjasave, shumica e tyre e panë Musain si një udhëheqës politik i cili iu ofroi mundësinë që të lirohen prej tiranisë. Prandaj, në vend se t’ia nënshtronin veten rrugës së drejtë, shumë prej tyre shfrytëzonin secilin rast për t’iu rikthyer praktikave idhujtare. Pra, ata vazhdimisht e sfidonin Musain dhe i rezistonin fesë së vërtetë të sjellur nga ai.

Së pari, Zoti urdhëroi Musain të ndante të bijtë e Izraelit në dymbëdhjetë fise të veçanta:

Dhe Ne i ndamë ata (popullin e Musait) në dymbëdhjetë fise – bashkësi të dalluara mes tyre. Ne e drejtuam Musain me frymëzim (Hyjnor), kur populli i tij i kërkoi ujë, duke i thënë: “Bjeri gurit me shkopin tënd!” Dhe që andej gurgulloi uji nga dymbëdhjetë kroje (burime) dhe secili fis e dinte krojin (burimin) e vet. (Kur’an, 7:160)

Shumica e bijëve të Izraelit dështoi në formimin e një besimi të rrënjosur thellë në zemrat e tyre. Ata patën guximin të kërkojnë nga Musai t’ua tregonte Zotin, madje deri në atë masë sa të pohonin paturpësisht se ata nuk do të besonin po të mos i bindej një dëshire të tillë:

Kujtoni edhe kohën kur ju thatë: “O Musa! Ne kurrë nuk do të besojmë ty, derisa ta shohim Allahun qartë me sytë tonë.” Por ju u goditët papritur si me shkrepëtimë rrufeje ndërsa po vështronit. (Kur’an, 2:55)

Me sa duket, tiparet e këtij kombi ishin lakmia dhe mosmirënjohja. Si mbështetje për të bijtë e Izraelit, Zoti përgatiti ushqim si mrekulli për ta. Ky ushqim, të cilit në Kur’an i referohet si “manë dhe shkurta (thëllëza)”, nuk arriti të kënaq të bijtë e Izraelit, edhe pse kjo ishte një mirësi nga Zoti:

Ne ju bëmë hije me re dhe dërguam mbi ju El-Menna (manë/rrëshirë të ëmbël) dhe Es-Selva (shkurttat) duke ju thënë: “Hani nga gjërat e mira të lejuara, me të cilat Ne ju kemi furnizuar,” (por ata kundërshtuan). Dhe ata nuk na bënë aspak keq Neve, por ata vetëm i bënë keq vetvetes së tyre. (Kur’an, 2:57)

Kujtoni edhe kohën kur ju thatë: “O Musa! Ne nuk mund të durojmë vetëm një lloj ushqimi. Lutju pra Zotit tënd për ne që t’na nxjerrë neve çfarë rritë toka - perimet e saj, trangujt, drithërat, thjerrëzat dhe qepët e saj.” Ai u tha: “A do ta ndërroni atë që është më e mirë për ju me atë që është më e keqe? Zbritni në çfarëdo qyteti dhe atje do të gjeni ato që dëshironi!” (Kur’an, 2:61)

Kjo ishte edhe një shenjë e qartë e mosmirënjohjes së madhe që shfaqën të bijtë e Izraelit.

RRËFIMI PËR LOPËN

Populli i Musait duket qartë që në asnjë moment nuk e kishte kuptuar besimin e vërtetë. Siç u përmend më heret, ata me sa duket e ndoqën Musain, jo pse donin të fitonin kënaqësinë e Zotit, por për shkak se në të panë një udhëheqës të fuqishëm dhe të vendosur.

Në një përpjekje që t'ia përshtatnin fenë hyjnore dëshirave të tyre dhe praktikave të tyre të lashta fetare, ata i bënë asaj shtrembërime të qëllimta. Duke shpërfillur në tërësi natyrën e thjeshtë dhe të qartë të religjionit, ata e bënë atë të ndërlikuar dhe të vështirë për t'u zbatuar. Ata ishin të prirur të adhuronin idhujt në vend të Zotit dhe e shndërruan religjionin në një varg ritualesh.

Prirja e tyre që të ndërlikonin religjionin pa nevojë më së miri shpjegohet në një rrëfim që rrëfëhet në Suren Bekare. Në këtë rrëfim, Zoti urdhëron të bijtë e Izraelit që të sakrifikojnë një lopë. Urdhëri, i përcjellur nga Musai tek fisi i tij, është një urdhër i thjeshtë. Mirëpo, bijtë e Izraelit këtë urdhër të qartë dhe të lehtë e ndërlikuan dhe u morën me të gjitha llojet e hollësive të parëndësishme që nuk u kërkuan prej tyre. Në të vërtetë, ata shkuan aq larg sa t'i thonë të dërguarit të Zotit: “A je duke u tallur me ne?”:

Kujtoni edhe kohën kur Musai i tha popullit të tij: “Vërtetë që Allahu ju urdhëron të therrni një lope”, (ndërsa) ata i thanë: “A don të tallesh me ne?” Ai u tha: “I mbështetem Allahut të më mbrojë që t'mos jem prej të paditurve.”

Ata i thanë: “Lutju Zotit tënd për ne t'na e bëjë mirë të qartë se ç'është ajo (që na kërkohet)?

Ai u tha: “Ai thot ‘ajo është thjeshtë një lope, as e vjetër e as e re, por të jetë mes dy anëve’, zbatoni pra atë që jeni urdhëruar për të bërë.”

Ata i thanë: “Lutju Zotit tënd për ne t’na e bëjë mirë të qartë ngjyrën e saj.”

Ai u tha: “Ai thot, ‘Të jetë lopë në ngjyrë të verdhë të ndezur që i kënaqë ata që e shohin.’”
Ata i thane (përsëri): “Lutju Zotit tënd për ne t’na e bëjë mirë të qartë çfarë lloji është, sepse vërtetë për ne të gjitha lopët janë njësoj dhe sigurisht, nëse don Allahu ne do të udhëzohemi drejt.”

Ai (Musai) u tha: “Ai thot, ‘Të jetë lopë e paushtruar për të punuar tokën apo për të ujitur fushat, e shëndoshë dhe të jetë vetëm në ngjyrë të verdhë të ndezur.’” Ata i thanë: “Tani na e solle të vërtetën.” Kështuqë ata e therrën atë dhe nuk e kishin ndërmend ta bënë (dhe qenë fare pranë moskryerjes së këtij urdhëri). (Kur’an, 2:67-71)

Siç rrëfhet më lartë, fisi i Musait vazhdimisht kundërshtonte urdhërat e Zotit. Vetëm kur urdhëri bëhej gadi i pazbatueshëm, për shkak të hollësive të parëndësishme që ata kërkonin, ata lëshonin pe. Në të vërtetë, urdhëri ishte mjaft i qartë: flijoni një lopë.

Hedhja e një vështrimi hulumtues Judaizmit sot do të zbuloj këtë mënyrë të njëjtë kokëfortë të gjykimit të Çifutëve. Talmudi, institucioni tradicional i mësimi Çifut, përmban në vete hollësira hutuese në lidhje me jetën e përditshme dhe lutjet. Për shembull, nga mjelja e një kafshe deri te përdorimi i temjanit të ndezur, njeriu mund të gjej hollësi të panumërta që me sa duket janë të parëndësishme për religjionin. Në Judaizëm, përpikmëria e një personi në vënjen re të këtyre hollësive, në jetën e tij të përditshme dhe në lutje, mendohet të jetë kyçe për devotshmërinë e tij. Thelbi i vërtetë i përkushtimit në anën tjetër, domethënë, besimi në Zotin dhe në Ditën e

Gjykimit është shpërfillur në tërësi. Si i tillë, Judaizmi është shndërruar në një grumbull ritualesh të pa rëndësishme për bazat e besimit, si përkujtimi i Zotit, mëshira e Zotit dhe dashuria ndaj Tij.

NGRITJA E TË BIJËVE TË IZRAELIT KUNDËR URDHËRIT TË ZOTIT

Me largimin e të bijëve të Izraelit nga Egjipti, Zoti u premtoi një vendlindje në të cilën do të banonin. Shumë kemi folur për kundërshtimet e ngritura kundër Musait gjatë këtij udhëtimi në faqet e mëparshme. Kjo prirje e tyre vazhdoi deri kur ata arritën në Tokën e Premtuar:

Kujto kur Musai i tha popullit të tij: “O populli im! Përkujtoni Mirësitë e Allahut mbi ju, kur ai nxori Pejgamberë nga gjiri juaj, ju bëri mbretër dhe ju dha çfarë Ai nuk i kishte dhënë në gjithë Alemin (ndër njerëz e xhinde më parë). O populli im! Hyni në Tokën e Shejtë të cilën Allahu e ka përcaktuar për ju dhe mos u ktheni prapa (në arrati), sepse kështu do të ktheheni të humbur pastaj.”

Ata thanë: “O Musa! Në të (në tokën e premtuar) është një popull i fuqishëm dhe ne nuk do të hyjmë në të derisa ata të largohen prej saj. Kur ata të ikin, atëherë ne do të hyjmë në të.” (Kur’an, 5:20-22)

Ndihma e Zotit ishte gjithmonë me të bijtë e Izraelit. Zoti i shpëtoi ata nga Faraoni duke ndarë detin dhe pastaj iu dha atyre një tokë. Për më tepër, Ai iu premtoi një fitore të sigurtë poqese do

të luftonin kundër fisit tiran që banonte atje. Ata duhej të kishin mbështetur besimin e tyre në Zotin dhe të ndjeknin të dërguarin e Tij. Në vend të kësaj, ata nuk i vunë veshin paralajmërimeve të Musait dhe u treguan frikacakë. Vetëm dy prej gjithë atyre pohuan që do të mbështetnin besimin e tyre në Zotin dhe të hynin në token e premtuar:

Dy burra prej atyre të cilët e kishin frikë Allahun dhe të cilëve Allahu u kishte dhuruar Mirësinë e Tij thanë: “I sulmoni nga porta, sepse kur ju të hyni Brenda, fitorja do të jetë e juaja dhe vini shpresat tuaja vetëm tek Allahu, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Kur’an, 5:23)

Përkundër paralajmërimeve të tilla, bijtë e Izraelit kundërshtuan të dërguarin e Zotit dhe iu drejtuan atij me mosrespekt:

Ata thanë: “O Musa! Ne kurrë nuk do të hyjmë në të, përderisa ata janë aty. Kështuqë shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni ju të dy, ndërsa ne nuk po luajmë fare prej këtu ku jemi.” (Kur’an, 5:24)

Pafytyrësia e popullit të Musait erdh e u keqësua aq shumë sa ata në të vërtetë filluan t’i injoronin fjalët e profetëve të tyre dhe haptazi t’i kundërshtonin ata. Prandaj, Musai iu lut Zotit të tij dhe kërkoi nga Ai që ta shpëtonte atë dhe vëllaun e tij Harunin nga ky popull i pacipë:

Ai (Musai) tha: “Zoti im! Unë nuk kam fuqi veçse për veten time dhe për vëllain tim, kështuqë na veço ne nga populli që është i panënshtuar dhe i pabindur ndaj Allahut.” Ai (All-llahu) tha: “Atëherë ajo (toka e shenjtë, e premtuar) ju ndalohet atyre për dyzet vjet. Të humbur do të enden nëpër tokë. Kështuqë mos të të vij keq për popullin e panënshtuar dhe të pabindur ndaj Allahut.” (Kur’an, 5:25-26)

Siç përmendet këtu, të bijëve të Izraelit iu ndalua hyrja në Tokën e Premtuar për dyzet vite, për shkak të paturpësisë që ata kishin treguar ndaj Zotit dhe të dërguarit të Tij.

Një pjesë të madhe të jetës së tij, Musai kishte bërë përpjekje që të përcjellte porosinë e Zotit tek ata. Ai u përpoq që të shpëtonte fisin e tij nga adhurimi i idhujve dhe t'i udhëzonte drejt fesë së vërtetë. Qëllimi i tij ishte vetëm të paralajmëronte njerëzit dhe t'i shpëtonte ata nga vuajtjet e Ferrit, mision që ai kreu vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit. Për këtë qëllim, ai u ballafaqua me Faraonin dhe bëri përpjekje që të çlironte popullin e tij nga besimet e kota. Sidoqoftë, ai u bë objekt i mizorive të Faraonit, sikurse edhe i popullit të tij. Megjithatë, ai ishte një shërbëtor bujar, i cili jetoi vetëm për të arritur kënaqësinë e Zotit dhe Zoti ynë e shpëtoi atë nga gjithë vështirësitë që iu shkaktuan atij.

Mund të nxjerren mësim nga mosmirënjohja e të bijëve të Izraelit, nje popull që nuk ndoqi hapat e profetëve të tyre, që ia kthyen shpinën fesë që iu besua atyre dhe që ishin aq të çoroditur sa të thonë: “shkoni e luftoni ti dhe Zoti yt.” Zoti ka paralajmëruar njerëzimin për paturpësinë që të bijtë e Izraelit treguan ndaj profetit të tyre:

O ju që keni besuar! Mos jini si ata që e fyen Musain, por Allahu e pastroi atë nga (shpifja) që i ngjiten dhe ai ishte i nderuar tek Allahu. (Kur'an, 33:69)

MUSAI (AS) DHE NJË NJERI I DITUR

Edhe një tregim për Musain rrëfëhet në Suren Kahf. Duke e lexuar tregimin, është vështirë të përcaktohet saktësisht se gjatë cilës pjesë të jetës së Musait ndodhën këto ngjarje. Mund të supozojmë, megjithatë, të kenë ndodhur pas largimit të Musait nga Egjipti me të bijtë e Izraelit. Tipari dallues i këtij tregimi është shpjegimi i ngjarjeve të rrëfyera në mënyrë simbolike. Tregimi mbështetet në një dialog në mes të Musait dhe të një njeriu të urtë. Në fillim të tregimit, Musai bën një udhëtim me ndihmësin (shërbyesin) e tij të ri:

Kujto edhe kur Musai i tha shërbyesit të tij: “Nuk do të ndalem derisa të arrijë vendin ku takohen dy detet ose derisa të kaloj vite e vite në udhëtim.”

Por kur ata mbërritën në vendin e bashkimit të dy deteve, ata harruan peshkun e tyre i cili e hapi rrugën e tij për në det (si një tunel). Kështu kur ata shkuan më tej (përtej vendit të caktuar për takim), Musai i tha djaloshit: “Na e sjell ushqimin e mëngjesit, vërtetë që jemi lodhur shumë në këtë udhëtimin tonë.”

Ai (shërbyesi i Musait) tha: “A e sheh çfarë ndodhi? Kur ne shkuam të gjejmë strehim te shkëmbi, unë e harrova peshkun. Askush përveç Shejtanit nuk më bëri që të harroj ta kujtoj. Ai gjeti rrugën për në det në mënyrë të habitshme!”

Ai (Musai) i tha: “Kjo është ajo që po kërkonim.” Kështu që ata u kthyen prapa duke ndjekur gjurmët e tyre të para. (Kur’an, 18:60-64)

Mësime të rëndësishme mund të merren nga këto vargje. Thënia “Na e sjell ushqimin e mëngjesit, vërtetë që jemi lodhur shumë në këtë udhëtimin tonë,” tregon se Musai ushqehet në të njëjtën kohë kur ndalet për të pushuar, gjersa të tjerët me gjasë do të pushonin dy herë për të përmbushur këto dy nevoja. Në thelb, ky vendim i tij tregon se një Musliman do të duhej të shfrytëzonte kohën e tij me mençuri.

Edhe një mësim tjetër hyjnor që këto vargje zbulojnë është të harruarit e ushqimit gjatë udhëtimit dhe roli i Shejtanit në të harruarit e tij. Ndikimi i padiskutueshëm që Shejtani ka në njerëz, domethënë, fakti që ai mund ta bëj njeriun të harroj, theksohet këtu. Për shembull, Shejtani bën që njeriu të harroj në mënyrë që ta pengoj atë që të kyçet në diç të mirë për religjionin dhe për hir të Muslimanëve. Qëllimi i tij kryesor është që t’i pengoj njerëzit në përkujtimin e Zotit dhe në të menduarit për Të. Gjëja më e mirë që një besimtar mund të bëj për t’iu kundërvënë përpjekjeve të Shejtanit është që të mbaj veten të zënë me përkujtimin e Zotit.

Mësimi i tretë hyjnor që nxjerrim nga dialogu në fjalë është vigjilenca e Musait ndaj shenjave të Zotit. Me të vërtetë, ai menjëherë e merr të harruarit e ushqimit nga ana e tij si një shenjë dhe prandaj ndërron drejtim. Kjo tregon se Musai është një njeri që vazhdimisht është i zënë me përkujtimin e Zotit, që e bën atë plotësisht të vetëdijshëm që Zoti paracakton (urdhëron) të gjitha rrethanat në jetë. Kjo e bën atë një njeri të ditur, të aftë që të arrijë deri te përfundime të shëndosha për ato që ndodhin rreth tij.

Musai dhe shoqëruesi i tij i ri e muarën harresën e tyre si shenjë dhe u kthyen duke ndjekur gjurmët e tyre prapa. Më vonë, Musai e takoi një person. Kur’ani nuk përmend emrin e këtij personi, të cilit Zoti i dhuroi mençuri të madhe, por tradita e quan atë Khidr. Edhe pse Musai

ishte i gatshëm që të mësonte nga mençuria e tij, ky njeri i mençur haptazi i tha se nuk do të mund të ishte i durueshëm. Tregimi është si vijon:

Pastaj ata gjetën një nga robët Tonë, tek i cili Ne kishim dhuruar mëshirë prej Nesh dhe të cilit Ne i kishim mësuar dije nga e Jona. Musai i tha atij (Khidrit): “A mund të të vijë pas, që ti t’me mësosh mua diçka nga ajo dije që të është mësuar ty nga Allahu?” Ai (Khidri) i tha: “Sigurisht që ti nuk do të jesh në gjendje të kesh durim e përmbajtje me mua. Dhe si mund të kesh durim për një gjë që ti nuk e di?”

Musai i tha: “Në dashtë Allahu, do t’me gjesh mua të durueshëm dhe nuk do të të kundërshtoj në asgjë.”

Ai (Khidri) i tha: “Atëherë, nëse ti më ndjekë mua, mos më pyet për asgjë, derisa unë vet të ta zë në gojë.”

Kështu vazhduan ata të dy bashkë derisa, kur hipën në një anije, ai (Khidri) e shpoi atë. Musai i tha: “A e shpove që t’i fundosësh njerëzit në të? Vërtetë që ke bërë një gjë (punë) të keqe e të urryer.”

Ai (Khidri) i tha: “A nuk të thashë se ti nuk do të jesh në gjendje të kesh durim me mua?” Musai i tha: “Mos më qorto për çfarë harrova dhe mos ji i ashpër me mua duke më sjellë vështirësi në çështjen time me ty.” Pastaj ata vazhduan të dy derisa takuan një djalë të cilin ai e mbyti. Musai i tha: “Ke mbytur një njeri të pafajshëm i cili s’ka vrarë kënd! Vërtetë që ke bërë një punë të shëmtuar e të tmerrshme!”

Ai (Khidri) i tha: “A nuk të thashë se ti nuk do të jesh në gjendje të kesh durim me mua?” Musai i tha: “Nëqoftëse të pyes më ndonjë gjë pas kësaj, atëherë mos më mba më në shoqëri me ty. Tashmë e tutje ke marrë arsye të plotë prej meje.”

Pastaj të dy vazhduan derisa takuan njerëzit e një qyteti. U kërkuan atyre për të ngrënë, por ata nuk pranuan që t'i mirëpresin. Pastaj ata të dy gjetën atje një mur gati të rrëzuar, ndërsa ai (Khidri) e rindërtoi atë. Musai tha: “Po të kishe dashur, sigurisht që do të kishe marrë pagesë për të!”

Ai (Khidri) i tha: “Kjo është ndarja mes meje e teje. Unë do të tregoj shpjegimin e urtësinë për ato gjëra që ti nuk qe në gjendje të tregoj durim. Sa për anijen, ajo u takonte njerëzve të varfër që punonin në det, kështu që unë desha ta bëjë me difekt për punë, sepse pas tyre vinte një mbret i cili merrte çdo anije me forcë. Sa për djalin, prindërit e tij ishin besimtarë dhe ne patëm frikë se mos ai do t'u shkaktonte atyre dhimbje duke ngritur krye dhe duke mos besuar. Kështu që ne dëshiroam që Zoti i tyre t'ua ndërronte atyre atë me një më të mire, më të drejtë, më të pastër dhe më të dhembshëm se ai. Ndërsa për murin, ai u takonte dy jetimëve të atij qyteti dhe nën të ishte një thesar që u takonte atyre. Babai i tyre ishte njeri i drejtë dhe Zoti yt dëshironte që ata të arrinin moshën e pjekurisë së plotë dhe ta merrnin thesarin e tyre si mëshërë nga Zoti yt. Dhe unë nuk e bëra këtë sipas vullnetit tim (por sipas udhëzimit të Zotit). Ky ishte shpjegimi i urtësisë për ato gjëra që ti nuk ishe në gjendje të tregoj durim.” (Kur'an, 18:65-82)

Mësimi i paraqitur këtu meriton vëmendje të veçantë. Lehtë mund të ndodhë se pas ngjarjeve që duket të jenë ngjarje të këqija, Zoti mund të dhurojë të mira përmes tyre. Fundosja e barkës pa ndonjë arsye të dukshme ose mbytja e një fëmije që nuk ka bërë asnjë të keqe, mund të duken vepra të këqija nëse vlerësohen pa u kuptuar në masën e duhur. Megjithatë, sikurse rrëfëhet në

tregimin e mësipërm, ka të mira dhe urtësi prapa këtyre ngjarjeve të paracaktuara nga Zoti, që as nuk janë të dukshme dhe as të kuptueshme menjëherë. Është e qartë se ndodhitë e rrëfyera në tregim kishin të gjitha rëndësinë e fshehur të tyre. Ato nuk ishin të zakonshme, ndodhi të përditshme. Ato ishin të rezervuara për një person të caktuar bujar të caktuar (emëruar) posaqërisht nga Zoti.

Njerëzit, megjithatë, do të duhej të mendonin për të mirën e pandarë në çdo gjë që bie mbi ta në jetërat e tyre të përditshme. Sot, me siguri se ka një qëllim hyjnor prapa gjërave në dukje të këqija që po ndodhin dhe për të cilat shumica thonë: “Pse gjithë këto fatkeqësi bien mbi njerëzimin?” Nëse njeriu është i durueshëm dhe përpiqet në mënyrë të sinqertë të kuptoj qëllimet hyjnore të tyre, Zoti lehtë mund ta bëjë atë që të kuptoj kuptimin e tyre të fshehtë.

PËRFUNDIM

Siç tregojnë të gjitha vargjet e përmendura gjer më tani, përmendje të gjera për Musain gjenden në shumë pjesë të Kur’anit. Jeta e tij është një shembull që gufon me mësimë dhe përkujtime të bollshme për besimtarët, duke filluar me periudhën e hershme të jetës së tij dhe me disa prej këtyre mësimëve dhe përkujtimeve ne jemi marrë në këtë libër.

Të menduarit për kuptimin e këtyre mësimëve na bën të njohim shkallën në të cilën fati në tërësi përmban jetën e një njeriu dhe të mirat që ai nënkupton për një besimtar.

Mësimet që mund të nxjerren nga jeta e Musait mund të përmbledhen si në vijim:

1 – Fati dhe qëllimet e tij hyjnore

Me lindjen e Musait, pejgamberia e tij dhe lufta që ai do të ndiqte në udhën e Zotit ishin të gjitha të paracaktuara. Në të vërtetë, gjithë kjo ishte paracaktuar madje edhe para lindjes së tij. Kur e shiqojmë vetveten, do të duhej gjithashtu të kuptojmë se ne jetojmë jetët tona përbrenda një fati të caktuar. Ky fat është gjëja më e mirë për ne. Është paracaktuar nga Zoti, i cili është Krijuesi jonë dhe Zoti jonë. Ai posedon dijeni dhe mëshirë të pafund. Kjo është arsyeja pse ne do të duhej t'ia nënshtrojmë vetveten fatit tonë dhe të përqafojmë çfarëdo që na ndodhë me gëzim, duke qenë të vetëdijshëm se është pjesë e fatit që Zoti ynë ka krijuar për ne.

2 – Animi nga të drejtët

Në pjesët e para të këtij libri ne përmendëm një tregim në të cilin Musai mori anën e një njeriu të kombit të tij dhe joqëllimisht e mbyti një person tjetër. Këtë e përmendëm për të theksuar gabimin e animit pa kushte nga bashkëkombasit tonë (familja, fisi, kombi, etj.). Ajo që e bën një njeri superior nuk është familja e tij, fisi apo kombi, por shkalla e drejtësisë që ai arrinë. Prandaj, do të duhej që gjithmonë të rregullojmë sjelljen tonë sipas drejtësisë, një vlerë që duhet ta mbajmë mbi gjithçka tjetër.

3 – Besimi në Zotin dhe mbështetja e besimit në Të

Tregimi për Musain thekson në masë të madhe pikëpamjen e mbështetjes së besimit në Zotin. Zoti paralajmëroi dhe mësoi Musain për nevojën që të mbështeste besimin e tij në Të, përkundër faktit se për nga natyra e tij ai shqetësohe (bëhej nevrrik) kohë pas kohe. Në ato situata me të cilat u ballafaqua përgjatë jetës së tij, Musai gjithmonë ishte i vetëdijshëm se Zoti është Ai që ushtron kontroll absolut mbi gjithçka dhe se Atij duhet besuar pa kushte. Për më tepër, ai do të kërkonte falje për gabimet që bënte dhe bënte çmos që t'i ndreqte ato.

Për të mbështetur besimin në Zotin, njeriu duhet të njoh Zotin dhe të çmoj Atë sipas fuqisë së Tij të vërtetë. Një besimtar udhëzohet në një dijeni të tillë duke përsiatur për cilësitë e Zotit: Zoti është Krijuesi i gjithë jetës, Ai është Ai që merr prapa shpirtin e njeriut, Ai ka fuqi absolute mbi gjithçka, Ai përfshinë gjithçka, Ai vetëm urdhëron “Bëhu” dhe ajo bëhet, Ai është kontrolluesi absolut dhe i vetëm i çdo gjëje, Ai është Mëshirëploti, Ai është Ai që iu përgjigjet të gjitha lutjeve dhe Ai udhëzon kë dëshiron në udhën e drejtë. Të gjitha veprat/punët e bëra kthehen tek Zoti. Po të kishim mundësi të kuptojmë plotësisht fuqinë e Krijuesit tonë dhe të çmonim fuqinë e Tij, atëherë do të mund të kuptonim se Ai është i Vetmi të cilit duhet t'i drejtohemi dhe të mbështesim besimin tonë.

4 – Natyra e përkohshme e jetës së kësaj bote dhe gjërave që posedojmë

Siç kemi mësuar nga shembulli i Karunit, vdekja i zhvlerëson të gjitha dobitë e pasurisë së kësaj bote. Për më tepër, nëse nuk shpenzohen në udhën e Zotit, këto lehtë mund të jenë shkaktarë për të rënduar vuajtjet, si në këtë botë ashtu edhe në jetën e përtejme. Pasuria materiale kurrë nuk do të duhej të jenë objekt i lakmisë së njeriut. Zoti i dhuron një begati më të madhe të të mirave të Tij kujt don Ai. Përparimi është i pavlerë nëse nuk përdoret për hir të Zotit. Në anën tjetër, për

dikend që i bindet vullnetit të Zotit, skamja në asnjë mënyrë nuk është burim i mjerimit. Prandaj, njeriu s’duhet as të pendohet e as të mburret me gjërat që posedon dhe pasurinë në këtë botë. Vetëm të jetuarit për hir të Zotit dhe frika nga Zoti duhet të jenë kriter mbi të cilin do të duhej të mbështetej jeta e njeriut.

5 – Padituria dhe pastrimi i vetvetes

Siç rrëfëhet në tërë librin, të bijtë e Izraelit përqaftuan fenë që Musai solli duke mos braktisur tërësisht mënyrën e vjetër të jetesës. Për më tepër, ata bënë përpjekje të shkrijnë mënyrën e jetesës së gabuar të tyre me fenë e zbuluar. Ky është një moment i rëndësishëm për të cilin të gjithë do të duhej të ishin të kujdesshëm. Mund të ndodhë që gjatë zhvillimit të personalitetit të tij, një individ mund të ketë rrënjosur në mendjen e tij një mënyrë të gabuar të të menduarit. Kështu, pas përqaftimit të udhës së drejtë, mund ende të mbajë diç nga këto besime dhe mendime të vjetra.

Në tregimin për Musain gjithashtu mund të kuptohet se praktikat idhujtare të fisit të cilin takuan gjatë udhëtimit të tyre u bënë shkas i joshjes për pjesëtarët e popullit të Musait më besim të dobët dhe që kishin dështuar në pastrimin e vetvetes nga padituria. Kjo tregon se zbatimi i rregullave Kur’anore është rruga e vetme e eliminimit të besimeve dhe mendimeve që janë rrënjosura në padituri.

6 – Hipokritët dhe sjellja e tyre

Në tregimin e Musait, gjejmë shembuj të hipokritëve që fshihen përbrenda një bashkësie dhe të dëmit të madh që ata mund t'i sjellin një shoqërie. Për shembull, mund t'i dallojmë tiparet që janë të veçanta për hipokritët në Es-Samirijin (Samaritanin).

Hipokritët gjenden në mesin e besimtarëve. Në kohën e Musait për shembull, Es-Samiriji (Samaritani) ishte njëri prej të bijëve të Izraelit. Për të shkaktuar probleme, hipokritët kërkojnë momentin kur besimi i besimtarëve është në shkallën më të ulët. Vetëm atëherë kur ndjejnë se mund të kenë më së shumti sukses ata veprojnë. Ata fusin në përdorim të metat e njerëzve për t'i larguar nga udha e drejtë. Në kërkim të realizimit të qëllimit të tyre, ata joshin epshet e natyrës njerëzore. Ata ofrojnë premtime boshe. Ata kurrë nuk e shprehin haptazi mosbesimin në fe apo në Zot, por në vend të kësaj, përpiqen që të tërheqin vëmendjen drejt përkushtimit të tyre të paqenë. Ata shkojnë aq larg sa të pohojnë se kuptojnë fenë më mirë se çdokush tjetër dhe se për këtë arsye janë më të aftët që të udhëzojnë të tjerët në udhën e drejtë. Edhe një tipar tjetër i rëndësishëm i hipokritëve për të cilin duhet të jemi të vetëdijshëm është shkalla e ndikimit të tyre në njerëz. Një hipokrit i vetëm mund të ndikoj negativisht një komb të tërë. Es-Samiriji (Samaritani) ishte prej të tillëve.

7 – Të bijtë e Izraelit dhe sjellja e tyre e zakonshme

Një vlerësim i vargjeve që kanë të bëjnë me Profetin Musa zbulojnë faktin se ai madje u ballafaqua me një luftë kundër vet popullit të tij. Arroganca, prirja nga idhujtaria dhe pabindshmëria (mosnënshtrimi) ishin karakteristikat e tyre themelore. Kjo ishte arsyeja që ky komb, duke mos merituar përfundimisht profetët, frymëzimet hyjnore dhe të gjitha të mirat tjera

që iu dhuruan nga Zoti, u zhvesh nga një nder i tillë. Ky është prap një mësim i rëndësishëm për besimtarët.

8 – Tregimi për lopën dhe preokupimi i tepruar me hollësira

Ky tregim zbulon një mentalitet specifik që pllakos të bijtë e Izraelit, prirjen njerëzore që të merret jashtë mase me hollësira...Përkundër natyrës së lehtë, të pandërlikuar dhe të pastër të fesë, disa njerëz përpiqen ta bëjnë fenë të vështirë, duke futur hollësira të panevojshme në të, dhe duke zhvendosur përqëndrimin nga thelbi i saj i vërtetë në çështje të parëndësishme. Megjithatë, Zoti shpjegon se feja e vërtetë është poaq e thjeshtë sa feja e Ibrahimit. Tregimi për lopën sjell në dritë gabimin e hyrjes së panevojshme në hollësira. Gjithashtu tregon se kërkimi i hollësirave të parëndësishme vetëm shkakton vështirësi për njerëzit dhe përfundimisht mund t'i largoi ata nga urdhërat e Zotit.

9 – Tregimi për njeriun e ditur dhe urtësinë nga Zoti

Ky tregim na rrëfen se mund të ndodhë që urtësia të fshihet pas ngjarjeve të caktuara dhe t'mos jetë e dukshme menjëherë. Kjo dituri është një lloj i posaçëm i urtësisë i dhuruar nga Zoti. Kjo shpjegohet me shembuj që edhe pse duken të jenë ngjarje shkatërrimtare mund në të vërtetë t'mos jenë aq fatkeqe dhe se përkundrazi mund të ketë ndonjë arsye pas tyre që ne jemi të paaftë ta kuptojmë.

Për të përfunduar, mësimi më i rëndësishëm për besimtarët ishin parimet morale që shërbyen si shembull të Musait dhe Harunit. Të dy ata ishin profetë të Islamit, të cilëve iu dhanë shkrimet e shenjta.

Edhepse Musai luftoi në udhën e Zotit mijëra vjet më parë, sjellja e tij dhe mënyra e të folurit mbesin shembull për ne. Zoti e zgjodhi atë për Vete, foli me të dhe e emëroi si të dërguar për të përcjellur porosinë e Tij te njerëzit. Zoti flet për këta njerëz bujar në Kur'an si në vazhdim:

Dhe Ne lamë për ata (të dy përkujtim përgëzues) ndër brezat e mëpastajmë. “Selam (Paqja jonë qoftë) mbi Musain dhe Harunin!” Sigurisht që kësajsoj i shpërblejmë Ne mirëpunuesit në Rugën e Allahut. Vërtetë që ata të dy ishin nga robërit Tonë besimtarë. (Kur'an, 37:119_122)

Zoti ishte i kënaqur me ta, siç është Ai me të gjithë të dërguarit e Tij. Na bekoftë Zoti jonë me urtësi për të kuptuar më mirë jetërat e këtyre të dërguarve dhe për të qenë prej atyre me të cilët Ai është i kënaqur.

KEKQIPTIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, që përpiket të mohoj faktin e krijimit të gjithësisë, nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim joshkencor. Kjo teori sipas së cilës jeta rrjedh nga materia e pajetë përmes rastësive, është shkatërruar në tërësi me dijen se gjithësia u krijua nga Zoti. Është Zoti Ai që krijoi gjithësinë dhe që e përpunoi atë deri në detalin më të vogël. Prandaj, është e pamundshme që teoria e evolucionit, sipas së cilës qeniet e gjalla nuk janë të krijuara nga Zoti, por janë fryt i rastësive, të jetë e vërtetë.

Nuk është çudi që kur i hedhim një sy teorisë së evolucionit, shohim se kjo teori është zhvlerësuar nga zbulimet shkencore. Krijimi i jetës është jashtëzakonisht kompleks dhe i mahnitshëm. Në botën e pajetë, për shembull, mund të shohim se sa të ndieshme janë barazpeshat në të cilat mbështeten atomet dhe më tej, në botën e gjallë, mund të shohim se në çfarë krijime komplekse janë bashkuar këto atome dhe sa të jashtëzakonshëm janë mekanizmat dhe strukturat e tilla si proteinat, enzimet dhe qelizat që janë përpunuar me to.

Ky krijim i jashtëzakonshëm i jetës e zhvlerësoi Darwinizmin në fund të shekullit të 20të.

Ne jemi marrë me këtë temë në masë të madhe në disa prej studimeve tona tjera dhe do të vazhdojmë të merremi me të. Megjithatë, mendojmë se duke marrë parasysh rëndësinë e saj, do të na ndihmonte po të bënim një përmbledhje të shkurtër edhe këtu.

RËNIA (RRËNIMI) SHKENCORE E DARVINIZMIT

Edhe pse një doktrinë që daton që nga Greqia antike, teoria e evolucionit u avancua në masë të madhe në shekullin e 19të. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri këtë teori temën numër një në botën e shkencës ishte libri i Çarlls Darvinit i titulluar Prejardhja e Gjallesave i publikuar më 1859. Në këtë libër, Darvini mohoi se gjallesat e ndryshme në tokë ishin krijuar ndarazi nga Zoti. Sipas Darvinit, të gjitha qeniet e gjalla kishin një paraardhës të përbashkët dhe ato u shndërruan në qenie të ndryshme me kohë përmes ndryshimeve të vogla.

Teoria e Darvinit nuk bazohej në asnjë zbulim konkret shkencor, sikurse ai vet gjithashtu pranoi, ishte vetëm një “supozim.” Për më tepër, sikurse Darvini pranoi në kapitullin e gjatë të librit të tij të quajtur “Vështirësitë e Teorisë,” teoria dështonte para shumë pyetjeve kritike.

Darvini investoi të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, që ai shpresonte të zgjidhnin “Vështirësitë e Teorisë.” Megjithatë, përkundër asaj që shpresonte ai, zbulimet shkencore zgjeruan dimensionet e këtyre vështirësive.

Disfata që Darwinizmi pësoi nga shkenca mund të pasqyrohet në tri çështje themelore:

1. Teoria në asnjë mënyrë nuk mund të shpjegojë mënyrën se si u shfaq jeta në tokë.
2. Nuk ekziston ndonjë zbulim shkencor që do të tregonte se “mekanizmat evolutiv” të propozuar nga kjo teori kanë ndonjë fuqi çfarëdo qoftë për të evoluar.
3. Dëshmitë për fosile dëshmojnë në tërësi të kundërtën e propozimeve të teorisë së evolucionit.

Në këtë pjesë, do të ekzaminojmë këto tri çështje themelore në mënyrë të përgjithësuar:

HAPI I PARË I PAKAPËRCYESHËM: ZANAFILLA E JETËS

Sipas teorisë së evolucionit të gjitha gjallesat evoluojnë nga një qelizë e vetme e gjallë që u shfaq në tokën primitive 3.8 bilion vjet më parë. Si mund të ketë krijuar një qelizë e vetme me miliona

gjallesa komplekse dhe poqese një evolucion i tillë me të vërtetë kishte ndodhur, pse nuk mund të vëzhgohen gjurmët e tij në dëshmitë e fosileve, janë disa prej pyetjeve në të cilat teoria nuk mund të jap përgjigje. Mirëpo, së pari dhe mbi të gjitha, hapi i parë i procesit të supozuar evolutiv që duhet të hetohet është si u shfaq (krijua) kjo “qelizë e parë”?

Pasiqë teoria e evolucionit mohon krijimin dhe nuk pranon çfarë lloji të ndërhyrjes së mbinatyrshme, pohon se “qeliza e parë” u shfaq (krijua) rastësisht përbrenda ligjeve të natyrës, pa ndonjë qëllim, plan apo mbarështim (përgatitje). Sipas teorisë, materia e pjetë duhet të kishte prodhuar një qelizë të gjallë si rezultat i rastësive. Kjo, megjithatë, është një pohim i paqëndrueshëm madje edhe për rregullat më të pamposhtura të biologjisë.

“JETA RRJEDH (BURON) NGA JETA”

Në këtë libër, Darvini kurrë nuk iu referua zanafillës së jetës. Të kuptuarit primitiv të shkencës në kohën e tij mbështetej në pandehjen se qeniet e gjalla kishin një strukturë shumë të thjeshtë. Prej mesjetës, krijimi spontan, teoria që pohonte se materiet e pjetë u bashkuan për të formuar organizma të gjallë, ishte gjerësisht e pranuar. Përgjithësisht besohej se insektet erdhën në jetë nga mbeturinat e ushqimit dhe minjët erdhën në jetë nga gruri. Eksperimente interesante u ndërmorën për të vërtetuar këtë teori. Ca kokra gruri ishin vendosur në një copë të ndytë pëlhure dhe besohej se minjët do të zënin fill nga ajo pas një kohe.

Ngjashëm, zhvillimi i krimbave në mish supozohej të ishte dëshmi e krijimit spontan. Mirëpo, vetëm pak kohë më vonë u kuptua se krimbat nuk paraqiteshin në mish në mënyrë spontane, por barteshin atje nga mizat në formën e larvave, të padukshme për syrin e njeriut.

Madje edhe në periudhën kur Darvini shkruajti “Zanafillën e Gjallesave”, besimi se bakteriet mund të vinin në jetë nga materia e pajetë ishte gjerërisht e pranuar në botën e shkencës.

Mirëpo, pas vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli rezultatet e tij pas një studimi të dhe eksperimentimi të gjatë, që hedhnin poshtë krijimin spontan, një gur themeli të teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale të mbajtur në Sorbonë më 1864, Pasteri tha: “Kurrë nuk do të këndellet doktrina për krijimin spontan nga kjo goditje vdekjeprurëse që iu dha nga ky eksperiment i thjeshtë.”⁶

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit iu bënë ballë zbulimeve të Pasterit për një kohë të gjatë. Megjithatë, me zgjidhjen e strukturës komplekse të qelizës së një qenieje të gjallë me zhvillimin e shkencës, idea se jeta do të mund të kishte lindur rastësisht u ballafaqua madje me një gjendje edhe më të pashpresë.

PËR PJEKJET JOBINDËSE TË SHEKULLIT TË 20TË

Evolucionisti i parë që vazhdoi çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e 20të ishte biologu i njohur Rus Aleksandër Oparin. Me tezat e ndryshme që ai lëvizi përpara në vitet e 1930ta, ai u

përpoq të dëshmojë se qeliza e një qenieje të gjallë do të kishte mundur të krijohej nga rastësia. Këto studime, megjithatë, ishin të dënuara të dështojnë dhe Oparinit iu desht të bënte këtë pohim: “Fatkeqësisht, megjithatë, problemi i zanafillës së qelizës është ndoshta pika më e paqartë në tërë studimin e evolucionit të organizmave.” 7

Pasuesit evolucionistë të Oparinit u përpoqën që të bëjnë eksperimente për të zgjidhur problemin e burimit të jetës. Eksperimenti më i njohur prej tyre u ndërmor nga kimisti Amerikan Stenli Miller më 1953. Duke kombinuar gazërat që ai pretendonte të kishin ekzistuar në atmosferën fillestare të tokës në një ambient eksperimentues dhe duke i shtuar kësaj përzierje energji, Milleri sintetizoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteineve.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohet se ky eksperiment, i cili ishte paraqitur atëherë si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit ishte i pavlefshëm, pasi që atmosfera e përdorur në këtë eksperiment ishte shumë e ndryshme nga kushtet e vërteta që ekzistonin në tokë. 8

Pas një heshtjeje të gjatë, Milleri pranoi se ambienti i atmosferës që përdori nuk ishte real.9

Të gjitha përpjekjet evolucioniste të parashtruara gjatë shekullit XX për të shpjeguar zanafillën e jetës dështuan. Gjeokimisti Xhefri Bada nga Instituti Scripps i San Diegos pranon këtë fakt në një artikull të botuar në “Earth Magazine” më 1998:

Sot në mbarim të shekullit XX ne ende përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim në fillim të shekullit XX. Si u krijua (shfaq) jeta në Tokë?10

PËRBËRJA KOMPLEKSE E JETËS

Arsyeja parësore pse teoria e evolucionit përfundoj në një gjendje të këthillë të parrugëdalje në lidhje me zanafillën e jetës është se madje edhe organizmat e gjallë që konsideroheshin më të thjeshtët kanë përbërje jashtëzakonisht komplekse. Qeliza e një qenieje të gjallë është më komplekse se të gjitha produktet teknologjike të prodhuara nga njeriu. Sot, madje edhe në laboratoriumet më të zhvilluara të botës, një qelizë e gjallë nuk mund të krijohet duke bashkuar materiet inorganike.

Kushtet e kërkuara për formimin e një qelize janë të panumërta në masë për t'u shpjeguar me anë të rastësive. Mundësia që proteinet, pjesë ndërtuese të qelizës, të jenë formuar rastësisht, është 1 në 10950 për një proteinë mesatare të përbërë prej 500 aminoacideve. Në matematikë, një mundësi më e vogël se 1 në 1050 konsiderohet të jetë praktikisht e pamundshme.

Molekula e ADN-së që gjendet në bërthamën e qelizës dhe që ruan informacionin gjenetik, është një bazë e jashtëzakonshme e të dhënave. Është llogaritur se poqese informacioni i koduar në ADN do të shkruhej, kjo do të formonte një librari gjigante që do të përbëhej nga 900 volume enciklopedike prej 500 faqesh secila.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund të përsëritet vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimeve). Megjithatë, sinteza e këtyre enzimeve mund të realizohet me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasiqë ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për t'u përsëritur. Ky fakt sjellë skenarin që jeta të ketë zënë fill vetvetiu në një situatë pa rrugëdalje. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me

nam nga Universiteti i San Diegos të Kalifornisë, pranon këtë fakt në numrin e Shtatorit të vitit 1994 të “Scientific American Magazine” (Revistës Shkencore Amerikane):

Është jashtëzakonisht e pamundshme që proteinet dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga struktura (përbërja), të kenë zënë fill vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Prapsepap gjithashtu duket të jetë e pamundshme të kesh njëri pa tjetrin. Dhe kështu, në shikim të parë, do të duhej të vihej te përfundimi se jeta kurrë, në të vërtetë, s’do të mund të kishte zënë fill me anë të proceseve kimike.¹¹

Padyshim, nëse është e pamundshme që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta “u krijua” në një mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt në mënyrë të qartë e zhvlerëson teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohojë krijimin.

MEKANIZMAT IMAGJINARË TË EVOLUCIONIT

Pika e dytë e rëndësishme që mohon teorinë e Darvinit është se të dy pikëpamjet (konceptet) e parashtruara nga kjo teori si “mekanizma evolutiv” janë kuptuar t’mos kenë në realitet ndonjë fuqi evolutive.

Darvini mbështeti supozimin e evolucionit tërësisht në mekanizmin e “përzgjedhjes natyrore.” Rëndësia që ai i dha këtij mekanizmi ishte evidente në emrin e librit të tij: Zanafilla e Gjallesave, me anë të Përzgjedhjes Natyrore...

Sipas përzgjedhjes natyrore ato gjallesa që janë më të forta dhe më të përshtatshme ndaj kushteve natyrore të mjedisit ku jetojnë do të mbijetojnë në luftën për jetë. Për shembull, në një kope të drerëve nën kërcënim të sulmit nga bishat e egra, ata që vrapojnë më shpejtë do të mbijetojnë. Prandaj, kopeja e drerëve do të përbëhet nga individë më të shpejtë dhe më të fuqishëm. Mirëpo, në mënyrë të padiskutueshme, ky mekanizëm nuk do të shkaktojë evoluimin e drerëve dhe shndërrimin e tyre në një lloj tjetër gjallesë, për shembull, në kuaj.

Prandaj, mekanizmi i përzgjedhjes natyrore nuk ka fuqi evolutive. Darvini ishte gjithashtu i vetëdijshëm për këtë fakt dhe iu desht të pohonte këtë në librin e tij Zanafilla e Gjallesave:

Përzgjedhja natyrore nuk mund të bëjë asgjë gjersa të ndodhin dallime apo ndryshime më të favorshme individuale.¹²

NDIKIMI I LAMARKUT

Prandaj, si do të mund të ndodhnin këto “ndryshime të favorshme”? Darvini u përpoq të japte përgjigje në këtë pyetje nga këndvështrimi i të kuptuarit primitiv të shkencës në kohën e tij. Sipas biologut Francez Lamark, i cili jetoi para Darvinit, gjallesat bartën tiparet që fituan gjatë jetës së tyre tek gjenerata e ardhshme dhe këto veti, duke u akumuluar nga një gjeneratë në tjetrën, shkaktuan formimin e gjallesave të reja. Për shembull, sipas Lamarkut, gjirafat evoluon nga antilopat, duke u përpjekur të hanë gjethet e drunjëve të lartë, qafat e tyre u zgjatën nga një gjeneratë në tjetrën.

Darvini dha gjithashtu shembuj të ngjashëm dhe në librin e tij “Zanafilla e Gjallesave”, për shembull, tha se disa arinjë duke shkuar në ujë për të gjetur ushqim u shndërruan në balena me kalimin e kohës.¹³

Mirëpo, ligjet e trashëgimisë të zbuluara nga Mendeli dhe të vërtetuara nga shkencë e gjenetikës që lulëzoi në shekullin e XX, krejtësisht rrënuan legjendën sipas së cilës vetitë u bartën tek gjeneratat pasuese. Pra, përzgjedhja natyrore u zhvlerësua si një mekanizëm evolutiv.

NEO-DARVINIZMI DHE MUTACIONET

Për të gjetur një zgjidhje, Darwinistët përparuan “Teorinë Moderne Sintetike”, ose si njihet përgjithësisht, Neo-Darvinizmin, kah fundi i viteve të 1930-ta. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë çrregullime të krijuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të jashtëm si rrezatimi ose gabimet gjatë shumëzimit (përsëritjes), si “shkaktarë të ndryshimeve të favorshme” përveç mutacionit natyror.

Sot, modeli që përfaqëson evolucionin në botë është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie, miliona gjallesa të pranishme në tokë u formuan si rezultat i një procesi përmes të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave siç janë veshët, sytë, mushkëritë dhe krahët, iu nënshtruan “mutacioneve”, domethënë, çrregullimeve gjenetike. Mirëpo, ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht gërryen themelet e kësaj teorie: Mutacionet nuk shkaktojnë zhvillim të gjallesave, përkundrazi, ato gjithmonë iu shkaktojnë dëm atyre.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja ka një përbërje shumë komplekse dhe efektet e rastësishme mund vetëm t'i shkaktojnë dëm asaj. Studiuesi Amerikan i gjenetikës B.G. Ranganathan e shpjegon këtë në këtë mënyrë:

Mutacionet janë të vogla, të rastësishme dhe të dëmshme. Ato rrallë ndodhin dhe mundësia më e mirë është që ato do të jenë të padobishme. Këto katër karakteristika të mutacioneve nënkuptojnë se mutacionet nuk mund të shpien drejt një zhvillimi evolutiv. Një ndryshim i rastësishëm në një organizëm tejet kompleks është ose i padobishëm ose i dëmshëm. Një ndryshim i rastit në një orë nuk mund të ndikojë për të mirë. Me siguri se ose do ta dëmtoj atë ose në rastin më të mirë do të jetë i padobishëm. Një tërmet nuk mund të ndikoj për të mirë në një qytet, por sjell shkatërrim.¹⁴

Nuk çudit aspak fakti se deri më sot nuk është vënë re asnjë shembull i mutacionit që do të dëshmohej si i dobishëm apo që të ketë ndikuar në zhvillimin e kodit gjenetik. Të gjitha mutacionet janë dëshmuar të jenë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni që është paraqitur si një “mekanizëm evolutiv,” është në të vërtetë një ndodhi gjenetike që dëmton gjallesat dhe i paaftëson ato (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri). Padyshim, një “mekanizëm shkatërrimtar” nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv”. Përzgjedhja natyrore, në anën tjetër, “nuk mund të bëj asgjë vetvetiu” sikur pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ka “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasiqë nuk ekzistojnë mekanizmat evolutiv, atëherë as edhe ndonjë proces i trilluar (imagjinar) i quajtur evolucion nuk mund të ketë ndodhur.

DËSHMITË PËR FOSILE: S'KA SHENJA TË FORMAVE TË NDËRMJETME

Dëshmia më e qartë se skenari i propozuar nga teoria e evolucionit nuk ka ndodhur janë dëshmitë për fosilet.

Sipas teorisë së evolucionit, çdo gjallesë ka ardhë në jetë prej një paraardhësi. Një lloj gjallese që ekzistonte më parë u shndërrua në diçka tjetër me kohë dhe të gjitha gjallesat erdhën në jetë në këtë mënyrë. Sipas kesaj teorie, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë miliona vjetëve.

Po të kishte qenë kështu, atëherë gjallesa të shumta të ndërmjetme do të kishin ekzistuar dhe jetuar gjatë kësaj periudhe të gjatë të transformimit.

Për shembull, ca gjysmë-peshk/gjysmë-zvarranik duhet të kenë jetuar në të kaluarën që kishin fituar veti të zvarranikëve përveç vetive të peshqëve që tashmë kishin. Ose do të duhej të kenë ekzistuar ca zvarranik-shpendë që kishin fituar veti të zogjëve përveç vetive të zvarranikëve që ata tashmë kishin. Pasiqë kjo do të duhej të ndodhte në një fazë kalimtare, këto gjallesa do të duhej të ishin të paafta dhe me të meta, gjallesa të gjymtuara (të sakatosura). Evolucionistët iu referohen këtyre krijesave të trilluara që ata besojnë të kenë jetuar në të kaluarën si “forma të ndërmjetme.”

Po të kishin ekzistuar me të vërtetë shtazë të tilla, do të duhej të ishin me miliona e madje edhe me biliona sosh në numër dhe llojllojshmëri. Ajo që është më e rëndësishme, eshtrat e këtyre krijesave të çuditshme do të duhej të gjendeshin në dëshmitë për fosile. Në *“Zanafillën e Gjallesave”*, Darvini shpjegoi:

Po të jetë teoria ime e vërtetë, një llojlojshmëri e panumërt e gjallesave të ndërmjetme, që do të lidhte ngusht në mes vedi të gjitha gjallesat e grupit të njëjtë me siguri duhet të kenë ekzistuar... Rrjedhimisht, dëshmi të ekzistencës së tyre do të mund të gjendeshin vetëm në mesin e mbeturinave të fosileve.¹⁵

SHPRESAT E DARVINIT U SHPARTALLUAN

Megjithatë, edhe pse evolucionistët bënë përpjekje të mëdha për të gjetur fosile që nga mesi i shekullit të 19të në gjithë botën, ende nuk u zbulua ndonjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet e nxjerra nga toka gjatë gjurmimeve treguan se përkundër asaj që shpresuan evolucionistët, jeta në tokë u paraqit përnjëherë dhe e formuar plotësisht.

Një paleontolog i njohur Britanik, Derek V. Ager, pranon këtë fakt, edhe pse ai është një evolucionist:

Lind çështja se nëse hulumtojmë në hollësi dëshmitë e fosileve, qoftë në nivelin e rradhitjes apo të gjallesave, ne gjejmë – gjithnjë – jo një evolucion të shkallëzuar, por një eksplodim të vrullshëm të një grupi në llogari të një grupi tjetër.¹⁶

Kjo do të thotë se në dëshmitë e fosileve, të gjitha gjallesat shfaqen përnjëherë në tërësi të formuara, pa ndonjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është mu e kundërta e pandehjeve të Darvinit. Gjithashtu, dëshmia se gjallesat janë krijuar është shumë e fuqishme. I vetmi shpjegim

që një gjallesë shfaqet përnjëherë dhe e formuar plotësisht deri në detajet më të imta pa ndonjë paraardhës evolutiv mund të jetë se kjo gjallesë u krijua. Kjo e dhënë pranohet gjithashtu edhe nga biologu evolucionist i njohur në gjithë botën Douglas Futuyma:

Krijimi dhe evolucioni, mes tyre, shterin shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat e gjallë ose u shfaqën në tokë plotësisht të formuara ose nuk u shfaqën fare. Nëse nuk u shfaqën, ato duhet të ishin zhvilluar nga gjallesat që duhet të kenë ekzistuar më parë përmes ndonjë procesi të modifikimit (ndryshimit). Poqese u shfaqën në gjendje të formuar plotësisht, ato me të vërtetë duhet të ishin krijuar nga ndonjë inteligjencë e plotfuqishme. 17

Fosilet tregojnë se gjallesat u shfaqën plotësisht të zhvilluara dhe në një gjendje të përsosur në tokë. Kjo nënkupton se “zanafilla e gjallesave” është, përkundër pandehjes së Darvinit, jo evolucion por krijim.

PËRRALLA E EVOLUCIONIT NJERËZOR

Tema më së tepërmi e rrahur nga avokatët e teorisë së evolucionit është tema e zanafillës së njeriut. Pohimi darvinist mbronë tezën se njerëzit modern të kohës sonë evoluoi nga ca krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë këtij procesi të supozuar evolutiv, i cili supozohet të ketë filluar 4-5 milionë vite më parë, pohohet të kenë ekzistuar ca “forma kalimtare” në mes të njeriut modern dhe paraardhësve të tij. Sipas këtij skenari plotësisht të trilluar, numërohen katër kategori themelore:

1. Australopitekusi
2. Homo habilisi
3. Homo erektusi
4. Homo sapiensi

Evolucionistët i quajnë të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunë “Australopitekusi” që domethënë “majmuni Jug-Afrikan.” Këto gjallesa në të vërtetë nuk janë asgjë tjetër veçse një lloj i vjetër i majmunëve që është zhdukur. Hulumtimet gjithëpërfshirëse të bëra në mostrat e ndryshme të Australopitekusit nga dy anatomistë të njohur në tërë botën nga Anglia dhe SHBA, gjegjësisht, Lordi Solly Zuckerman dhe Prof. Charles Oxnard, kanë treguar se këto mostra i takonin një lloji të zakonshëm të majmunëve që u zhduk dhe që nuk përmbante asnjë ngjashmëri me njerëzit.¹⁸

Evolucionistët e kategorizojnë shkallën e ardhshme të evolucionit njerëzor si “homo,” që domethënë “njeri.” Sipas pohimit evolucionist, gjallesat në kategorinë e Homo-s janë më të zhvilluar se Australopitekusët. Evolucionistët sajojnë një skemë imagjinare të evolucionit duke rradhitur fosilet e ndryshme të këtyre krijesave në një rradhitje të posaçme. Kjo skemë është e trilluar sepse kurrë nuk është dëshmuar se ekziston ndonjë raport evolutiv në mes të këtyre kategorive të ndryshme. Ernst Mayr, njëri prej ithtarëve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit të shekullit të 20të, diskuton në librin e tij “Një Argument i Gjatë” se “në veçanti (enigmat) historike siç janë zanafilla e jetës ose e Homo sapiensit, janë jashtëzakonisht të vështira dhe madje mund t’i rezistojnë një shpjegimi të kënaqshëm përfundimtar.”¹⁹

Duke nënvizuar lidhjen zinxhirore si “Australopitekus – Homo habilis – Homo erektus – Homo sapiens,” evolucionistët lënë për të kuptuar se secila prej këtyre llojeve është paraardhëse e tjetrës. Megjithatë, zbulimet e mëvonshme të paleoantropologëve kanë zbuluar se Australopitekusi, Homo habilisi dhe Homo erektusi kanë jetuar në pjesë të ndryshme të botës në të njëjtën kohë.²⁰

Për më tepër, një pjesë e caktuar e njerëzve e rradhitur në kategorinë e Homo erektusit kanë jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens neandertalensis dhe Homo sapiens sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin region.²¹

Kjo rrethanë qartësisht tregon pavlefshmërinë e pohimit se ata janë paraardhës të njëri tjetrit. Një paleontolog nga Universiteti i Harvardit, Stephen Jay Gould, shpjegon këtë situatë të pashpresë të teorisë së evolucionit edhe pse ai vet është evolucionist:

Çfarë ka ndodhur me shkallën tonë nëse ekzistojnë tri raca hominide (njerëzore) bashkëjetuese (A. afrikanus, Australopitekus robust dhe H. habilis), qartësisht asnjëra me prejardhje nga tjetra? Për më tepër, asnjëra prej tyre nuk shfaqin ndonjë prirje evolutive gjatë ekzistimit të tyre në tokë.²²

Thënë shkurt, skenari i evolucionit njerëzor, të cilin mundohen ta mbështesin me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të disa krijesave “gjysëm majmunë, gjysëm njerëz” që janë shfaqur në media dhe në libra kurseesh, domethënë, sinqerisht, përmes propagandës, nuk është asgjë tjetër veçse një përrallë pa baza shkencore.

Lordi Solly Zukerman, njëri nga shkencëtarët më të njohur dhe më të respektuar në Britaninë e Madhe, i cili bëri hulumtime në këtë çështje për vite të tëra dhe studioi në veçanti fosilet e

Australopitekusit për 15 vite, përfundimisht konkludoi, përkundër faktit se edhe vet ishte evolucionist, se në të vërtetë nuk ekziston një trung familjar që zgjerohet nga krijesat e ngjashme me majmunë tek njeriu.

Zukermani gjithashtu bëri një “spektër interesant shkencor”. Ai formoi një spektër të shkencave duke filluar prej atyre që ai konsideronte si shkencore deri te ato që konsideronte si joshkencore. Sipas spektrit të Zukermanit, si shkencat më shkencore, domethënë, që mvaren nga të dhënat konkrete shkencore janë kimia dhe fizika. Pas tyre vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fundin e skajshëm të spektrit, e cila është pjesa e konsideruar si më “joshkencorja,” janë “perceptimi jashtë-shqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë dhe në fund “evolucioni njerëzor.” Zukermani shpjegon këtë gjykim të tij:

Ne pastaj largohemi nga regjistri i të vërtetës objektive në ato fusha të shkencës së supozuar biologjike si perceptimi jashtë-shqisor ose interpretimi i historisë së fosileve njerëzore, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundshme – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit) është nganjëherë në gjendje të besojë disa gjëra kundërthënëse në të njëjtën kohë. 23

Prej përrallës së evolucionit njerëzor s’mbetet asgjë tjetër veçse interpretime të paragjykuara të fosileve të nxjerrura nga toka nga disa njerëz që verbërisht besojnë në teorinë e tyre.

TEKNOLOGJIA E SYRIT DHE VESHIT

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyeshme e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë në çështjen e syrit, le të përgjigjemi shkurtimisht në pyetjen se “si shohim ne.” Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt kthehen mbrapsht në retinën e syrit. Këtu, këto rreze drite shndërrohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe arrijnë në një pjesë të vogël në pjesën e prapme të trurit të quajtur qendra e shikimit. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si një përfytyrim pas një vargu procesesh. Me këtë prapavi teknike, le të mendojmë pak për këtë.

Truri është i izoluar nga drita. Kjo domethënë se brendia e trurit është plotësisht e errët dhe drita nuk arrin deri tek vendi ku është i vendosur truri. Vendi i quajtur qendra e shikimit është një vend plotësisht i errët ku drita kurrë nuk arrinë. Mund të jetë edhe vendi më i errët që mund të keni njohur ndonjëherë. Megjithatë, ju vëzhgoni një botë të ndritshme dhe të shkëlqyer në këtë errësirë të plotë.

Pamja e formuar në sy është aq e mprehtë dhe e qartë sa që as teknologjia e shekullit të 20të s’ka qenë në gjendje ta arrijnë. Për shembull, shiqo në librin që je duke lexuar, duart me të cilat e mbanë, pastaj ngrite kokën dhe shiqo rreth vetes. A ke parë ndonjëherë ndonjë pamje aq të mprehtë dhe të qartë sikur kjo kudo tjetër? As edhe ekrani më i zhvilluar televiziv i prodhuar nga prodhuesi më i madh televiziv në botë nuk mund të ofroj një fotografi më të qartë për ju. Kjo është një pamje tre-dimensionale, me ngjyra dhe jashtëzakonisht e mprehtë. Për më shumë se 100 vite, me mijëra inxhinierë janë munduar të arrijnë këtë mprehtësi. Fabrika, godina të mëdha u

ndërtuan, shumë hulumtime janë bërë, projekte dhe plane janë bërë për këtë qëllim. Prapsepap, hedhja një sy ekranit televiziv dhe librit që mbani në duart tuaja. Do të vëreni se ekziston një dallim shumë i madh sa i përket mprehtësisë dhe qartësisë. Për më tepër, ekranit televiziv ju jap një pamje dy-dimensionale, gjersa me sytë tuaj ju shiqoni në një perspektivë tre-dimensionale që ka thellësi.

Për vite të tëra, me dhjeta mijëra inxhinierë janë përpjekur të bëjnë një TV tre-dimensional dhe të arrijnë cilësinë e pamjes të syrit. Po, ata kanë bërë një sistem televiziv tre-dimensional por është e pamundur ta shiqosh pa vënë syze. Për më tepër, është vetëm një perspektivë tre-dimensionale artificiale. Prapavija është më e mjegulluar, plani i parë na paraqitet sikur një sfond prej letre. Kurrë nuk ka qenë e mundshme që të prodhohet një pamje e mprehtë dhe e qartë sikurse ajo e syrit. Në të dyja, në kamerë dhe televizion, ka një humbje të cilësisë së pamjes.

Evolucionistët pohojnë se mekanizmi që prodhon këtë pamje të mprehtë dhe të qartë është formuar rastësisht. Tani, po t'ju thoshte dikush se televizioni në dhomën tuaj është formuar si rezultat i rastit, se të gjitha atomet që e përbëjnë atë ndodhi që të bashkohen dhe të krijojnë këtë aparat që prodhon pamje, çfarë do të mendonit? Si mund atomet të bëjnë një gjë të tillë që me mijëra njerëz s'mund ta bëjnë?

Nëse një aparat që prodhon një pamje më primitive se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë se syri dhe pamja që shohim përmes syrit nuk mund të jenë formuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm pranon zërat e kapshëm dhe i drejton ato tek veshi i mesëm; veshi i mesëm i bartë lëkundjet e zërit duke i rritur ato; veshi i brendshëm i

dërgon këto lëkundje në tru duke i përkthyer ato në sinjale elektrike. Po sikurse në rastin e syrit, akti i të dëgjuarit finalizohet në qendrën e të dëgjuarit në tru.

Ajo që vlen për syrin vlen edhe për veshin. Domethënë, truri është i izoluar nga zëri po sikur që është i izoluar nga drita: nuk lejon hyrjen e asnjë tingulli brenda. Prandaj, pa marrë parasysh se sa zhurmshëm është jashtë, brendia e trurit është plotësisht e heshtur. Megjithatë, tingujt më të mprehtë perceptohen në tru. Në trurin tuaj, që është i izoluar nga zëri, ju dëgjoni simfonitë e një orkestre dhe e dëgjoni çdo zhurmë në një vend përplot me njerëz. Mirëpo, po të matej niveli i zërit në trurin tuaj me një aparat preciz në atë moment, do të shihej se një heshtje e plotë mbizotëron aty.

Siç është rasti me pamjet, janë bërë përpjekje me dekada për të prodhuar dhe riprodhuar tingull që është besnik ndaj origjinalit. Rezultati i këtyre përpjekjeve janë aparatet për regjistrimin e zërit, sistemet me cilësi të lartë transmetimi dhe sisteme për të kapur tingujt. Përkundër gjithë kësaj teknologjie dhe mijëra inxhinierëve dhe ekspertëve që kanë punuar në këtë, nuk është fituar një zë që do të kishte të njëjtën mprehtësi dhe qartësi sikurse zëri që perceptojmë përmes veshit. Mendoni për sistemet me cilësinë më të lartë të transmetimit të zërit të prodhuara nga kompanitë më të mëdha të industrisë së muzikës. Madje edhe në këto aparate, kur zëri të jetë regjistruar, një pjesë e tij humbet, ose kur e ndizni një sistem të cilësisë së lartë transmetuese (HI-FI) gjithmonë e ndieni një zë fërshëllues para se të fillojë muzika. Mirëpo, zërat që janë produkte të teknologjisë së trupit njerëzor janë jashtëzakonisht të mprehtë dhe të qartë. Veshi i njeriut kurrë nuk percepton një zë të përcjellur me fërshëllimë ose me shkarkime atmosferike siç është rasti me sistemet HI-FI (të cilësisë së lartë transmetuese). Ai e pranon zërin saktësisht ashtu si është, të mprehtë dhe të qartë. Kështu ka qenë që nga krijimi i njeriut.

Deri më sot, asnjë aparat vizuel apo regjistruer i prodhuar nga njeriu nuk ka qenë aq i ndieshëm dhe i suksesshëm në perceptimin e të dhënave shqisore sikurse janë syri dhe veshi.

Mirëpo, sa i përket të shikuarit dhe të dëgjuarit, një fakt shumë më madhështor qëndor mbi gjithë këtë.

KUJT I TAKON NDËRGJEGJA QË SHEH DHE DËGJON PËRBRENDA TRURIT?

Kush është ai që shiqon një botë tërheqëse në trurin e tij, dëgjon simfonitë dhe cicërimat e zogjëve dhe e nuhat trëndafilin?

Stimulimet që vijnë nga sytë, veshët dhe hunda e një qenieje njerëzore udhëtojnë në tru si impulse elektro-kimike nervore. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si krijohet ky imazh (pamje) në tru. Mirëpo, ju kurrë nuk do të ndesheni me faktin më të rëndësishëm në lidhje me këtë çështje: kush është ajo qenie që percepton këto impulse nervore kimike si pamje, zëra, aroma dhe ndodhi ndijore në tru? Ekziston një vetëdije në tru që percepton gjithë këto pa ndër nevojë për sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo vetëdije? Nuk ka dyshim se kjo vetëdije nuk iu takon nervave, shtresës së trashë dhe neuroneve që e përbëjnë trurin. Për këtë arsye Darwinistët-materialist që besojnë së gjithçka përbëhet nga materia nuk mund të japin përgjigje në asnjërën prej këtyre pyetjeve.

Sepse kjo vetëdije është shpirti i krijuar nga Zoti. Shpirti nuk ka nevojë as për syrin për të vështruar pamjet, as për veshin për të dëgjuar zërat. Për më tepër, nuk i nevojitet as truri për të menduar.

Cilido që lexon këtë fakt të qartë dhe shkencor do të duhej të mendonte për Zotin e Gjithëfuqishëm, do të duhej t'i frikësohej Atij dhe të kërkoj strehim tek Ai, Ai i Cili ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej vetëm disa centimetrash kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndriçuar.

NJË BESIM MATERIALIST

Të dhënat që i kemi paraqitur deri më tani na tregojnë se teoria e evolucionit është një pohim që në mënyrë të qartë bie ndesh me zbulimet shkencore. Pohimi i teorisë për prejardhjen e jetës nuk është në përputhje me shkencën, mekanizmat evolucionarë që propozon nuk kanë fuqi evolutive dhe fosilet tregojnë se format e ndërmjetme për të cilat ka nevojë teoria kurrë nuk kanë ekzistuar. Pra, nga kjo rrjedhë se teoria e evolucionit do të duhej lënë anash si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide sikurse idea e gjithësisë me qendër të saj tokën janë larguar nga agjenda e shkencës përgjatë historisë.

Mirëpo, teoria e evolucionit është mbajtur me këmbëngulje në agjendën e shkencës. Disa njerëz madje përpiqen të paraqesin kritikën e drejtuar kundër teorisë si një “atak në shkencë.” Pse?

Arsyeja është se teoria e evolucionit është një besim i kotë i pashpenzueshëm për disa qarqe njerëzish. Këto qarqe janë verbërisht të përkushtuara ndaj filozofisë materialiste dhe e pranojnë Darwinizmin sepse është i vetmi shpjegim materialist që do të mund të parashtrohej për funksionimin e natyrës.

Çka është mjaft interesant, ata pranojnë këtë fakt kohë pas kohe. Një studiues i mirënjohur i gjenetikës dhe një evolucionist i zëshëm, Richard C. Lewontin nga Universiteti i Harvardit, pranon se ai është “së pari dhe parasëgjithash një materialist dhe pastaj një shkencëtar”:

Nuk qëndron puna aty që metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë që të pranojmë një shpjegim materialist të botës së dukurive, por, përkundrazi, që ne jemi të shtrenguar a priori nga besnikëria jonë ndaj çështjeve materiale për të krijuar një mjet të hulumtimit dhe një grumbull konceptesh që japin shpjegime materialiste, pa marrë parasysh se sa kundër-intuitive, pa marrë parasysh se sa mistike janë ato për të paditurit. Për më tepër, se materializmi është absolut, që t’mos lejojmë Këmbën Hyjnore në derë.²⁴

Këto janë pohime eksplicite që Darwinizmi është një dogmë që mbahet në jetë vetëm për hir të besnikërisë ndaj filozofisë materialiste. Sipas kësaj dogme, nuk ekziston asgjë tjetër veç materies. Prandaj, argumenton se materia e pajetë dhe e pavetëdije krijoi jetën. Këmbëngul se miliona gjallesa të ndryshme; për shembull, zogjët, peshqit, gjirafat, tigrat, insektet, drunjët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore zunë fill si rezultat i bashkëveprimeve në mes të materies siç është shiu që bie, vetëtimja që shkrepetinë, etj., nga materia e pajetë. Ky është një rregull në kundërshtim me të dyja arsyen dhe shkencën. Mirëpo, Darwinistët vazhdojnë ta mbrojnë atë vetëm e vetëm që “t’mos e lejojnë Këmbën Hyjnore në derë.”

Cilido që nuk e shiqon zanafillën e qenieve të gjalla me një paragjykim materialist do të shoh këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë krijesa të një Krijuesi, i Cili është i Gjithëfuqishëm, Më i Urti dhe i Gjithëdijshmi. Ky Krijues është Zoti, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, e krijoi në formën më të përsosur dhe iu dha formë të gjitha gjallesave.

Mos përziej të vërtetën me të rrejshmën dhe me vetëdije të fshehësh të vërtetën. (Kur'an, 2:42)

Ata thanë “Lavdia të qoftë Ty!

Ne nuk kemi dijeni tjetër përveç çfarë na ke mësuar Ti.

Ti je i Gjithëdijshmi,

Më i Urti.”

(Kur'an, 2:32)